

1.

Nga vijnë këto koka? Të ç'vendi janë, të ç'kohe?

Duke bërë këto pyetje Jacques Lacarriére, njohës i shquar i antikitetit, i Perëndimit e i Lindjes, ka bërë, në të vërtetë, pyetjen e gjithë atyre që gjenden për herë të parë përpara pikturave të Omer Kaleshit.

Një çast të duket se të kujtojnë fytyrat e ashpra të Caravaggio-s, pastaj ato të Goya-s, gjersa heq dorë prej kërkimit, për të bërë prapë pyetjen e parë. E, meqenëse nuk është e lehtë të marrësh një përgjigje aty për aty, pyetja përsëritet, këtë herë për krijuesin e tyre, Omer Kaleshin. Nga vjen ky piktor, i ç'vendi është, i ç'kohe?

Emrit të tij turk Omer, i mungon vetëm H-ja, për t'u bërë i njëjtë me emrin e poetit të madh grek. Kur njihesh edhe më afër me piktorin një gjë e tillë të duket sikur s'është rastësi. Omer Kaleshi është piktor turk e ballkanas, njëkohësisht. Ka kryer studimet në Akademinë e Pikturës në Stamboll, por rininë e ka kaluar atje ku ka lindur, në tokën e shqetësuar të gadishullit më aventurier të Europës. Ai është nga ajo zonë e botës, ngjarjet tronditëse të së cilës zotëruan ekranet e TV-it botëror në këtë vit të fundit të mijëvjeçarit.

Një zjarr i rënë në hambaret dhe stallën ngjitur me shtëpinë e tij, kujtim i shqetësuar i fëminisë, i ka lënë mbresë të thellë. Ishte një zjarr kriminel, i vënë për arsye urrejtjeje e hakmarrjeje, ndaj i është dukur edhe më i tmerrshëm. Dele dhe buaj digjeshin. Më vonë, kur urrejtja të bëhej edhe më e fortë, do të digjeshin njerëz.

“Ka vite që punoj mbi këtë dramë”, thotë Omer Kaleshi.

Në ngrehën e jetës së tij gjendet e gërshetuar një pjesë e nyjës ballkanase. Omer Kaleshi e ka të atin shqiptar dhe nënën maqedonase. Ndërkaq, piktura e tij është krijuar kryesisht në Turqi dhe në Francë.

Përkatësia etnike, gjëja më e natyrshme në botë, në Ballkan merr ngjyrimet tragjike, sidomos vitet e fundit. Një kapitull i veçantë i dramës ka lidhje me njerëzit që i kanë prindërit të kombësive të ndryshme, disa herë në armiqësi me njëra-tjetrën.

Në tragjeditë greke bëhet pyetja se cila zanafillë është kryesore: e atit apo e mëmës, ato që të shqiptarët quhen “lisi i gjakut” dhe “lisi i tamblit” (qumështit). Omer Kaleshi ka tmerr nga kjo ndarje. Ndoshta, për t'iu larguar këtij tmerr, për të mos qenë i detyruar të zgjedhë midis gjakut dhe qumështit, ai ka emigruar në Turqi, për t'u bërë piktor turk. Më pas, gjithmonë në kërkim të një harmonie botërore, ku Turqia dhe Ballkani të fqinjërojnë natyrshëm, ai është vendosur në Francë.

Në bulevardin “Arago”, banesa-atelie e tij është në katin e gjashtë. Meqenëse është në katin e fundit, një pjesë e qiellzanës së pjerrët është prej qelqi, kështu që sipër kokës ka vetëm qiellin.

Por as nga qielli nuk vjen gjithmonë qetësi. Dhe kjo ndihet qartë kur shikon pikturat e tij. Peshja e tokës është e rëndë, nganjëherë e padurueshme.

Pyetja: nga vijnë këto koka, të ç'vendi janë, tani mund të marrë njëfarë përgjigjeje. Këta njerëz, këto koka, që në përsëritjen e tyre kanë diçka nga turmat biblike që lëvizin, nga vargjet e të mërguarve me po ato fytyra të njëjtësuar nga brenja, është vështirë të përcaktosh se ç'populli i përkasin. Është, ndoshta, tmerrri i vjetër prej përkatësisë etnike, që e ka bërë piktorin të vijë te ky vizion parak. Këta njerëz, këto koka janë banorë të Anadollit po aq sa të luginave ballkanase, ata janë turq, shqiptarë, maqedonas, epirotë, hebrej, trojanë, babilonas, pellazgë.

Por, ndërsa është e vështirë t'u gjendet kombë-sia, është lehtë të merret vesh se me se merren. Janë kryesisht barinj dhe dervishë.

Ka një harmoni kundërthënëse midis shfaqjes së ngrirë të tyre dhe thelbit të fshehur. Midis luzmës njerëzore barinjtë dhe dervishët bëjnë pjesë ndër ata që ndodhen në lëvizje të paprerë. E në pëlhurat e Kaleshit ne i shohim si të zënë në kurth. Është një palëvizshmëri, që të kujton thënien e vjetër shqiptare: ngriu si ujku në vetëtimë. (Vetëm popujt malësorë mund të kenë vërejtur një çast kaq të rrallë: hutimin e ujkut prej dritës së vetëtimës.)

Të djelën më 17 prill 2022 u nda nga jeta në moshën 90-vjeçare piktori i shquar Omer Kaleshi. Për t'u njohur me jetën dhe veprën e piktorit të famshëm,, po botojmë këtë ese të Kadaresë e shkruar më 1999.

ARTI SI MËKAT

Ese nga Ismail Kadare



Bariu dhe dervishi janë dy gjedhe, dy modele njerëzore, sa të moçme, aq edhe të ngarkuara me simbolikë. Bariu është prijës i një grigje, është i vetmuar, i ndarë nga njerëzit, pra, i damun (demon). Ai është i largët, mungues, i pafjalë. Dervishi duket si e kundërta e tij, kur mendojmë se nuk merret as me dele, as me qumësht, as me lesh, që janë baza e të jetuarit, por ngjan me bariun, ngaqë si ai është endacak, i vetmuar e i largët. Bariu lëviz i shtyrë nga lënda, nga qëllimi jetësor. Dervishi zhvendoset i shtyrë nga mistika, rrallë nga shërbime të fshehta, që s'i di askush. E megjithatë, të dy ngjajnë njëlloj të pakuptueshëm: si ai që ruan ushqimin njerëzor, si tjetri që nuk parashtroon veç ëndrra e ngandonjëherë valle të frikshme.

2.

Pëlhurat e Omer Kaleshit janë të mbushura me një si popull të veçantë, që nuk ekziston gjekund në botë. Sepse askund nuk mund të ketë pasur një popull që të përbëhej vetëm prej barinjsh e prej dervishësh. Ashtu siç bëhet pyetja: nga vijnë këta njerëz? po ashtu mund të vazhdohet me pyetjen: ku janë të tjerët? Përse nuk i shohim ushtarët, nëpunësit, bujqit, kokëprerësit, zonjat, zotërinjtë, shërbëtorët, aventurierët etj., etj.?

Kjo pyetje e dytë, që mund të duket fare e pavend në një rast tjetër, përligjet për Omer Kaleshin. Nga pëlhura e tij del një vizion global. Tablotë e tij kërkojnë të japin fytyrën e një popullsie që mbush një hapësirë të gjerë. Ndaj pyetja, goftë edhe e gabuar, është e përligjur.

Hapësira nga ka dalë ky shqetësim, kjo seri kokash që të kujton vizionin shekspirian të serisë së kokave që ndjellin magjistricat të “Makbethi”, është tepër e shtrirë. Disa perandori janë ngritur, për t'u shkatërruar pastaj në këtë hapësirë. Perandoria romake, bizantine, otomane, në fund, bishti i perandorisë komuniste. Pas çdo rrënimi, hijet e gërmadhave të secilës zinin vend në ngrehën e asaj që vinte.

Ishte e njëjta hapësirë ku më parë kishin

ndodhur aventura të mëdha të mendjes njerëzore. Egjiptianët kishin shpikur botën e përtejme, domethënë ferrin, asyro-babilonasit kishin shpikur shkrimin dhe grekët e vjetër lirinë e mendimit. Në këtë hapësirë kishin lindur tri qytetërimet dhe besimet e mëdha: judaizmi, krishterimi dhe islami. Kishin përvetësuar shpikjet egjiptiane dhe asyro-babilonase, por ishin përpjekur ta mposhtnin antikitetin grek. Veç luftërave me armë dhe me ide, u bënë ndeshje të tjera, që, në pamje të parë, dukeshin groteske e pa kuptim, por që vazhdonin nganjëherë një mijë vjet. E tillë ishte ndeshja që lidhej me pikturimin e fytyrës njerëzore.

Pasqyra ku njeriu shikon shëmbëllimin e vet, paskësh qenë, me sa dukej, një shqetësim i madh, sidomos në Perandorinë Bizantine dhe në atë otomane. Pikturimi ose jo i Krishtit dhe i Shën Mërisë, zëvendësimi i tyre me vija simbolike, siç është rasti i kryqit për Krishtin, ikonoklasta që erdhi pas kësaj, ndalimi i qdo fytyre njerëzore në pikturë prej Islamit, të gjitha këto ishin një pjesë e rravimit kulturor në këto vise.

Si piktor turko-ballkanas, Omer Kaleshi ka qenë i lidhur me kujtimet e Perandorisë Otomane, e cila u tërhoq nga gadishulli në fillim të këtij shekulli. Për çudi, në letërsinë dhe artet turke vizioni i perandorisë është përgjithësisht i zbehtë dhe i cekët. Disa e shpjegojnë këtë me një refuzim të shkrimtarëve turq për të pranuar një lidhje me të, shpjegim jo fort bindës. Në letërsinë ballkanase, përkundrazi, tabloja e perandorisë shfaqet më e plotë e më dramatike. Greku Nikos Kazanzaqis, jugosllavi Ivo Andriç, boshnjaku Mesha Selimoviç e shkrimtarë të tjerë rumunë, shqiptarë, bullgarë kanë thurur si në një vegjë të madhe fytyrën e ndërlikuar të këtij shteti kolosal.

Përpara se të vendosej përfundimisht në Gadishullin e madh European, të cilit do t'i jepte edhe emrin, Perandoria Osmane kishte luftuar, filtruar e jetuar përbri me perandorinë paraardhëse, bizantinën. Prej saj ajo përvetësoi vizionin shumëkombësh

të shtetit të madh, ndërlikimin hierarkik, burokracinë, intrigat diplomatike e, ndoshta, shërbimin e fshehtë.

Kam vënë re se, kur bie fjala për Perandorinë Otomane, biseda, zakonisht, rrjedh. Për atë Perandori të gjithë dinë diçka e më së shumti nuk dinë sa ç'duhet. Është pikërisht ky gërshetim i dijes me mosdijen, që e nxit bisedën, më shumë se çdo të ndodhte, për shembull, nëse ajo do të zhvillohej midis dy njerëzve që dinë shumë, ose dy të tjerëve që nuk dinë asgjë.

Sado e habitshme të duket, me Omer Kaleshin flasim tepër rrallë për ish-shtetin e madh. Nuk besoj se kjo vjen ngaqë ne të dy dimë shumë për të, kështu që druheni se mos e mërztim njëri-tjetrin me gjëra të njohura. Në të vërtetë, dimë shumë për të, por ajo që di njëri prej nesh është e ndryshme nga ajo që di tjetri. Ngjan si puna e dy njerëzve që kanë njohuri të ndryshme për hënën, ngaqë secili ka parë njërën faqe të saj, atë që s'e ka parë tjetri.

Më shumë se shkak për të mos folur, kemi këtu të kundërtën: rrezikun e një bisede që vrujon si përrua e ku bashkëfolësit mezi ç'presin rastin për ta ndërprerë shoku-shokun.

Është e vështirë të përfytyrohet një gjë e tillë midis nesh. Në të folurën e kursyer të Omer Kaleshit ka një vuajtje, një pengesë. Në heshtjen e tij, edhe më shumë. Ai ka dy gjuhë në shërbim të tij, shqipen dhe frëngjishten, por pengesa s'është gjuhësore. I përdor të dyja gjuhët shkëlqyeshëm dhe saktësinë e shprehjes e ka të pagabueshme.

Kam përshtypjen se pengesa është gjetkë. Ajo lidhet, ndoshta, me një ndjenjë faji. Duket sikur ai ka drojë mos e fyen Turqinë, vendin që i dha strehë pas shpërnguljes së dhimbshme nga Jugosllavia. Nga ana tjetër, ka drojë mos e tradhton zanafillën e tij ballkanase. E ky trazim nuk mbaron me kaq. Ka frikë mos tregohet i padrejtë me gjakun e babait të tij shqiptar. Mos është i padrejtë me qumështin e nënës maqedonase. Ndodhet i vetëm midis emblemave, flamurëve, shenjave heraldike të gdhendura me shpatë ose me art: shqiponjës kërcënuese dykrenore të shqiptarëve, gjysmëhënës së dremitur turke, yllit të Filipit, që maqedonasit duan ta shpallin si kryeshenjë të tyre, zemërimit grek për këtë, coroditjes europiane që s'di si ta shuajë këtë grindje etj., etj.

Për fat të keq, gjithë këto shenja e vizatime janë ende në një kacafytje e në një gramshalesh të pafund. Kështu që, në pritje të qetësimit të stuhisë, atij s'i mbetet gjë tjetër veç të ngrejë duart për t'u mbrojtur prej saj.

E si të mos mjaftojë kjo, më duket se ne të dy kemi rënë padashur në kurth (në një kurth të ngritur nga s'di se kush e s'di se si), duke marrë, jashtë vullnetit tonë, dy role që përfaqësojnë dy palë: njëri ballkanasin ngatërrestar, tjetri otomanin e duruar. Si të tillë ne shprehim, ndoshta, dy të vërteta: ai të andejshmen, unë të këndejmen. Dhe bashkë me to vjen pyetja: a ka megjithatë një të vërtetë të tretë, të vlefshme për të dyja palët?

Një çast më duket se arrij të kap diçka nga ai ndërlikim midis ballkanasve dhe shtetit otoman. Nga ai moskuptim, nga ai kuptim, nga ai flirt, nga ajo mizori, nga ato trumbeta e nga ajo çarturi e pafund.

Ç'ka ndodhur midis Ballkanit dhe Perandorisë? Ç'ka ndodhur midis të dyve dhe Europës? Përse në këtë vit të fundit të mijëvjeçarit, bashkë me ballkanasit që rrinë kokulur përpara zonjës-nënë të tyre të dikurshme, Europës, duke pritur që ajo t'i pranojë në shtëpinë e vet, ka zënë radhën e po pret të hyjë edhe Turqia, bërthama e Perandorisë së lemerishme Otomane, ajo që ishte betuar mbi Kuran e mbi shpatë se do t'i shembte kulm e themel Europën e krishterë?

Ç'ka ndodhur? A mund të shpjegohet? A duhet?

Le të përpiqemi:

Pas gëlltitjes së Bizantit, gëlltitje pas së cilës Perandoria Osmane nuk ishte më ajo që kishte qenë, asaj i doli përpara një det i trazuar popujsh, një lëmsh i vështirë, nga më të vështirët e kësaj bote, goftë për miqësi, goftë për armiqësi. Shtriheshin rresht, me gjuhë dhe fytyra të rrezikshme, të ndryshme, heroike dhe groteske, njëkohësisht, befasues, të paparashikueshëm. Ishin, pa dyshim, një ledh mbrojtës i Europës së krishterë, por disa mendje vizionare të Perandorisë e kuptuan

shumë shpejt se nga mbrojtës të kontinentit mëmë, mund të shërbenin në sulmin kundër tij. Dhe kështu, ashtu siç kishte bërë më parë me princat bizantinë, Perandoria zhvilloi me princat ballkanas politikën e njohur të fshikullit e të kulaçit. Plagët që hapte shpata e saj pushtuese, rrekej t'i zbuste me postet e nishanet që ua jepte bujarisht. Të rënë kështu në kurth, ballkanasit përjetuan gjatë pesëqind vjetëve një histori kundërthënëse, të cilën ende sot nuk janë në gjendje ose, më saktë, nuk kanë kurajën ta shpjegojnë.

E parë nga një pikëshikim i distancuar, historia e Gadishullit Ballkanik është historia e një gjymtyre të prerë të kontinentit europian. Një mijë e ca vjet më parë, një tjetër gadishull të prerë, atë të Pirenejve, Europa arriti ta rimmerre, me anë të Riconquistës. Me Ballkanin puna është më e ndërlikuar. Nuk është më Europa që rreket për ta rifituar, me shpatë apo me diplomaci. Janë ballkanasit vetë që duan të kthehen, ndërsa Europa mëdyshet.

Te popujt ballkanas e kaukazianë tregojnë legjendën e shqiponjës së zënë rob, e cila arrin t'i shpëtojë robërisë e të kthehet prapë te familja e saj. Mirëpo robëruesi i ka vënë shqiponjës një unazë në kthetra. Është kjo shenjë që e bën shpendin e arratisur të huaj për racën e vet. Familja nuk e pranon më shpendin e kthyer.

Popujt ballkanas, pas mungesës së gjatë, qëndrojnë përpara portave të Europës, pa mundur ta fshehin dot shenjën që u ka lënë në trup e në ndërgjegje Perandoria Otomane. Ata kanë nostalgji për Europën, por bashkë me nostalgjinë ndiejnë nervozizëm e zemërim. Nervozizëm për fajet e tyre, që s'duan t'i pranojnë, zemërim për harresën e gjatë të nënës kontinentale, Europës.


Natyrisht, ashtu si çdo shtëpi që kërkon të dijë se ç'ka bërë në mërgimin e tij të gjatë djali plëngprishës që po i troket në portë, edhe Europa ka dashur të dijë se ç'kanë bërë këta popuj në atë mjegull e në atë terr pesëqindvjeçar. Dhe këtu nis një dramë e re: ajo e shpjegimit ose, më saktë, ajo e përçarjes. Sepse më shumë se një shpjegimi të besueshëm, ajo që ballkanasit tregojnë për të kaluarën e tyre, i ngjet një belbëzimi pa kuptim.

Mund të thuhet kështu se as versioni otoman, sipas të cilit, perandoria i zbuti dhe i kultivoi ballkanasit kokëfortë, e as versioni i këtyre të fundit, sipas të cilit ata paraqiten si popuj martirë, që veç vringëllonin shpatat kundër pushtuesit, nuk i qëndrojnë së vërtetës. Një version i tretë na e jep atë që ka ndodhur. Është e vërtetë se popujt e Ballkanit i bënë qëndresë Perandorisë, por po aq e vërtetë është se ata u bënë pjesë e saj, pra pjesëtarë në trofetë, në bëmat dhe në krimet e saj.

Në shekujt XIX e XX, kur popujt e Ballkanit, njëri pas tjetrit po shkëputeshin nga Perandoria, kur erdhi pra, ora e kujtimeve, secili nga këta popuj nisi të harronte atë pjesë të historisë që quhej "e turpshme", domethënë bashkëpunimin, dhe të kujtonte veç pjesën "heroike", atë të rebelimeve.

Të mbërthyer kështu pas armiqësisë ndaj njëri-tjetrit, ballkanasit, këta shkretanë të pandreqshëm e armiq të vetvetes, nuk arritën të dëshmojnë asnjëherë epilogun e historisë së tyre të gjatë me Perandorinë Osmane. Ky epilog, ky bilanc përfundimtar i ndeshjes, është i çuditshëm e i madh, e megjithatë, ndonëse ka ndodhur në shekullin XX, në prani të të gjithëve, ende qëndron në terr, i pakapur prej syve tanë të verbër.

Epilogu ka të bëjë me pyetjen se a ka pasur një fitues e a ka pasur një humbës në këtë ndeshje pesëqindvjeçare midis Perandorisë Osmane dhe ballkanasve? Përgjigjja e kësaj pyetjeje përbën një paradoks të madh. Në përfundim të këtij rravimi shekullor, ballkanasit, ndonëse në shumicën e kohës të mundur e të rrëzuar tragjikisht përtokë, pikërisht në kohën kur gongu i mbarimit të dramës po binte, arritën t'i jepnin një goditje fatale Perandorisë së tmerrshme. Goditja ishte e padukshme, e pabujshme, e tillë që s'kuptohej nga vinte, ndaj dhe ishte e madhërishtme: Turqia, bërthama e Perandorisë pushtuese, ajo që me shpatë dhe Kuran kishte bërë çnuk e çmos për t'i kthyer ballkanasit nga europianë në otomanë, e nga të krishterë në islamikë, në mbarim të kacafytjes përfundoi ajo vetë në një shtet laik e republikan.



Ishte vepër e ballkanasve? Pa asnjë dyshim. Pesë shekuj përkitjeje pasionante, një klimë e vazhdueshme zie dhe feste, dashurie dhe urrejtjeje, kur pas goditjes mizore vinte përqafimi, e pas përqafimit goditja, pra pesë shekuj bashkëjetese të tillë, diçka të tillë do të jepnin. Diçka të epërme, befasuese, që qëndronte sipër dekreteve, flamurëve, minareve e kishave. Në dyluftimin me Perandorinë, ballkanasit u dëmtuan vërtet, u shfytëruan, u gjymtuan rëndë, por ndryshimin më të madh e pësoi Perandoria. Ndryshimi ndodhi në thellësi: në frymën e saj. Te qendra e shtetit të tmerrshëm, ëndrra e të cilit kishte qenë shfarosja e Europës së krishterë, lindi papritur ëndrra e kundërt: t'i bashkohet Europës, të kthehet në një rajon të saj.

Vepër e ballkanasve, hakmarrja e tyre e vonuar?

Pa dyshim. Vetëm ballkanasit mund t'ia ngjitin atë virus. Gjithë ata gjeneralë që morën praktikisht në dorë ushtrinë, ata vezirë që drejtuan shtetin, ata guvernatorë e vezirë të mëdhenj, që komanduan pushtimet e mëdha, ata arkitektë që ndërtuan tempujt, në shumicën e tyre ishin me prejardhje ballkanase. Kishin qenë të krishterë e ishin kthyer në myslimanë, për hir të karrierës. Kështu që ishte e kuptueshme që, bashkë me frymën luftarake, zotësinë profesionale, ambicien e marrëzinë, do të pikonin në dejtë e plakur të perandorisë nostalgjinë për europeanizmin dhe krishterimin e tyre të humbur. Dhe bashkë me të do të pikonin ide të laicitetit e të lirisë.

Dukuria nuk ishte e re. Dihej, tashmë, nga të gjithë se në kushte e rrethana të tjera, rreth dy mijë vjet më parë, në marrëdhëniet Romë-Greqi kishte ndodhur pak a shumë diçka e ngjashme: pushtimi i fitimtarit prej frymës së të mundurit.

Por ballkanasit nuk arrijnë ta kuptojnë e, aq më pak, ta shpjegojnë atë që ka ndodhur. Vazhdojnë të qëndrojnë në portat e Europës, dramatikë në moskuptimin e tyre, tragjikë në verbërinë e tyre. Smira për njëri-tjetrin ua errëson mendjen e çartur, përçarja e tyre vazhdon të jetë e pabesueshme. Kështu që ata s'janë në gjendje t'i shpjegojnë zonjës dhe nënës së tyre europiane trofenë që i kanë sjellë, njerken e tyre të zënë robinjë, Turqinë.

Omer Kaleshi më dëgjon pa m'i hequr sytë. Kërkon të hetojë nëse në shtjellimin tim ka anësi, domethënë adhurim të fshehtë për njërën palë ose nënçmim të mbuluar për tjetrën. Kur bindet se nuk ka asgjë të tillë, fytyra e veçanërisht sytë i ndriçohen si në festë. Ai është ballkanas e otoman, njëkohësisht e, si të mos mjaftojë kjo, është shqiptar e sllav, i krishterë dhe mysliman ose, më saktë, as ashtu e as kështu dhe, mbi të gjitha, është artist.

Është kjo arsyeja, ndoshta, që në pëlhurat e tij nuk gjendet asgjë nga ekzotizmi qoftë osman, qoftë ballkanas. As jeniçerë, as pashallarë turq, as komitë maqedonas a shqiptarë, as zonja me perçe apo pa perçe. Duket sikur ai ecën si i verbër midis rekuizitës shekullore të përfytyruar prej poetëve e piktorëve, që nga Goethe e Byron te

Delacroix, me një padurim për të mbërritur në themelin e gjërave, atje ku është baza, shtresa tektonike që nuk lëviz: barinj të dhe dervishët. Bariu është i vjetër sa bota, me qumështin e leshin e tij, dhe po aq i vjetër është dervishi, ndonëse emri i tij ka ndërruar nga vendi në vend e nga koha në kohë (mag, mistik i krisur, fetar, pelegrin).

3.

Duke shkruar për portretet e Francis Bacon-it, Milan Kundera flet për dëshirën që na lind për të zbuluar të fshehtën që ndryjnë ato. Në kujtimet e shkrimtarit kjo dëshirë lidhet me tundimin e përdhunimit të një gruaje të re. Në fund të fundit, te çdo marrëdhënie burrë-grua është gjithmonë ajo pjesë e historisë që në disa gjuhë shprehet me fjalët: "ta shtiesh në dorë". Shtënia në dorë, thënë ndryshe, depërtimi i një gruaje, është njëfarë mënyre zbulim i një të fshehte, qoftë edhe pjesërisht.

Piktori përpiqet të zbulojë të fshehtën, duke e zbërthyer dhe rimodeluar fytyrën e njeriut. Shkrimtari, gjithashtu, ndeshet me tiraninë e gjuhës, e cila përpiqet t'i detyrojë ligjet e saj, pa i lënë hapësirë lirie, por shkrimtari ngadhënjën më lehtë, ngaqë gjuha është abstrakte. Ajo nuk ka gjëkund asnjë shëmbëllim, asnjë pasqyrë ku mund të gjeshe qokat ose gjedhet e saj, ato që në rast katastrofe mund ta zëvendësojnë. Kurse tirania e pamjeve, që piktori duhet të hedhë mbi pikturë, qofshin portret a peizazh, është tepër e fortë. Pamjet janë gjithmonë përbri teje, si një miratim ose si një qortim.

Lëkura e njeriut, moda, raca, ndotja e mjedisit, sëmundjet, frikërat përpiqen të njëjësojnë portretin njerëzor. Mbi këtë gdhendje, si prej ere të shkretëtirës, piktori rreket të zbulojë të veçantën, të rivendosë shpirtin e humbur. Nganjëherë e thyen portretin, me shpresë se në rindërtimin e tij e fshehta do të shfaqet. Nganjëherë përpiqet të germojë në thellësi, ashtu siç hiqet suvaja, për të nxjerrë shtresën e mirëfilltë të murit. Por kjo mund të jetë zhgënjyese. Dihet që gurët, gjithashtu, janë të ngjashëm. Kurse poshtë lëkurës së njeriut, ngreha e kockave, gropat e syve dhe dhëmbët janë tmerrsisht të njëtrajtshme.

Piktori është i detyruar prapë të ngjitet në sipërfaqe. Do apo s'do, duhet të merret me lëkurën e njeriut. Ndërkaq, në rastin e portretit vendosja mijëvjeçare e syve, e hundës, e flokëve, e gjithçkaje tjetër që ka koka njerëzore, përpiqet ta pengojë. Atëherë piktori përpiqet të krijojë nëpërmjet shkatërrimit. Ai kërkon ta thyejë fytyrën e njeriut, të zhvendosë atë që natyrës i janë dashur qindra shekuj për ta skajuar. E megjithatë, qëllon që edhe pas kësaj e fshehta nuk shfaqet.

Pas pyetjes nga vijnë e nga ç'vend janë këto koka, përpara portreteve të Omer Kaleshit, vjen pyetja e tretë, edhe më e vështirë: ç'të fshehtë ndryjnë këta njerëz? Sytë e tyre shohin edhe nuk shohin, nganjëherë duket sikur përtej tyre shikojnë diçka tjetër, nganjëherë sikur vështrojnë brenda vetvetes.

Jacques Lacarriére thotë se ato koka të japin përshtypjen se kanë kaluar nëpër një krusmë jonjerëzore. Sipas tij, ato janë imazhi ynë i ikur, që na kërkon prapë. Dhe, ndoshta, vetëdija e errët që nuk del.

U besuam katalogëve, për t'i kujtuar gjer tani barinj dhe dervishë dhe befas fillojmë të dyshojmë nëse janë vetëm të tillë. Edhe pak dhe nuk do ta kemi vështirë ta përfytyrojmë veten në punishten e vjetër, atje ku modeli i njeriut u krijua së pari nga balta.

4.

Dënimi zyrtar më i përhapur, sidomos për njerëzit e rëndomtë, në Perandorinë Romake, ishte kryqëzimi. Në bizantinën ishte verbimi me një vegël hekuri me dy pinca. Osmanët vunë prerjen e kokës. Nga të tria këto, i pari, kryqëzimi, ishte edhe më teatrori e tmerrndjellësi. (Ngritja e dërrasave prej druri, mbërthimi i viktimës, qëndrimi i kufomës mbi kryq njëfarë kohe.)

Verbimi, ndërsa ishte më pak i bujshëm, në çastin e kryerjes së gjymtimit, e kishte tepër të gjatë efektin e tmerrit. (Viktima, në rast se nuk vdiste, mund të endej vite me radhë rrugëve.) Prerja e kokës, sidomos kur bëhej në sheshe publike, ngjante me kryqëzimin, por e kishte dramaticitetin, sa të fortë, aq edhe të shkurtër në kohë. Për t'ia shtuar rrezatimin e tmerrimit (qëllimi kryesor në të tria llojet e dënimeve), osmanët shpikën ibret tashenë, kamaren e turpit, ku koka e viktimës vendosej ditë me radhë, për t'u soditur nga turmat.

Kur Edouard Pignon shprehu mendimin se portretet e Omer Kaleshit u ngjanin kokave të prera, piktori nuk ishte në një mendje me të. Ai edhe sot e spraps me këmbëngulje këtë krahasim dhe shumë njerëz mund të habiten nga këmbëngulja e një njeriu që shquhet për butësi dhe durim.

Mendoj se ky mospranim vjen nga një thellësi e vetëdijes së tij. Peneli i tij pikturon portrete që mund të ngjajnë si koka të prera, por për ndërgjegjen e tij krijuese ato janë koka njerëzish normale. Kokat njerëzore nuk mund të priten kurrsesi.

Për ta kuptuar ndoshta këtë, duhet të rikthehemi te makina e vdekjes në Ballkan. Përmendëm tri dënime kryesore të shteteve të mëdha (pa u ndalur në dënime të tjera të tyre: djegia, mbytja me gurë, shpimi me hu), por pa folur, sidomos për dënime që kishte njohur gadishulli përpara mbërritjes së këtyre perandorive.

Është i njohur mospranimi prej grekëve të vjetër i copëtimit të trupit njerëzor. Kjo prerje, sipas tyre, prishte një harmoni dhe një rend të gjërave. Ajo ishte një prerje e ndërlidhjes midis të vdekurve dhe të gjallëve, pra, një shkëputje dhe një goditje në thelb të gjithçkaje që njeriu i asaj kohe besonte. Kur i biri i Agamemnonit të vvarë kërkon të bindë bashkëqytetarët e tij për shëmtinë e krimit të nënës, një nga provat kryesore është prerja e gjymtyrëve të trupit të viktimës.

Për banorët e tjerë të gadishullit, ilirët, ne nuk dimë ç'dënime përdornin. Por nga kodi zakonor i shqiptarëve, që janë pasardhës të

tyre, del fare i qartë tmerri prej gjymtimit trupor. Kodi i famshëm i shqiptarëve e ka çuar edhe më larg fobinë greke, duke ndaluar rreptësisht jo vetëm gjymtimin, por edhe preken e trupit të kundërshtarit. E vetmja që ky kod pranonte, ishte goditja nga larg, çdo vrasje tjetër quhej e paligjshme, rrjedhimisht, e dënueshme.

Megjithatë, nuk mund të thuhet aspak se ishin osmanët ata që ua mësuan ballkanasve të pafajshëm prerjen e kokave, siç mund të mëtojnë letrarët kombëtaristë të gadishullit. Përpara se ajo të vinte në Ballkan bashkë me ligjet dhe rekuizitën e osmanëve, tremen ku xhelati priste viktimën, fermanin e lexuar me zë kremtor prej kasnecit, e gjer te shiriti i mëndafshit, që përdorej për t'i thyer arrëzën e qafës, kur viktimja ishte zyrtar i lartë, ajo prerje barbare e kokave njihej gjerësisht në gadishull. As kujtimet e qytetërimit grek, as kodi shqiptar nuk mund ta ndalonin dot. Ballkani banohej nga shumë popuj, disa prej të cilëve kishin ardhur nga larg bashkë me doket e tyre të ashpra.

Mizoritë e përshkruara në këngët epike ballkanase, janë të tilla që të ngjethin mishtë kur i lexon. Gjatë kohës së pushtimit osman ishte e lehtë që të dyja palët t'ia hidhnin të keqen kundërshtarit, por kur punët u ndanë, doli një e vërtetë tjetër.

Gati një shekull pas ikjes së turqve, krimi u harbua në Ballkan me një shpërthim të paparë. Gjymtime të lemerishme, koka të prera, sy të nxjerrë, djegie të gjalla, thyerje kockash, sharrime, shqyerje. Të gjitha këto u bënë, sidomos në Bosnjë e në Kosovë. Ballkanasi i hershëm, Kaleshi, i sprapste ato në thellësi të ndërgjegjes së tij, por Kaleshi i sotëm i jepte dashur pa dashur në pëlthurë. Ishte, me sa dukej, nën përshypjen e lajmeve që vinin andej, kur Pignonit iu dukën portretet e Kaleshit si një koleksion kokash të prera. Dhe jo vetëm atij. Të shumtë ishin ata që patën përshypjen se ndodheshin përpara një piramide kokash, si ato të Timur Lengut, një piramidë e shpërbërë, gurët e së cilës janë vendosur rresht, për t'i parë më mirë, në një galeri pikturash.

Me atë të bardhë të ftohtë anash, atë dëborë, atë brymë frigoriferike, ato na kujtojnë morgun e madh të Prishtinës, ku hetuesit e Gjyqit Ndërkombëtar të Hagës plotësonin dosjet e tyre, në vitin e egër 1999. Këto holle, këto hajate të mëdha të vdekjes, thotë Francis Bacon-i, kur vërtitet në supermarketet ushqimore, ku copat e mishit janë vendosur në raftë të ftohta. Erën e vdekjes, që vinte nga këto shitore, ai u përpoq ta hidhte në pëlthurë.

Vitet e fundit, si për të theksuar më fort, atë që pikërisht piktori e ka kundërshtuar, në portretet e Kaleshit, midis qafës dhe trupit shfaqet një vijë e hollë, gati e tejdukshme, ajrore, e tillë që e bën Lacarriére-in ta quajë “shenjtëri”. Kjo vijë, që duket si e rënë nga lart, shëmbëllën vërtet me breroret e shenjtoreve në ikona. Është si një plagosje e përhershme, vazhdon Lacarriére, duke kujtuar heroin e antikitetit grek Filoktetin.

Në atë vijë ndarëse, më shumë enigmatike, sesa të shpjegueshme, janë, ndoshta, të tria rrënjët e Kaleshit: edhe plagosja e Filoktetit ballkanas, edhe hija e shiritit të mëndafshit osman, që ndehej mbi qafën e viktimës, edhe përndritja e gjotinës franceze, e cila ende ishte në veprim, kur piktori u vendos në Francë.

5.

Katundi Sërbice, në Maqedoni, është një ndër më të largëtit e më të paarritshmit për udhëtarin. Omeri i vogël, që kishte lindur në këtë humbëtitë, shumë herët e kuptoi arsyen përse gjyshi i tij, i ardhur nga malet veriore të Shqipërisë, kishte zgjedhur për ngulim këtë skutë të mënjanuar. Një rënie në gjak e kishte detyruar. Qysh në atë kohë emri i Shqipërisë, malet me mjegull të së cilës dalloheshin nga rrafshulta maqedonase, lidhej me një kërcënim.

Omeri i ri punonte si elektrikist. Çdo ditë, për të shkuar në punë, i binte rruga përbri Hamamit të Daut Pashës, i cili, pas ikjes së turqve, qe kthyer në muze ikonash. Atje, në ngrehinën otomane të mbushur tani me frymë të krishterë, ai për herë të parë pa një ekspozitë arti. Ishte e skulptorit anglez Henry Moore. Gravurat e tij për bombardimin e



Londrës gjatë luftës së fundit, njerëzit e strukur në metro, ankthi dhe tmerri i lanë përshtypje të pashlyeshme. Ishte viti 1955.

Një vit më pas, familja e tij, ashtu si mijëra familje të tjera, u mërgua në Turqi. Ishte koha e egër e terrorit të serbomadhit Ranković. Jugosllavia dëbonte nga trualli i vet një pjesë të kombësive joslave. Shenjat e para të spastrimit etnik dukeshin në horizont. Emri i Jugosllavisë iu kujtonte europianëve liberalizmin dhe festivalet, por për të dëbuarit ai emër lidhej prapë me një kërcënim.

Në Ankara, Omeri punoi përsëri si elektrikist. Ëndrra e tij për të shkuar në Stamboll, në Akademinë e Arteve të Bukura, u krye më në fund. Pas mbarimit të saj, më 1962, bashkë me dy studentë të tjerë vendosën “të shikojnë botën”. E fillojnë nga Turqia. Për pesë muaj i bien anakënd me autostop gjithë vendit. Shikojnë katunde, qytete, pazare, dervishë, karavansaraje, tyrbe otomane, uzina, varre, bidonvile. Vizitojnë rrënojat e lashta: Trojën, Bergamon, Hefesin, gjithçka.

Pas këtij shtegtimi, vëllai i tij, Hasan Kaleshi, profesor në Hamburg e në Prishtinë të Kosovës, ku edhe vdiq, e ndihmon të marrë vizë për të dalë në botë. Më 1963, udhëton nëpër Itali dhe Francë. Më 1964, në Vjenë, Gjermani, Angli e Holandë. Më pas viziton Madridin e Toledon. Muzetë dhe galeritë janë magjepsëse kudo, por atë e tërheq sidomos Parisi.


Kthehet në Paris dhe punon si lyerës ndërtesash. Një aristokrat shqiptar, një zotni i madh i kulturës europiane e otomane, Abedin Dino, e ndihmon, ashtu siç kishte ndihmuar dhjetëra bashkëkombës të tij, të merrte letrat. Ca kohë lan qelqet në Drugstoren e Champs Elysées. Një ditë, atje gjithashtu ra zjarri... Dukej i ndryshëm nga zjarri i feminisë, zjarri i stallës, përmes të cilit dhitë e djegura rendnin si në përrallë. Megjithatë, thelbi ishte po ai: një zjarr i pjellë nga urrejtja.

6.

Paraprojektin e “Komedisë hyjnore” të Dantes dikush e gjeti te një dru (rrënjët-ferri, trangu-purgatori dhe kurora-parajsa). Po të donim ta gjenim ngrehën danteske te trupi i njeriut, do të ishte pakëz më vështirë. Sidoqoftë, mendimi i parë do të ishte që koka është ferri, trupi me kënaqësitë e tij mëkatore parajsa, dhe këmbët purgatori.

Marrëdhëniet e kokës e të trupit e kanë shqetësuar shumë mendjen e njeriut. Sa më të vjetra të jenë gjuhët, aq më shumë fjala krye ka shërbyer si rrënjë për dhjetëra fjalë të tjera. Përftimi i kokës shoqërohet aty për aty me mençurinë, rëndësinë e njeriut, shkallën e tij hierarkike, çmendurinë, rebelimin, luftën për pushtet, sundimin, kurorën. Ndaj dhe prerja e kokës, përpara se të jetë bërë dënim i njëmendtë, ka mundësi të ketë gjalluar në mënyrë të turbullt te njeriu si një shkoputje, një veprim i skajshëm, një zëvendësim.

Ajo që ngjan e veçantë në galerinë e portreteve të Omer Kaleshit është njëfarë kthimi kryengulthi i gjërave. Këto koka, që shfaqen përpara nesh, nuk na kujtojnë as mençurinë e as çmendurinë, as sundimin e as nënshtrimin. Duket sikur në këtë botë të ashpër ato kanë mundur t'u shmangen rravgjimeve njerëzore, ngaqë kanë njohur një tjetër tmerr e i binden një tjetër urdhri.



Shmangia e parë ka lidhje me thelbin e kokës: njëjësinë e saj. Koka është një. Ajo është e papërsëritshme. Omer Kaleshi duket sikur kërkon të sfidojë këtë thelb. Si në një pasqyrë të Borgesit, si në një makth, ai na jep një seri kokash të ngjashme.

Duke qenë të shumta, ato vetvetiu e humbin ambicien e njëshit, të veçantisë, të sundimit tiranik. Ndërkaq, s'kanë asgjë të përbashkët me turmën e përlur.

Çfarë i bën të duken të natyrshme në skajimin e tyre të ndërmjetëm? Janë, pa dyshim, midis njeriut të gjallë dhe maskës, midis njëmendit dhe shëmbëllimit, shkurt, midis jetës dhe mosjetës. Piktori, sa ç'është piktor, është edhe balsamues. Moskuptimi që vjen nga pëlthurat sa vete bëhet më i thellë. Duket sikur koha nuk rrjedh më, ashtu siç thuhet se ndodh, po t'i afrohem një vrimë të zezë.

Ndërkaq, nga thellësitë e historisë së njerëzimit vjen një paradoks. Një nga simbolet më klasike mbretërore e perandorake, shqiponja dykrerëshe, bie në kundërshtim me idenë e njëshit, të sovranit. Dykrenia e zogut mbretëror nuk i përgjigjet asnjë logjike, përkundrazi. E megjithatë, është simboli më i përhapur qysh nga koha parabizantine. Rusia e flaku drapër e çekanin komunist, për ta vënë prapë në emblemën e saj. Serbia, me gjithë tërbimin antishqiptar, bëri të njëjtën gjë. Shqipëria është i vetmi vend që shkabën dykrenorë e ka në flamur dhe nuk e ka hequr kurrë qysh nga mesjeta.

Europa, zakonisht, dorëcunge me shqiptarët, për habi, ua njohu këtë uzurpim të shqiponjës së moçme. Dhe jo vetëm kaq, por, si për të ta ripohuar atë, ka qindra vjet që po përdor shprehjet “vendi i shqipeve”, për Shqipërinë, dhe “bijtë e shqipes”, për banorët e saj, dy emërtime që, më shumë se prej vendësve, përdoren nga të huajt.

Ndërkaq, një tjetër mister, që këtë herë vjen nga gjithnjaja e gjuhës, atje ku gjërat janë shpesh të zhytura në një terr të rremë, na kujton se në shqip fjala “krye”, ajo që ka pjellë mbi njëqind e njëzet fjalë, nga kryetar e krejt, gjer te krenar e kryehershme, paraqitet trillane dhe e pabindshme. Fjalë me tri gjini, rast i rrallë, në mos i vetëm në shqip, më shumë e palakueshme se e lakueshme, më pranë gjinisë asnjënjëse se mashkullorë a femërore, e përdorur vetëm në njëjës për njeriun, dhe veç në shumës për bagëtinë, ajo i shpëton, megjithatë, çdo rregulli. Kështu, për shembull, përdorimi në shumës te njeriu lejohet në një rast, kur është fjala për krerë të një lëvizjeje, të një politike, të një kryengritjeje ose të një komploti. Kjo kundërvënie njëjës-shumës ka gjasë të ndryjë në vetvete raportet sovran-popull, sovran-feudalë, ose president-parti, në kushtet moderne.

Ndërkaq, duket sikur ka një kundërthënie midis thelbit tiranik, mbretëror të fjalës, me tingëllimin e jashtëm që në gjuhën shqipe duket si më pranë shumësit se njëjësit. Ka gjasë që ky shumës i shfaqur të theksojë edhe më fort thelbin që fjala ndryn, në po atë mënyrë që formulimet mbretërore, që fillojnë me “ne, mbreti i X”, theksojnë idenë e sundimit të njëshit.

7.

Omer Kaleshit i pëlqen të përsëritë se për një kohë të gjatë i qëllon të pikturojë të

njëjtën gjë. Ai shton pastaj se Giacometti gjithë jetën ka bërë portretin e të vëllait.

Në atelienë e tij, në bulevardin “Arago”, nuk ka orare. Dita e piktorit s'ka të bëjë fare me ditën kalendarike. Ajo mund të nisë në mesnatë ose në tre të mëngjesit.

Kjo mungesë oraresh e kjo ngjashmëri ditësh janë të lidhura, me sa duket, me një ritëm të veçantë në krejt jetën e tij. Ky ritëm vetanak jep në pëlthurë portrete ku ndryshimet zhvillohen ngadalë. Duket sikur piktori i bindet ritmit natyror të zhdrivillimit. Kur dashurohet pas një ngjyre, duket sikur ngopja me të do të vijë ngadalshëm, ashtu siç vjen ose ikën ngjyra ngadalshëm në fytyrën e njeriut, siç shtohen rrudhat ose siç zbardhen flokët.

Ca fruta të kursyera u shfaqën në fund në pëlthurat e tij vite më parë, por shfaqja më e gëzueshme ishin fëmijët. Omer Kaleshi nuk është i martuar dhe nuk ka fëmijë. Fëmijët u shfaqën në pëlthurën e tij në moshën gjashtëdhjetëvjeçare.

Të bukur e të freskët, pa asgjë të përbashkët me barinjët dhe dervishët. Ndërkaq, duhet kujtuar se këta të dytët nuk martohen dhe nuk kanë fëmijë.

8.

Fiton modeli, kur i ngjan pikturës dhe jo e kundërta, ka shkruar kritiku turk i artit, Kaya Orsergin, duke folur për pikturën e Kaleshit.

Në atelienë e tij prej vitesh nuk ka hyrë asnjë model.

“Modelet e mia nuk e dinë që janë pikturuar prej meje”, thotë Omer Kaleshi. “Unë i lë ata aty ku i shikoj: në rrugë ose në kafene. I lë të qetë. Rri unë pa gjumë për ta.”

Është një mënyrë vetanake përftimi e punës krijuese. Piktori dhe modeli krijojnë së bashku diçka. Modeli ka lënë peng pamjen e tij në kujtesën e piktorit. Dhe ky, pa dijeninë e të parit, e përpunon atë.

Një ndërsjelltësi e tillë të kujton përrallat ballkanase, në të cilat ka shpesh një ndarje të trupit e të shpirtit ose, më saktë, të thelbit të këtij të fundit: njeriu rri diku në një mjedis pallati, në shpellë ose tavernë, por nyja e fshehtë ku është lidhur e brendshmja e tij, shpirti, fati, programimi i tij (po të përdorim një qasje të sotme) ndodhet diku larg, në malin me akull, për shembull, ose në një vezë në det.

Dordolecët, që përveç përdorimit prej fshatarëve si trembës shpendësh nëpër ara, ushtria perandorake osmane i përdorte përpara çdo fushate si mjet përçmimi e nënvlehtësimi ndaj kundërshtarit (përpara flamurëve e trumbetave, në krye të ushtrisë marshonin disa dhjetëra ushtarë, që mbanin në vend të heshtave dordolecë), dordolecët, pra, dëshmonin lidhjen e fshehtë që bashkonte njeriun me shëmbëllimin e vet. Në rastin e kukullave, që shpoheshin me gjilpëra, kemi prapë përpjekjen për të krijuar një lidhje midis njeriut të urreyer, le të themi modelit, dhe shëmbëlltysë së tij. Ndërsa, kur është fjala për dordolecët, njeriu i përçmuar mund ta shikojë sendërgjini e tij me sy, si me tejpyrë, që pas kështjellës së rrethuar, në rastin e kukullave të shpuara, ai nuk di asgjë.

Ndryshe nga shpuesi i kukullave, që i dëshiron të keqen modelit, piktori i jep atij jetë të dyfishtë, ndonëse në rastin e Omer Kaleshit modeli nuk e di. Modeli lëviz, ecën, jeton, pi çaj në kafenet e Ballkanit ose të Stambollit, pa i shkuar mendja se në katin e gjashtë të një ndërtese të Parisit dikush rri pa gjumë për të.

9.

Omer Kaleshi shkon shpesh në Stamboll. Si për ballkanasit e kryehershëm, ai mbetet përherë kryeqyteti i tij. Nuk ka gjetur dot një kryeqytet në Ballkan. Beogradi, për arsye kujtimesh historike, nuk e ka afuar, Shkupi ka qenë kryeqytet i vogël, Tirana, duke qenë për një kohë të gjatë staliniste, ishte vetvetiu groteske. Kështu që, përpara se të njihje Parisin, natyrshëm, ai është lidhur me kryeqytetin e përbashkët të krejt ballkanasve.

Dihet se ka, së paku, dy Stambolle: ai hijerëndi bizantino-otoman, me hijen dhe pluhurin dyperandorak të shpërndarë kudo, me Shën Sofinë, Xhaminë Blu, mishmashin mbretëror, Topkapinë, rezidencën e

sulltanëve, që Gérard Georges Lemaire e ka krahasuar bukur me një fushim kryezotësh nomadë, që kanë ngrirë befaz në vend, dhe tjetri, Stambolli i pazareve, i kafeneve, i galerive të pikturës dhe i gjithë dihatjes që shkaktohet nga përkitja e dy kontinenteve, të cilët mu midis tij llapashitin ujërat, puthen, duhen, përçmohen, merren vesh e keqkuptohen pa fund.

Kaleshi ka shumë miq në Stamboll: shokë të Akademisë së Arteve, shkrimtarë, galeristë, filozofë. Ai i njeh mirë të dyja Stambollet. Por për të, ashtu si për gjithë ballkanasit, ka një Stamboll të tretë. Ky është, ndoshta, më i pafundmi, më befasuesi e më i xhevahirti, siç janë, zakonisht, qytetet e përfytyruara. Stambolli për gati gjashtë shekuj ka qenë i pranishëm në fantazinë ballkanase, në mendjen e njerëzve, në baladat e tyre, në urimet, mallkimet, frikërat. Nuk ka një popull të gadishullit të mos e ketë përmendur dhjetëra herë në këngët epike, të mos ketë rrëfime për të, të mos ketë shprehje ose proverba. Për grekët, ai ka qenë Konstandinopoja e ëndërruar, për sllavët e jugut, Caregradî (qyteti mbret), për shqiptarët, Stambolli, e kështu me radhë.

Ai ishte qendra e perandorisë trikontinentëshe, prej nga vinin lajmet, dekretet, fatkeqësitë, taksat, shpallja e luftës, e pages, dënimet, faljet. Për atje niseshin ankesat, kallëzimet, prej andej vinte verdikti. Të gjithë prisnin vendimin e tij: popuj që grindeshin, pashallarë që kacafyteshin me njëri-tjetrin, tregtarë, fetarë, mistikë.

Në malet e tyre të ftohta, ballkanasit e përfytyronin kryeqytetin në trajtat më fantaziste që mund të mendohej. Dhe po aq të përrallshme i mendonin pallatet e tij, xhamitë, vezirët dhe zotin e botës, sulltanin. Qëllonte që, pasi prisnin me muaj e me vite përgjigje për ankesën e tyre, befaz vendosnin të nisin një dërgatë atje. Dhe meqenëse nuk kishin asnjë vizion të qartë gjeografik, parashikimi i rrugëtimit ishte gjithmonë i gabuar. Nga udha tepër e gjatë u ndodhte që ta harronin qëllimin kryesor të udhëtimit, pengoheshin nëpër qytetthet e mbyllura prej murtajës ose rebelimeve, sëmureshin ose humbnin paratë në bixhoz, kështu që kur arrinin më në fund atje, nuk e gjenin dot kurrë vezirin, që thuhej se kishte lindur në katundin e tyre, ose i gjenin varrin, por jo atë vetë.

Kur Omer Kaleshi bëri udhëtimin e parë për në Stamboll, ndonëse mund të mos i ketë menduar këto, në njëfarë mënyre i ka pasur me vete, si çdo ballkanas. Ka kohë që Stambolli nuk është më kryeqytet i Ballkanit, por hija e tij është ende aty. Ajo do të japë herë pas here përndritje të zbehta, si ato që vijnë nga fundi i një pusi.

Në botë shumëçka përsëritet në trajtë qerthullore. Dërgimi i një ushtrie shumëkombëshe në Ballkan në prag të vitit 2000, për ta bërë zap gadishullin kryekërcyer, a nuk e ka hijen e ushtrisë së dikurshme perandorake që vinte nga larg? Veçse këtë herë perandoria është Europa dhe dy kryeqytetet e saj, Brukseli dhe Strasburgu, kanë më pak hije shtypëse se Konstandinopojë-Stambolli i dikurshëm.

10.

Një pjesë e atyre që e dinë lidhjen e piktorit me Parisin, gjëja e parë që kërkojnë në pëlhurat e tij është shfaqja e tij. Ka midis tyre që në krye mund të jenë zhgënjyer. Të tjerë mund ta kenë marrë për mosmirënjohje: jeton kaq kohë në Qytetin e Dritës dhe prej tij na paska nxjerrë veç këta barinj e këta dervishë?

Është një keqkuptim që përsëritet në Paris. E kërkojnë Parisin në sipërfaqe: në tituj vjershash, në përshkrime romanesh, në pëlhurë. E kërkojnë edhe më keq: në trille, në kotni. Dhe harrojnë ose nuk janë në gjendje ta kërkojnë atje ku duhet: në thellësi. Parisi është metropol i madh i artit pikërisht, sepse jep liri. Dhe liria e tij as është e kushtëzuar, as kërkon shpërblim: më jep, të të jap.

Ngaqë, ndoshta, nuk e kapin këtë përmasë të pashfaqur lirie, ata habiten që midis përplasjes së modave, të shkollave, të rrymave, të salloneve të pranverës, të hyrjes së vjeshtës, për të cilat Parisi ka qenë dhe mbetet i pakrahasueshëm në botë, Omer

Kaleshi vazhdon punën e tij, i patrazuar prej dallgëve.

Është vërtet i patrazuar? Vështirë të thuhet. Është, ndoshta, e kundërta. Gjithë ai tmerr që vjen mbrëmjeve prej ekraneve e lajmeve televizive, ajo egërsi, ajo ftohtësi, ai moskuptim i botës, të gjitha këto japin e marrin nëpërmjet një hullie të fshehtë me pëlhurat e tij. Dhe ajo vijë e hollë, e tejdukshme, shndërrim në një teh thike i brerores së shenjtë, diçka ndan, diçka bashkon, diçka ka plagosur përjetë te ne, Filoktetët e këtij fundmijëvjeçari.

11.

Omeri e pi kafenë e së dielës, zakonisht, në rrugën “Mouffetard”. Është pothuajse në largësi të barabartë nga atelieja e tij dhe nga banesa ime. Biseda jonë për marrëdhëniet midis pikturës dhe letërsisë ndodh pikërisht këtu.

Në bisedë, Omeri është i përmbajtur, fjalëpakë dhe jokundërshtues. Jep gjithmonë përshtypjen se di më pak se ato që di në të vërtetë. Kjo vjen ngaqë nuk tregohet asnjëherë grykës për të sunduar një kuvendim.

Në kohën kur më shumë se kurrë flitet për urat, që duhet t'i bashkojnë e jo t'i ndajnë popujt, sidomos në Ballkanin e trazuar, kërkimi i rrënjëve të përbashkëta në çdo sferë, përveç që është “politikisht korrekt”, është një bisedë e lehtë, sidomos për dy përtacë të fjalës.

Që nga antikiteti i thellë, prirja për bashkimin e poezisë dhe pikturës ka qenë e njohur. Askush nuk mund të habiste askënd me vjersha të shkruara në trajtë befasuese, që të kujtonin gjithfarë figurash, sendesh, madje dhe gjallesash.

Kur Guillaume Apollinaire-in e kritikuan, më 1914, ngaqë vjershat e tij “calligramatiques” ishin një gjë e njohur, e vjetër sa bota, ai u mbrojt, duke thënë se s’kishte bërë gjë tjetër veçse ishte kthyer te parimi bazë, përderisa ideograma ka qenë pikërisht parimi i shkrimit.

Ëndrra për t’u kthyer në unitetin e arteve, “ut pictura poesis”, siç thoshte Horaci, ka qenë e njohur. Dhe, si në çdo ëndërr, është shkuar përherë aq larg sa ç’mund të shkohet.

Janë kërkuar, për shembull, ura lidhëse midis gjuhës dhe matematikës e, pse jo, midis gjeometrisë e gjuhës dhe më tej, midis gjuhës dhe astrologjisë, kimisë apo mjekësisë!

Një shpërthim i fundit ndodhi pas rënies së komunizmit, kur gjithë të çmendurit e Lindjes, duke i mbushur mendjen vetes se s’kishin mundur të shpreheshin për shkak të regjimit, shpalosën margaritarët e tyre që, për fat të keq, mbuluan njëfarë kohe të përndjekurit e vërtetë.

Më 1766, si për të frenuar vrullin bashkues

letërsi-pikturë, Lessingu botoi “Laokoont”-in e tij të famshëm, që ishte një trajtesë jo për shkrimin, por për kufijtë midis tyre. Në të njëjtën kohë u botuan të nëntë pjesët e një prej biblave të modernizmit, romanit “Tristram Shandy” të Laurence Sterne.

Dukej sikur ishte koha për të bërë një bilanc ose, së paku, për t’u kujtuar të gjithëve se në botën e shkrimit, qysh prej treqind vjetësh para Krishtit, nuk kishte mbetur trill pa u provuar. Me vjersha të shkruara në trajtë piramide, veze, manastiri, varri, kryqi, gaforreje, shtylle, ylleti, trëndafili, derri, labirinti, me fjalë të tjera, të shkruara nga koka këmbët, siç thuhet, janë mbushur bibliotekat e mesjetës.

Ne i kujtojmë të gjitha këto. Ne, pa dyshim, jemi me mendimin tjetër, atë që e përfton risinë e artit si një rrugëtim të natyrshëm, që kryhet sipas ligjeve të brendshme të tij, ligje që shpeshherë s’kanë asgjë të përbashkët me botën e jashtme. Brenda këtyre ligjeve dhe jo brenda pargjeve të ndryshme, arti mbrohet nga sulmi i paprajshëm i vulgaritetit. Arti nuk është qeveri, parti ose kastë, që mund të ndërrohet pas një përmbysjeje. Ndërkaq, brenda të njëjtit regjim plot paqe ai mund të pësojë katastrofë. Shkurt, arti dhe letërsia nuk vdesin herë pas here, për të lindur po ashtu. Në një rast të tillë bota do të ishte plot kufoma, që s’do të dinim ku t’i varrosnim. Arti dhe letërsia jetojnë vazhdimisht dhe, në goftë se në to ka pakëz vdekje, kjo është ajo vdekje që e ka brenda jeta dhe që, në fund të fundit, e ripohon atë.

Si përherë, kur vjen fjala për marrëdhëniet e letërsisë me artet e tjera, unë dyshoj se jam i anshëm, domethënë i padrejtë. Është një padrejtësi që nuk më shqetëson, ngaqë më duket se kam lindur me të. Jam i bindur se letërsia, për shkak të veglave të saj, e sidomos të vegjës bazë, që është gjuha, është më e lirë dhe më e pakufishme se piktura. Edhe në gjendjen e saj parake, gjuha njerëzore e ka të ndryrë si çmërs një minimum letërsie. Pikturës, për shembull, iu desh të shpenzojë shekuj të tërë për të ardhur në mënyrë të pavarur te një fytyrë njerëzore me tre sy, kurse për letërsinë shpërthime të tilla kanë qenë si ushtrime të thjeshta qysh në zanafillë.

Natyrisht që duhet të jem i padrejtë dhe vetë krahasimi midis tri arteve kryesore: letërsisë, muzikës dhe pikturës duhet të jetë po aq i pamundur sa midis pjesëve të gjithësisë ku veprojnë ligje të ndryshme.

Omer Kaleshi nuk më kundërshton. Ose e bën ngaqë është tepër harmonioz dhe nuk dëshiron të prishë paqen e këtij mëngjesi shtatori parizian, ose ngaqë rruga “Mouffetard” (atë që, ndoshta, turqit e marrin për Myftar, ashtu siç marrin për Osman, bulevardin “Hausmann”), ndonëse ndodhet

në largësi të barabartë nga banesat tona, i përket më tepër botës së pikturës, pra, i duket si shtëpi e vet. Dhe në shtëpinë e vet, njeriu është më pak kundërshtues.

12.

Ka dy fate artistësh. Një palë lindin dhe rriten në shtëpi ku arti ka hyrë, ndërkaq: biblioteka është plot me libra, pasditeve nëna luan në piano ose emta pikturon, pasdarkeve miqtë flasin për letërsinë, artet dhe spiritizmin. Një palë tjetër nuk njohin asgjësend nga këto. Në shtëpitë e tyre nuk është dëgjuar kurrë muzikë, s’është folur kurrë për pikturë dhe të vetmit dialogë dramatikë që janë dëgjuar kanë qenë grindjet e prindërve në ditët plot mërzi. Askush nuk mund ta dijë, ndërkaq, se cili mjedis e nxit më fuqishëm prirjen e artistit të vogël: ai që e josh me praninë e tij gjithkund, apo tjetri, që ia shton etjen me mungesën e tij. Ndërkaq, ka edhe një fat të tretë, disi më të rrallë, por më dramatik. Jo vetëm që fëmija që ëndërron të pikturojë ose të shkruajë nuk ka kurrfarë nxitjeje nga njerëzit e familjes, por, përkundrazi, ka pengesë. Dhe artisti i ri shkon drejt artit siç shkohet drejt mëkatit.

Mos pikturo fytyra njerëzish, sepse pastaj duhet t’u japësh shpirt, i thoshte i ati Omerit të ri.

Djaloshi mbrohej: Zoti, a nuk ishte një artist i madh, kur e bëri Adamin prej balte?

Po Zoti jep shpirt, ngulte këmbë i ati. Ti s’mundesh.

Islami, për një kohë të gjatë, e kishte ndaluar pikturimin e fytyrës njerëzore. Kur i ati, falë këmbënguljes së të birit, e pranoi, më në fund, shfaqjen në pëlhurë të dhuntisë së tij, i tha: unë s’të ndalova dot të bëhesh piktor. Tani që u bërë, kërkoi Zotit ndjesë!

A të ka shkuar ndër mend të kërkosh ndjesë një ditë?

Omeri nuk përgjigjet. Nënqesh me vete.

Një ditë më ke thënë se nuk e duron dot praninë e të tjerëve kur punon, madje, as praninë e sivëllezërve të tu piktorë.

Është e vërtetë. Madje, kjo gjë më ka shqetësuar mua vetë një kohë të gjatë. Jam qetësuar vetëm kur kam lexuar një thënie të Leonardo da Vinçit: Kur në atelie jeni dy veta bashkë, ti nuk je veç gjysmë. Kur bëhen tre, ti s’je veç një e treta. Kur bëhen katër, je një e katërta. E kur janë shumë, ti nuk je më.

A ka për ty ngjyra më pak miqësore, për të mos thënë armiqësore? A ka ngopje prej tyre, ka lodhje, velje, siç i qëllon që i ndodh shkrimtarit prej fjalëve?

Jo. Nuk kam ngjyra armiqësore. Ka ngjyra që nuk i përdor, si e bardha, e zeza dhe bluja. Nuk i përdor, ngaqë nuk i njoh. E ngaqë s’i njoh, më trembin.

Më fol për ngjyrën e kuqe e për këto koka.

Ngjyrën e kuqe e kam zgjedhur qysh në rini.

Dhe ai tregon për atë ditë kur profesori u dha atë këshillën e paharrueshme: çdo student duhej të zgjidhte një mjeshtër, me të cilin të ndihej i afërt. Dhe bashkë me mjeshttrin të zgjidhte një ngjyrë, gjithashtu, të afërt. Omeri zgjodhi për zot të tij Goya-n, dhe për ngjyrë, të kuqen. Ishte e kuqja e zjarrit të fëminisë, e gjakmarrjes së gjyshit dhe e krejt gjakut ballkanas.

Kur për herë të parë e pa freskën e Goya-s në kulmoren e Santa Antonio dela Flora, kokat e pikturuara i kujtuan prapë një pamje dramatike të fëminisë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Njerëzit thërrisnin: ikni nga fshati, do të ketë luftë! Dhe të gjithë iknin, fshiheshin ku të mundnin. Një çast, në fushën plot me gropa, Omeri i vogël pa dhjetëra koka të trembura që dilnin aty-këtu. Ajo mizëri kokash, në kujtesën e tij, i ngjante aq shumë kulmores së kishës në Spanjë.

13.

Nga vijnë këto koka, ç’kërkojnë...

Të largëta, si të pjella nga një kujtesë tejhistorike, shtillen njëra pas tjetrës, me atë ndriçim që e kanë thithur përbrenda.

Duket sikur duan të japin një kumt e nuk e japin dot. Është një kohë e ashpër, gati barbare, që i ka pjellë, për të cilën, ndoshta, kanë nostalgji, ose e kundërta, me të cilën duan të ndahen. Janë aty, me atë moskuptim të pafund në sy, me një pritje tragjike, ndoshta, pritjen për të bërë një kapërcim...

Antibes, shtator 1999



Shqyrtime të gjuhësore dhe letrare, tashmë e Skanë dhënë përgjigjen mbi shkrimin letrar të Budit dhe gjurmët e pranishme të poetit e të prozatorit, si tekst dhe vlerë. Sjellja në vëmendje e përcaktimit të Selman Rizës, të bërë në mesin e viteve '60 të shekullit të njëzet, ndihmon për të kuptuar se si është trajtuar më herët trashëgimia poetike: *"Si për nga ristia e temave dhe gjinive, ashtu edhe nga aftësia kompozicionale, gjithashtu për nga fuqishmëria e shprehjes Pjetër Budit kurrësesi nuk mund t'i mohohet cilësia jo vetëm e të parit lavrues frymëgjatë të poezisë letrare shqipe, por njëherazi edhe të parit poet shqiptar..."*

Megjithatë, mëdyshja e treguar herë pas herë ndaj poezisë së autorit, duke shpërfillur hapur aftësitë e poetit, madje në shumicën e herëve pa e lexuar si tekst, sidomos në Shqipëri, e cila ngahera rishfaqet si hije gjërryese e vlerave letrare që bart, kërkon një verifikim më të pranshëm tekstologjik të gjithë materies poetike. Ligjërata e pashmangshme e përcaktimit të trefishtë të natyrës së poezisë së Pjetër Budit, pra, si e përkthyer, e përshtatur dhe origjinale, nuk është se largon dhe zgjidh çështjet e trajtimit të trashëgimisë poetike në kohë dhe hapësirë të autorit themelhedhës të shkrimit poetik të kultivuar të shqipes, aq më tepër me libër me poezi. Ndërmjet tyre, si më thelbësore, në optikën e hedhjes dritë në këtë proces kompleks dhe tejet të ndërlikuar, ndonëse të përqëndruar për një kohë të gjatë në shtjellat jashtëtekstore, janë:

A – Marrëdhënia e lëndës përkthimore dhe autoriale, e cila nuk është parë dhe trajtuar ndamazi, por si një bashkëshkrirje e tyre, pa kufijtë e pranishëm të analizës dhe interpretimit të secilës anë shkrimore, në katër librat e shkrimtarit.

B – Lënda poetike dhe prozeshkrimi, që dëshmon praninë e vlerave letrare të endura nga shkrimtari, ku ndërkaq poezia ka njohur një botim të trashëgimisë poetike të të tre librave, përkatësisht në vitin 1986, nën përkujdesjen e Rexhep Ismajlit, kurse proza gjendet ende vetëm në librat e botuar nga Propaganda Fide. Pra, ende jemi pa një tekst integral, ku të bashkëlidhen të gjithë faqet në prozë që trashëgojmë prej shkrimtarit.


C – Metodatat e studimeve letrare, për të analizuar dhe vlerësuar qenësinë artistike të letërsishkrimit të autorit, të poezisë dhe të prozës, më tepër si një qasje jashtëtekstologjike, si dhe duke hulumtuar antifetaren dhe fetaren, por përgjithësisht duke lënë jashtë verifikimit dhe interpretimit shenjat letrare, duke u bazuar në parimet e poetikës së letrare.

D – Papërcaktueshmëria e lëndës poetike dhe modelet e leximit të teksteve të Budit dhe të letërsisë së hershme, si fakt gjuhësor që nuk ka lidhje me shenjëzimet artistike, e cila formalisht, bazuar në praninë e vargut dhe të strofës, po kaq të figurave dhe shprehësish, nuk jep dorë me lënë pezull një situatë të identifikuar të shkrimit të vargjeve.

Katër librat e Pjetër Budit, që ndërkaq kanë shpëtuar nga muggullimat e kohërave, përkatësisht *"Doktrina e Kërshtenë"* (1618), *"Pasqyra e t'rrëfyemit"*, *"Rituali Roman"* (ku gjendet edhe libri *"Kush thotë meshë këtë kafshë"* (libër - B. Gj.) *i duhet me shelbuom*) në vitin 1621, në hapësirat e veta kanë të përfshira:

- Lëndën e përkthyer, *"Doktrina e Kërshtenë"*, nga vepra homonime e Roberto Belarminos; *"Pasqyra e t'rrëfyemit"*, nga libri *"Specvlum confessionis"* të Emerio de Bonis; *Rituali Roman, një kodifikim rritesh, ceremonisë e lutjes fetare*, ku vihet re se materia tekstologjike këtij libri vjen e ndërthurur me tekstet e autorit, e cila përbën pjesën me të madhe të teksturës që trashëgojmë prej Budit. Përgjithësisht, nga sa reflektohet në studimet gjuhësore dhe letrare, materiali i përkthyer është përdorur si pasqyrë për të analizuar tekstet e autorit në gjuhën shqipe, pa hyrë shumë në analizën e sjelljes në gjuhën shqipe të akteve të ceremonialeve fetare, madje duke lënë në hije të dyja anët e medaljes, përkthimin si akt dhe praninë e shenjave letrare origjinale. Materia e përkthyer, sidomos për dy librat e parë të shkrimtarit, është parë si fakt gjuhësor dhe dëshmi e ceremonialeve fetare, kryesisht pa e hetuar ende modelin përkthimor të autorit a gjurmët vetjake të pasazheve të përshtatura ose të rishkruara. Andaj, kur përmendet koncepti i pranisë së shenjave të përkthimit, së pari duhet analizuar dhe shqyrtuar lënda që përmendëm më sipër, për të hetuar dhe verifikuar aftësitë e përkthimit të Budit, si dhe për ta përfshirë në kontributin e shkrimtarit, e mandej të hamendësohet se ka gjasa që edhe në shkrimin autorial, të ndeshen stilema ose episode të përkthyer.

- Materia poetike, që përbëhet nga faqet e fundit të librit të parë *"Doktrina e Kërshtenë"*, ku gjenden 19 poezi, e librit tjetër *"Pasqyra e*



t'rrëfyemit", ku ndodhen tri poezi dhe e *"Rituali Roman"*, ku ndodhet vetëm një poezi. Së bashku janë 23 poezi gjithsej, me 3139 vargje në gjuhën shqipe, e organizuar nëpërmjet tetërrokëshit trokaik, vargut më të përhapur të poezisë shqipe, si dhe strofës katërshe/kuaternës, me përjashtim të poezisë së vetme që gjendet te *"Rituali Roman"*, e cila ndryshe nga poezia tjetër e autorit, derdhet me vargje monokolonë, si dhe me tetërrokësh të dyzuar, pra me gjashtëmbëdhjetërrokësh, një varg që do ta hasim më vonë në vargjet e poemës *"Bagëti e bujqësi"* të Naim Frashëtrit, si dhe në disa poezi të Lasgush Poradecit.

- Materia e prozës së Pjetër Budit, e cila përbëhet nga parathënie, pasthënie dhe sidomos proza epistolare/letërsimbimi (më i përhapur si shkrim), mbërrin në rreth 170 faqe, e shtrirë në të tre librat, si dhe në lëndën e librit më vete *"Kush thotë meshë këtë kafshë i duhet me shelbuom"*, që është analizuar dhe madje theksohet se si me këto tekste ka zënë fill proza shqipe, ndonëse nuk ka mbërritur në duart e lexuesit, ashtu si poezia e botuar në vitin 1986.

Pamja e librave të shkrimtarit, e lëndës përmbamëse të secilit sosh, më në fund na kthjellon se Pjetër Budi ka përkthyer dy libra, si dhe disa tekste rritesh, gjë që është pohuar si fakt, por shkalla e shqyrtimit të teksteve të përkthyer, të materies së përkthyer, është në nivele fillimtare, me përjashtim të pohimeve të bëra nga studimet gjuhësore dhe ndonjë hamendësim i përkthyesve, që realisht nuk e njohin letërsinë e hershme, po kaq edhe veprat e Budit, se nga janë marrë si tekste, gjithnjë duke mbetur në rrafsh hipotetik. Në mesin e përkthyesve që janë marrë me përqasjet ndërtekstore, do të veçoja Robert Elsie, për rropatjet e tij për të përqasur një poezi të Budit, me poezinë Thomaso a Celano (1200: 1255), për të cilin në librin Poetika e Budit, botuar në vitin 2002, nga ana ime është bërë një interpretim mbi pamundësinë e lidhjes së vargjeve të Budit, sepse ai vetë në parathënie e librit *Doktrina e Kërshtenë*, pohon se i ka marrë te Pal Hasi, e jo në tekstin latinisht që përmend Elsie. Për më gjatë, përqark kësaj situatë, mundet të konsultohet libri, ku është dhënë një përgjigje mbi një karahasim qartësisht të hamendësuar. Vijimi i të tjerëve, në këtë hulli të pagjasshme, në rastin e kësaj poezie, nuk është se zgjeron gjasat e përkthimit të poezisë së autorit tonë, e prandaj nuk meritojnë vëmendje për të ripohuar të njëjtën rrethanë, që nuk ndërlidhet me rrethanat dhe kontekstet shkrimore me vargjet e poezisë së Budit². Materia e përkthyer, e pranishme në librat e shkrimtarit, ende pret që të përfshihet në trashëgiminë përkthimore të shqipes, po kaq të ndihmesës së dhënë prej Budit në lëmin e përkthimit. Rrethana e pranisë së lëndës së përkthyer, në bashkëlidhje me tekstet e shkrimtarit, ka gjasa që të jetë bërë shkas edhe për "shpjegimin" e pamjaftueshëm të natyrës së poezisë së autorit, madje për pohime që nuk zbehin praninë e poezisë, por vënë në dyshim

rrafshet e leximit të saj, prej atyre që vënë në dyshim shenjat origjinale të poezisë së Budit, duke projektuar më tepër hamendësimet e shqyrtuesve.

Përcaktimi si vlerë letrare i teksteve me poezi dhe prozë, ka bërë udhë të gjatë, madje ka njohur kurba uljengritjesh, të cilat kanë krijuar jo pak mjegullnajë, sikur kemi më tepër një hartues librash të përkthyer dhe jo një autor origjinal, madje duke këmbëngulur në pamundësinë e hartimit të poezive prej autorit, gjithnjë si shqyrtime jashtëtekstore. Përqark kësaj "tymnaje", të ngritur me kontributin e akademizmit të botëkuptimit antifetar, si dhe të disa përkthyesve që lëvizin në hipoteza, larg tekstit dhe kontekstit shkrimor të Budit, pra pa e lexuar gjithë poezinë e tij, e cila ngahera duket dhe zhduket në skenën e studimeve albanologjike, me interes është pohimi i bërë nga Zef Skiroi, njëri prej njohësve të parë të librave të Budit, i cili shprehet pa asnjë ekuivok: *"... është e çuditshme se prej atyre që kanë thënë, ndoshta edhe me mospërfillje olimpike, ndonjë fjalë rreth Doktrinës së Budit askush të mos ketë ndjerë detyrën (përgjegjësinë) për të vënë në rëndësinë e duhur faktin që 110 faqet e fundit të saj përmbajnë 2884 vargje, pothuaj gjithnjë të zbritshme, të rradhitura në 721 kuartina me rimë të alternuar..."*³

Megjithatë, pavarësisht rrethanës rastësore, që me letrarësinë e teksteve të letërsisë së hershme, por edhe të trashëgimisë letrare, në poezi dhe prozë të Budit, janë marrë më së shumti filologët, mbase për shkak të vështirësive të rrafshit filologjik që bartin librat e asaj periudhe, asnjëherë nuk janë përjashtuar mundësitë e shenjave artistike në librat e shkrimtarit, pra edhe në shkrimin e poezive, në mënyrë të posaçme. Nëse për prozën, nga studimet e mëparshme, qysh me Mario Rok, Gaetano Petrotta, Gunar Svane, Faik Konica, Zef Skiroi, Kolë Ashta, Selman Riza, Eqerem Çabej, Mahir Domi, Dhimitër Shuteriqi etj., janë hedhur mendime të qarta, shpesh të shoqëruara me argumente, mbi ndonjë element artistik, trashëgimia poetike, e cila gjendet në tre librat e autorit, përkundrazi është parë me mëdyshje, madje në kohët e vona, është vënë në dyshim origjinaliteti i poezive të shkrimtarit, duke notuar në situatën e përkthimit dhe të përshtatjes, si një hipotezë që mbetet larg tekstologjisë së shkrimit të poezive, pavarësisht mbizotërimit të ngjyresave fetare.

Më herët, dritëhijet e trajtimit të poezisë së Pjetër Budit, marrin përgjigje të plotë në një punim mbi poezinë e autorit, në vitin 1949, nga Henrik Lacaj, ndonëse kjo qasje të thelluar studimore ende nuk ka mbërritur te lexuesi. Më vonë, shqyrtimi dhe vlerësimi i poezisë së Budit përplotësohet me shqyrtime të S. Rizës, I. Rugovës, R. Smjalit, S. Hamitit, Z. Neziri, M. Hysës, A. N. Berishës etj. Alternativa e përcaktimit të poezisë, e pranisë së shenjave estetike, që trashëgohet nga librat e Pjetër Budit, përsëri mbeti në një situatë të përzier, që është përkthyes

dhe përshtatës më shumë sesa poet. Për të hedhur dritë, mbi dyshimin e mungesës së plotë të origjinalitetit në poezinë e shkrimtarit, paraqet interes verifikimi i metodave të përdorura për leximin dhe interpretimin e teksteve me poezi. Në qasjen ndaj poezishkrimit të Budit kanë mbizotëruar këto mënyra:

- Leximi i trashëgimisë poetike vetëm si fakt gjuhësor dhe historik, sidomos në momentet e para të rënies në gjurmët e librave të autorit, gjë që lidhet ngushtësisht me rrethanat e zbulimit dhe të pranisë së tyre në jetën e shqiptarëve dhe po kaq edhe në dëshmitë e pranisë së letërsisë shqipe. Kjo situatë e paragjykimit, institucional dhe jashtëtekstor, të shenjave artistike të poezishkrimit rimerret edhe pas viteve '50 të shekullit të kaluar, kohë që përkon me fillimin e goditjes së variantit të gegnishtes dhe arbërishtes, e cila kulmon në vitet '76, kur vihet në dyshim dhe përjashtohet çdo shenjë vlerash artistike në shkrimin e poezisë së P. Budit, udhëhequr kryesisht nga botëkuptimi përjashtues i fetares.

- Leximi antifetar, që ka mbizotëruar për shumë kohë në mjediset akademike dhe universitare, për shkak të karakterit të tematikës fetare në këto libra, veçanërisht me vendosjen e sistemit monist në Shqipëri, që nxjerr krye në analizën e poezisë së tij, e cila zhvlehtësohet pa asnjë argument. Në tekstin *"Historia e Letërsisë Shqiptare"*, botim i Akademisë së Shkencave, ku duket se merr udhë përfundimtare kodifikimi i leximit me kufizime ideore të shkrimit poetik të Budit, po ashtu të letërsisë së hershme shqipe, në mes tjerash nënvizohet: *"... duke mos qenë shprehje artistike e një qëndrimi të caktuar ideor emocional ndaj jetës, nuk mund të quhet letërsi në kuptimin e mirëfillt të fjalës..."*, duke vendosur vulën përfundimtare të qëndrimit zyrtar ndaj poezisë së Budit, e cila nxjerr jashtë loje përfundime që merren nën hijen e betejës së monizmit, se feja është opjum. Po në këtë tekst, kinse shkencor, me kahje të zbatimit të platformës përjashtuese të letërsisë së shkruar në gegnisht, kemi edhe pohimin që shërben si një optikë zyrtariste, për mënyrën se si duhet lexuar dhe trajtuar krijimtaria letrare e Budit: *"Veprat e Budit janë në pjesën më të madhe përkthime të lira dhe përshtatje..."*⁴ Formulim unik në llojin e vet, për të lënë në hije shkrimin poetik të autorit, si një hipotezë që nuk ka asnjë lidhje me librat e Budit, lëshuar nga mendimi shkencor zyrtar, bazuar në shkencën e monizmit, që fetaren e shihte si antivlerë, e cila zbulon rrënjët kohore dhe ideore se kur ka nisur mëdyshja e vënies në dyshim të pranisë së vlerave artistike në shkrimin poetik të Budit. Kjo situatë institucionale, madje e nivelit më të lartë të mundshëm, e verifikimit dhe shqyrtimit të akademizmit të lidhur me idelogjinë komuniste, nuk lë shumë hapësirë për të kuptuar semantikën e përjashtimit të secilës vlerë të veprave të autorit, parashikuar nga dogma e realizmit socialist dhe botëkuptimi zyrtar, i cili fetaren e shihte si opium që shkatërron vetëdijen e njeriut.

- Leximi filobibliq, që ka mbizotëruar në studimet letrare në Kosovë, i cili kohëve të fundit u projektua edhe si shkolla filobiblike, një shtjellim i gjerë, kinse akademik, që megjithatë vjen pa argument të plotë bindës prej Sabri Hamitit, për të gjithë periudhat letrare. Nga ana tjetër, lidhur me periudhën e parë dhe vetë historinë e letërsisë shqipe, pavarësisht pikësnyimeve të prekshme didaktike, kryesisht për nevoja utilitare të shkollës së lartë, problematika është më hipotetike. Përcaktimet e bëra, sidomos sa i përket natyrës së shkollës filobiblike, më tepër vijnë në formë të përgjithshme, si dhe të bën përshtypje lënia jashtë këtij formulimi veprën e Buzukut, Matrëngës. Në këtë shkollë letrare, teksti letrar në shqip, në fakt, është derivim i tekstit biblik, që është universal, prandaj edhe emërtimi karakterizues filobiblike. Madje tekstet letrar zakonisht janë mbrenda librave doktrinarë të krishterë, duke krijuar një shfaqje tjetër të doktrinës. Autori shenjohej, mirëpo statusi i tij ndërron nga përkthyesi, te rikrijuesi e krijuesi. Ligjërimi thuret simbas gjedhes së retorikës e të moralitetit biblik të krishterë. Po ashtu, tematikat zotëruese janë biblike (Besëlidhja e Vjetër e Besëlidhja e Re).⁶

Megjithëse leximi filobibliq i lëndës shkrimore të letërsisë së hershme, ku Sabri Hamiti ka përfshirë veprën e P. Budit, P. Bogdanit dhe të J. Varibobës, krahasimisht me leximin antifetar që përjashtonte çdo element të pranisë së shenjave artistike, shkon më pranë teksteve, përsëri vijon që ta trajtojë fakturën letrare të letërsisë së hershme, kryesisht në këndvështrim tematik, duke i lënë sërisht në gjysmëterr shenjat letrare, ato që reflektojnë vlera edhe në poezinë e Budit.

4 *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë 1976, f. 4.

5 *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë 1976, f. 26.

6 Faqe internet, *Shkollat letrare shqipe*, Sabri Hamiti, <https://ëëë.scribd.com/.../SHKOLLAT-LETRARE-SHQIPE-Albanian-literary-school...f.3>.

1 Selman Riza, Selman, *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, Tiranë, Toena, 2002, f. 91.

2 Behar Gjoka, Poetika e Budit, Tiranë, Albias, 2002, f. 160-161.

3 Gaetano Petrotta, *Populli, gjuba dhe letërsia shqiptare*, Palermo 1932, faqe 27.

Papërcaktueshmëria e natyrës së poezisë së autorit, madje endja në mëdyshjen e trefishtë dhe hipotetike, të përkthyesit, përshtatësit dhe poetit, është objekti kryesor i ligjëratës, që ka si pikësynim rivënien në fokus të pranisë së poetit në tekstet me poezi. Përpjekja serioze për të gjetur shtegun formal dhe logjik, është e ndërvarur vetëmse nga të mbërrimet e interpretimit të teksteve të poetit, e po kaq në hetimin e gjurmëve të poetikës vetanake, të projektuar në hapësirën e poezive. Me gjithë mundësitë për ta njohur dhe lexuar, shqyrtuar dhe vlerësuar poezinë e autorit, thellimi i qasjeve ndaj trashëgimisë së Budit, më pranë tekstit dhe “vlagës” letrare që përlindet në të, kulmon në vitet ’80 të shekullit të kaluar e në vijim. Krahas shqyrtuesve të hershëm të librave të Budit, të cilët kanë hulumtuar mbi vlerat gjuhësore dhe poetike, për fatin e poezisë së tij, e rivlerësimit të shenjave poetike, ndikuan dy-tre momente:

Së pari: Botimi në vitin 1986 në Prishtinë, i trashëgimisë poetike të Budit, të pjesës së shkruar në gjuhën shqipe, nën përkujdesjen e Rexhep Smailit. Ky botim, ndërkaq ka njohur edhe botime të tjera, në vitin 2006 dhe 2016.

Së dyti: Analiza e hollësishme, interpretimet e gjera tekstologjike, varësisht metodikave dhe teorive të reja, të analizës së letërsisë së mesjetës, si dhe me rëndësi është përqasja me barokun religjioz e poezive të librit “*Doktrina e Kërshtenë*”, nga Zeqirja Neziri në vitin 1995.

Së treti: Shqyrtimi i vlerave të poezisë dhe prozës në një situatë përbashkuese të thelluar në të dy shenjat letrare, që përçojnë librat e shkrimtarit, të cilat e vendosin në një ekuilibër të trajtimit të dy anëve të shqiptimit letrar të krijimtarisë së autorit, në vitin 2015, nga Anton N. Berisha.


Në atë qarkëzim të verifikimit dhe vlerësimit të shkrimit poetik të Pjetër Budit dhe Pjetër Bogdanit, të autorëve të letërsisë së hershme, veçohen trajtesat e I. Rugovës, S. Hamitit, A. N. Berishës, M. Hysës etj., gjithnjë jashtë Shqipërisë, të cilat hedhin dritë me argumente të plotësuar mbi aspekte të ndryshme të poezisë së Pjetër Budit, madje duke përmendur e zbërthyer praninë e vlerave artistike në vjershërinë e këtij poeti. Në shekullin e njëzet e një, veçmas të tjerëve, në shqyrtimet e Anton Berishajt, Kujtim M. Shalës, Anton N. Berishës, e ndonjë tjetri, sidomos duke e ndërlikur vjershërimin e Budit me rrafshet e intertekstualitetit biblik (rikëndimit të biblës), më së shumti dëshmohet qenësia e poetit, si dhe prania e “prushit” të bariut shpirtëror, të shqiptuar përmes fjalës shqipe. Megjithatë në botime dhe interpretime të ndryshme, më tepër si akt jashtëtektor, si një prirje më e theksuar kjo në Shqipëri, me shumë gjasa një bartje e verifikimit zyrtar, ende nuk e kanë shmangur mëdyshjen nëse Pjetër Budi është poet, madje edhe në shekullin e njëzet e një, mbahet si tezë zyrtare e rëndësishme. Shtrimi i kësaj pyetjeje, lidhet me rrafshet konceptuale dhe me mënyrat e interpretimit të tekstit poetik, veçmas të letërsisë së hershme, në vlerën e një marrëdhënie të komplikuar të tekstit letrar dhe kontekstit shkrimor, të cilat janë të ndërthurura më tepër në bashkëjetesë dhe kundërvënie. Përpara studimeve letrare dhe gjuhësore, jo vetëm për shkrimin letrar budian, por për epokën përlindëse të letërsisë shqipe, e cila shenjëzon plejadën e Buzukut, Matrëngës, Bardhit dhe Bogdanit, të analizës dhe shqyrtimit të librave të tyre, sërish mbeten vjerrë tri momente:

- Bindja e studimeve letrare (e di si se në cilën metodikë dhe teori letrare është mbështetur) e të gjithë hapësirave, sipas së cilës poezia e mirëfilltë në letrat shqipe zë fill me Jeronim De Radën dhe Naim Frashërin, duke lënë anash dhe të shmangur prej hartografisë themelhedhësit e saj, Budin, Bogdanin dhe Matrëngën, ndonëse ky i mbрами me një këngë të përshtypshme.

- Ende nuk është braktisur situata e verifikimit dhe e trajtimit të shkrimit letrar të periudhës, si tipologji e leximit antifetar të poezisë së Budit, ndonëse ka rënë sistemi monist, që e ka lënë të varur idenë fiktive, sipas së cilës autori, më tepër është përkthyes e përshtatës, sesa poet, duke lënë në mjegullë, qoftë aktin e përkthimit, po kaq edhe situatën e teksteve autoriale.

- Deri kur do të funksionojnë “muret prej xhami”, në rrafshet e shqyrtimeve albanologjike, të cilat i kemi ngritur ndërmjet vedi, aq sa edhe gjuha e letërsia, shqyrtimet mbi veprat letrare, të lënë përshtypjen se më shumë janë “republika letrare autonome”, që më shumë ndërkomunikojnë rastësisht, larg bazamentit gjuhësor të shqipes së përbashkët.

Trajtimi ndërkohor dhe hapësinor i poezisë së Budit, që është shoqëruar me uljengritjet e veta, tashmë ka krijuar dy linja të qarta, që megjithatë janë të përkundrahta dhe shumë larg njëra-tjetrës, të cilat shkojnë deri në kundërvënie, duke vënë përballë argumentat bazuar në interpretimin e teskteve, me mungesën e leximit



të teksteve me poezi të autorit. Linja e parë, e cila rimerr në konsideratë përfundimet mëparshme të nxjerra nga ana e studiuesve mbi poezinë e shkrimtarit, e shqyrtimit të tekstit, të materies poetike të shkrimtarit, që shfaqet në fillimin e shekullit të njëzet, shënon një pikë reference të përfillshme në 400-vjetorin e lindjes së Budit, në vitin 1966, e cila bashkëshoqërohet me analiza të thelluara nga filologët dhe studiuesit e letërsisë. Linja e dytë, që ndërkaq shënon dukshëm braktisjen e së parës, e cila formësohet si qëndrim zyrtar mbi poezinë e P. Budit, sidomos në vitin 1976, e cila pason ndalimin e gegnishtes dhe arbërishtes në Kongresin e Drejtshkrimit të vitit 1972, rikthen situatën e mosshqyrtimit të teksteve letrare të shkrimtarit, gjë që zbulohet në pohimin e bërë nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë: “*Budi, në shumicën e rasteve, i kushtoi pak kujdes punës me vargun e strofën. Vjershat e tij vuajnë nga mungesa e teknikës në ndërtimin e tyre, nga përdorimi i shpeshtë i fjalëve të tepërta që e rëndojnë stilin. Po nuk duhet harruar se jemi në fillim të vjershërës artistike shqiptare.*”¹

Kjo rrethanë e leximit të pastër antifetar të vargjeve të Budit, mbase e leximit dogmatik të materies letrare, ndihmon që të kuptosh se në këtë përfundim të pazakontë të Akademisë ka vetëm mohim dhe injorim të mëtesave shkrimore të poetit, që nuk duhet të shkëputen nga kontekstet e kohës së shkrimit, për të hetuar dhe vlerësuar praninë e secilës vlerë. Në këto përcaktime zyrtare dhe pa argument të thelluara, nuk ka asnjë konsideratë për shkrimin poetik, madje më tepër kemi të bëjmë me një ligjërim jashtëtektor, pra pa lidhje formale me vjershërimin e Budit. Në anën tjetër, si një shpalim i analizës dhe i interpretimeve të teksteve me poezi të autorit, pasojë e njohejs dhe vlerësimit të shenjave letrare, që sugjerojnë praninë e vlerës letrare në poezishkrimin e tij, kemi vlerësimet e jo pak personaliteteve në kohë dhe hapësirë, të cilat artikulojnë vlerësimin për shkrimin poetik të Pjetër Budit.

Kështu, Mario Rok, njëri ndër njohësit e letërsisë së hershme shqipe, ndër të tjera, shkruan edhe për: “... *shqetësimet intelektuale në poezi të e tij...*”, që duket se përcjell një prani të autorit me shtesimet e veta, e rrokshme në hapësirën e teksteve. Selman Riza, njëri nga gjuhëtarët më të shquar, si ndër njohësit e letërsisë së hershme, të veprave të autorëve përfaqësues të saj, të studiuar dhe vlerësuar në të gjithë treguesit, si një kundërshti ndaj qëndrimeve të mbajtura, thekson me forcë: “*Mendimin e ndonjë kritiku se Pjetër Budi paska qenë vjershëruar i thjeshtë e jo njëherazi edhe vjershëtor i mirëfilltë shkruasi i këtyre radhëve e gjen të papërpiktë.*”² Mahir Domi, një filolog i spikatur i bashkëkohësisë, si dhe ndër njohësit e vlerave që përçon e gjithë periudha e letërsisë së hershme, ndër të tjera

1 *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë, botim i Akademisë së Shkencave, 1976, f. 27.

2 Mario Rok, *Gjurmime mbi Tekstet e Vjetra Shqipe e shkrime të tjera*, Shkodër, Botime Françeskane, 2011, f. 27.

3 Selman Riza, *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, (shkruar në vitin 1964 fillimisht si tekst universitar), botuar në 1996 në Prishtinë dhe në vitin 2002 Toena, Tiranë f. 178.

shprehet: “*Duke qenë edhe autori i parë i prozës origjinale shqipe e po ashtu lëvruesi i parë i vjershërisë shqipe...*”³ Në këtë formulim të bërë në vitin 1966, M. Domi nënvizon hapur qenien e Budit si autori i parë i prozës shqipe, por sa i përket materies poetike, më tepër lë një gjendje mjegullësie, duke e lënë pezull shenjimin e vlerës së shkrimit poetik, ngaku duket se merr udhë mendimi i mëvonshëm, për të përjashtuar çdo vlerë artistike, në poezishkrim.

Henrik Lacaj, përkthyesi veprës madhore të Virgjilit, poemës “*Eneida*”, si dhe studiuesi më zelltar dhe skrupuloz për të ndriçuar vlerësinë e poezisë së Budit, përveç punimit të detajuar për poezinë (shkruar në vitin 1949 dhe që ka mbetur ende në dorëshkrim, pa mundur që të bjerë në duart e lexuesit), duke e shoqëruar më shqyrtime tekstologjike të përimtësuar, sa i përket figurës dhe pranisë së vlerës në poezi, ka shprehur edhe këto mendime: “... *vendin e një shkrimtari të tillë nuk e la të zbrazët pikërisht Pjetër Budi i cili, përveç një lande aq të vëllimshme në prozë, na la edhe 707 strofa katërshe me rimë të alternueme në Doktrinën e Kërshtenë, 41 strofa në Pasqyrën e t’rëfjyemit dhe një vjershë prej 38 vargjeshe me tetërokësh të dyfishtë në Ritaullin Roman.*”⁴

Martin Camaj, shkrimtari që la Shqipërinë për shkak të kushteve të mbrapshta politike dhe kulturore, me një trashëgimi letrare të vyer në poezi, prozë dhe dramatikë, si dhe me punime të zgjeruara gjuhësore, në vitin 1966, që përkon me 400-vjetorin e lindjes së Budit, në revistën *Shejzat*, ku qe kryeredaktor dhe pati për editor Ernest Koliqin, shkruan: “*Budi asht poet jo me shumë talent, por asgjamangut farkues i mirë i vargut tetërokësh.*”⁵

Parashtrimi këtu i të dyja linjave, pra që e sheh si poet dhe, që nuk pranon asnjë dëshmi poetike në vargëzimin e poetit, së paku në këtë ligjëratë nuk ka për qëllim evidentimin e pengesave, ose numërimit e mungimeve të vëna re në leximin dhe analizën e poezishkrimit të shkrimtarit, porse vetëm nxitjen e thellimit të njohjes dhe të argumentimit se në poezinë e autorit ka materie letrare, ku gjellin fryma origjinale e shkrimit poetik. Po ashtu, të marrin fund hipotezat dhe hamnedësimet e ndryshme, që hidhen në shtypin letrare, pa lexuar librat e shkrimtarit, ku gjellin poezi dhe proza autoriale. Prania e magjisë së gjurmëve të shkrimit vetanak, me dëshmi të vlerave artistike, në prozë dhe poezi, ka mundësuar që të hyjë në historinë e letërsisë shqipe si poeti dhe prozatori i parë i shkrimit të kultivuar në letrat shqipe, gjithnjë e shenjuar me katër libra të shkrimtarit. Ligjërata jo pak e gjatë, pohuese dhe kundërshtuese, nihiliste dhe pa sjellë argument, aq më tepër që përbën vetëmse një kujtesë të rimarrë nga trajtimet e mëhershme, sidomos të rrethanave dhe konteksteve të leximit antifetar, ka mundësuar idenë mbizotëruese se leximet e pranishme jashtëtektore, vijnë që ta mbajnë vjershërimin e Budit jashtë rrjedhave të poezisë së kultivuar, ende në shekullin e njëzet e një. Koncepti hipotetik dhe pa shpjeguar asgjë mbi këtë qasje, i përcaktimit të poezisë, kinse të mirëfilltë në letrat shqipe dhe, që gjoja zë fill me veprën poetike të De Radës dhe të Naim Frashërit, duke lenë shtegun djerrë, sikur paska edhe poezi të pamirëfilltë, që do të vinte në dyshim jo vetëm dijen letrare, por edhe praktikën e leximit të letërsisë dhe poezisë. Emërtimi për poezinë e mirëfilltë, duke qenë një pistë zyrtare dhe akademike, detyruese e vepruese, për mjediset universitare dhe shkencore, prej kaq kohësh ka krijuar pasoja:

- Pa asnjë argument të analizës tekstologjike dhe stilistike, të dijes dhe praktikës së receptimit të shkrimit, përjashton nga leximi dhe verifikimi vlerat letrare të thurura në librat e Buzukut, Matrëngës, Budit, Bardhit, Bogdanit, aq sa janë, pa shtuar dhe hequr asgjë nga shenjat tekstologjike. Kështu, me këtë optikë të “ndalimit dhe përjashtimit” të librave të kësaj periudhe, lë jashtë historisë së dëshmime letrare periudhën e parë të letrave shqipe, si dhe humbet nga gjurmët e letrares shekujt 16-17-18, duke i kapërcyer ato në shekullin 19.

- Vë në zgrip ekzistencial shtegtimin e gegnishtes, variantit përlindës të gjuhës shqipe, e dokumentuar me libër me “*Mesharin*” e Gjon Buzukut, po kaq edhe të arbërishtes, që zë fill me E mbase me Kërshtenë, të Lek Matrëngës, gjë që lë hapësirë të pamatshme, të бедарjes së vlerave gjuhësore të këtyre dy varianteve të shkrimit të gjuhës shqipe.

Në anën tjetër, mbajtja në fuqi e hipotezës se Budi është më tepër përkthyes dhe përshtatës, sesa poet, duke lënë kështu në hije qasjet dhe interpretimet e mëparshme, të gjuhëtarëve dhe

4 Mahir Domi, *Pjetër Budi*, Tiranë, botim i Muzeut Historik Kombëtar, 2008, f. 206.

5 Henrik Lacaj, *Pjetër Budi*, Trianë, botim i Muzeut Historik Kombëtar, 2008, f. 217.

6 Marin Camaj, *Pjetër Budi*, Tiranë, botim i Muzeut Historik Kombëtar, 2008, f. 115.

studieusve më në zë të letërsisë së hershme, të vlerave të shumëfishta, tashmë duhet kapërcyer, më shumë për shenjat letrare të sendërtuara në gjuhën shqipe, sesa për vetë autorin. Ky qëndrim në marrëdhëniet me tekstet e shkruara, do të ndikonte për të shkruar në cakun e fillimit të letërsishkrimit, për ta bërë pjesë të panteonit të letrave shqipe. Shkrimi i gjuhës shqipe, në shekullin e 16 me librin e Buzukut “*Meshari*” dhe të Matrëngës “*E mbsuame e Krështerë*”, në shekullin e 17, me librat e Budit, Bardhit dhe Bogdanit, dëshmon se e kemi një njësi unike të shqipes, si një bashkëshkrim, të faktit gjuhësor dhe historik, që përçon edhe vlerat letrare dhe përkthimore, që duhet vendosur në ato kontekste, dhe mbi të gjitha duhet lexuar dhe interpretuar duke u bazuar në diskurin letrar, që në të gjitha rastet diskurin fetar nuk e përjashton si vlerë, përkundrazi e kundron si njëri ndër rastet që konfirmon praninë e shenjave letrare. Nëse Bibla është libri i librave, për secilin njohës të atij teksti, si mundet që të kemi drojën për ta parë, lexuar dhe zbuluar, shenjat e tilla, në librat e shkrimtarëve tanë, të shekujve të mesjetës së vonë, që morën shkas nga Dhjata e Vjetër dhe e Re, duke indentifikur ekzistencën e gjuhës shqipe, si gjuhë e shkruar, si gjuhë e letërsisë dhe kulturës!

Përfundime

Varësisht të mbërrimeve të studimeve gjuhësore dhe letrare, për të përçuar bindjen se ligjërata pati si funksion vetëm me qartësuar sadopak fatin e poezisë së shkrimtarit, si dëshmi e vlerave artistike, të enduara nga poeti në tekstet e shkruara, mund të formulojmë ndonjë konkluzion:

- Në rastin e shkrimit poetik të Budit, kemi një situatë poetike vërtet komplekse dhe të ndërthurur, të teksturës origjinale dhe të rishkruar (term i Selman Rizës), e cila nuk është se e përjashton përkthimin ose përshtatjen, por mbetja e prurjes së shkrimit poetik, vetëm në këto dy rrethana, që përjashtojnë praninë e poezisë origjinale, është e papranueshme për vetë situatën e poezive të autorit.

- Forma më tipike dhe më e shtrirë në vjershërimin e Budit, por edhe të shkrimtarëve të tjerë të letërsisë së mesjetës së vonë, është hartimi i poezisë si rikëndim i Dhjatës së Vjetër dhe të Re, ose si një modelim vetanak, që bart shenjat e origjinalitetit, si frymë e asaj tipologjie në ndonjë poezi tjetër të librave të shkrimtarit. Për këtë tip poezie, pra si rikëndim i materies së huamarrë nga Bibla, interes të veçantë zgjon këndvështrimi i Anton Berishajt, e cila shtejllohet gjerësisht në librin *Letërsia Performative*, për letërsinë e vjetër, kur mes tjerash thekson: “... *tekstualiteti i letërsisë së vjetër shqipe me dimensionin e tij polisemik, si një diskurs religjioz dhe si program tekstual që qëndron në themel të Letërsisë.*”⁶, çka përpos rivlerësimit të lëndës shkrimore të kësaj letërsie, ndërkaq tepër e rërndësishme është situatë kur në mes tjerash, pa asnjë ekuivok, sugjeron kodin e verifikimit të kësaj letërsie, po kaq edhe të poezisë së Budit, si një mënyrë e hetimit të gjurmëve letrare.

- Prania e poezisë origjinale të Budit, e cila nuk ka asnjë shans për ta ndërlikur me situatat e përkthimit, megjithatë shpaloset në disa poezi të autorit, të rrokshme në të tre e autorit. Fillimisht po përmendim poezinë 17 të “*Doktrinës së kërshtenë*”, me 150 vargje gjithsej, ndër të cilët:

*Tu'pam gjithë të keqtë
Aqë idhunë e helumom
Ke nd'arbënë shtiu leqtë
Dialli i mallëkuom.*⁸

Te këto vargje, të shkëputura nga materia e kësaj poezie, sidomos nëpërmjet përmendjes së fjalës *arbënë*, pra që shoqërohet me përcaktimin e vendit, ku ndodh kataklizmo e konvergimit fetar të dhunshëm, dëshmohet për një situatë të qartë të hartimit të një poezie autoriale, nga ana e P. Budit. Po ashtu, në poezinë e tetëmbëdhjetë, me titullin e hapur, *Për ndihmë të gjithë kërshtënimit Arbënit*, me 145 vargje, ndeshet problematizimi i kësaj gjendje, dhe mbi të gjitha vihet re se udhët e ndryshimit kërkohen me anë të fjalës, të librit që shërbën si një pasqyrë, ku ndeshim edhe thirrjen:

*N'dorë e merri, e këndon
lu qi dini me kënduom
Vini veshët e ndëgjoni
lu qi dini me ndëgjuom.*⁹

ku ndërkaq kalohet në një moment tjetër, që ka të bëjë me fatin e krishtëritimit në Arbëni, por edhe ku përcillet mesazhi i rëndësisë së librit, i

7 Anton Berishaj, Anton, *Lertërsia performative*, Prishtinë, Buzuku, 2010, faqe 39.

8 Pjetër Budi, *Poezia*, Prishtinë, Rilindja, 1986, f. 241.

9 Pjetër Budi, *Poezia*, Prishtinë, Rilindja, 1986, f. 253.

1. Një libër jastëku!

Janë ca libra që e tejkalojnë ndjeshëm të qenit libra dhe shndrohen në manifeste. Ndryshe, mund t'i quajmë dhe "libra jastëku", para të cilëve shndrohen në liliputë dhe librat pandemikë bestseller!

Kështu ishte për ne studentët e gjuhë-letërsisë libri "Autobiografia e popullit në vargje" e Ismail Kadaresë, i botuar në vitin 1971. Libër jastëku! Lexuar e rilexuar disa herë. Dhe jo vetëm kaq: Duke qenë nën jastëk, ai ishte i skeduar dhe i gatshëm që vetëm me dy-tre lëvizje dore të shfletohet e të mund të gjeje në të atë që të duhej... aq më tepër për ne studentët që ishim projektuar për të dhënë letërsinë nëpër gjimnaze. ...

Ishte koha kur jo vetëm ndjehej në ajër, po edhe zbarkonin në tokë rrebeshe parathënësë breshëri se "Kadareja shkruan për shijet e të huajve e jo të shqiptarëve", se "Sidomos me folklorin atë e ndan një det i tërë"!... Ndërkohë, për mendjen e formimin tim të atyre viteve, "Autobiografia..." ishte krejtësisht e kundërta: Hyjnizim i kësaj letërsie tradicionale gojore! Duke nisur që në përzgjedhjen e majasë së saj e deri në atë depërtim mjeshtëror për të zbuluar e nxjerrë në dritë të diellit arin e padukshëm të shpërndarë në tonelatat e xehërorit të artit folklorik popullor. (Vite më pas, si mësues gjimnazi, kudo do shpreheshë se, "Autobiografia" duhet kthyer në një tekst-test i domosdoshëm e i detyrueshëm në programet e degës së gjuhë-letërsisë në universitetet tona të shumta... se nuk mundet një mësues letërsie të kryejë një koment, këtë pjesë krijuese vetiake të orës mësimore, pa kaluar në praktikat e shumta model të këtij libri!) ...

Besoj që ky ishte prologu pse unë, studenti i vitit të tretë të gjuhë-letërsisë në vitin e largët 1977, kërkova që si temë parapërgatitore diplomimi pas një viti, të guxoja të formuloja si kërkesë temën: "Karakter i popullor i krijimtarisë së Ismail Kadaresë"! ...

Në nënvetëdije më brente një merak: Po sikur të ma keqinterpretojnë?... ('është ky palo student që del kundër perceptimit tërësor, veçanërisht ndaj natyrës jopopullore të Kadaresë?!... dhe, mirë që "Autobiografinë" na e klasifikoka si Dashuri ndaj popullit, po na e shtrika edhe si formim të autorit në krejt krijimtarinë e tij?!)... Po një Nënzë tjetër më përgjigjej: Fundja, ç'do më bëjnë?... një politikë penale, sepse unë hyj te ata me "biografi të mirë"! ...

Kështu u hëngra e u griva me vetveten, deri sa, pas një bisede me profesorin tonë, të mirin, Ali Xhiku, shefin e katedrës së letërsisë, i cili, pasi më dëgjoi për linjat e perceptuara shtjelluese të temës, pas një hezitimi normal, më tha: Po mirë, provo e hidh në letër kuintesencën e asaj që mot do jetë diploma jote! ...

"U tha, u bër", thonë në Elbasan!... Dhe unë, 23-vjeçari, krejt qejf e impenjim gdhiva ditë të tëra të nxija me shkrim dore, me stilograf, (ku ta gjenim një makinë shkrimi!?) në 10 letra të bardha format, temën e ëndërruar: "Karakter i popullor i krijimtarisë së Ismail Kadaresë"!...

... U mbush muaji, rodhën stinët, sosi viti dhe vjen haberi nga dikasteri: Ti, Fatmir, diplomën do ta mbrosh me temë e jo me provime, po jo me atë që ke zgjedhur... zgjidh një tjetër!...

- S'e paskam bërë mirë atë kuintesencën, profesor?!- e pyeta i drojtur e i pezmatuar, të mirin Xhiku!

- Lëre tani!- më tha shkurt profesori, shoqëruar me një lëvizje dore, si të më thoshte se më hape dhe mua telashë!

M'u kujtuan nja dy vargje të Nolit:

Aty nisi, aty pushoi, Aty krisi, aty mbaroi...

... dhe shtova:

Bir, Fatmir, i letërsisë,

Në një shkëmb të Marrëzisë!

TRIPTIK PËR KADARENË

Nga Fatmir Musaj



... Ç'të bëja?! ... M'u kujtua një libër që e kisha: "Partishmëria proletare në letërsi" e Adriatik Kallullit... E gjeta, thashë me vete! Do sajoj ca gjëra si të miat nga gjithë ai libër! Dhe, pa një e pa dy, direkt kërkesën në katedër, mo ta mo si titulli i librit. Tashmë i sigurtë për rrufeshmërinë e aprovimit!...dhe ashtu ndodhi!...

Po a më bënë duart t'i hyja një angarie të tillë?! Po sërish isha me fat!... Një miku im i gjimnazit, student në gazetari, më rekomandoi një temë diplome, tëpëkë si e imja, që e kish mbrojtur dikush para nja dy vitesh!... Kontaktua me të dhe ai, shpirtmadhi, pa e ditur plagjiaturën që do ndodhte, na e dha një kopje të temës së tij të diplomës!

Epilog: ... Na dolën dhe emërimet dhe përfundova si mësues letërsie për "stazhin pasuniversitar" në Dardhë të Librazhdit. Duhej bërë diploma! Edhe një javë kishte mbetur!... Po ku më bindeshin duart të shtypja mbi ato tastiera të dala boje mbi makinën e shkrimit (se mos kishte copy pas) të përgjegjësit të sektorit të kooperativës, Hakiut?

Sigurisht që do të ishte superplagjiaturë! Vetëm faja e parë prezantuese, ku ndryshova gjeneralitetet e Temës në identitetet e kohë, ishte origjinale! Gjithçka tjetër ishte identike, përpos gabimeve të shtuara drejtshkrimore! Përpos veshjes me një kopertinë të bukur me ngjyrë të kuqe të Diplomës rreth 50 faqe! ...

E dorëzova në ditën e fundit të skadimit të afatit! E dorëzova e mora frymë mbijetese, si një pragmatist i devotshëm! Pa më vrarë fare ndërgjegja! Madje, i vetëkënaqur për ndjenjën hakmarrëse njëvjeçare që më kish ndjekur!

... Çudia ndodhi... Isha vlerësuar me "Shumë mirë"!... Medemek 9!... E kisha hedhur bukur mirë lumin, po thjesht pa u mbytur!... se, për t'u lagur, isha qullur deri në palcë: S'm'u dha mundësia të shprehja atë që Ndjeja deri në koskë për një Idhull!...!... Kaq e vetëm Kaq!... Ma bënë e ua bëra paq!

P.S.= Tani kam dalë në pension e s'besoj se për plagjiaturën e detyruar të para 44 vjetëve do më penalizojnë!

2. Një mitik i pandreqshëm...!

Do kemi qenë në vit të tretë kur morëm vesh se kapitullin e "Letërsisë dekadente", brenda "Letërsisë së huaj", do na e jepte pedagogu i jashtëm, Ismail Kadareja!

... Të natyrshme një sërë pyetjesh e medimesh: Vërtetë?!... Vetë Ai do ulet aty në atë katedër, përballë nesh dhe do kemi boll kohë ta ç'mitizojmë?!... Po ç'ne, pikërisht letërsinë dekadente?... Mos ia kanë me kunj që i kanë dhënë pikërisht këtë kapitull të anatemuar, medemek se ai qenkësh më afër dekadentëve?... Ç'bëhet kështu? Ai është klasik e modern njëkohësisht!...

Po Ai, a e ndjen këtë mëdyshje që po e mban si Gur Sizifi mbi shpinë, lëshuar nga Zeusi dhe perënditë e Olimp të aq më keq nga hosanarat e gjindjes ndaj Barabbait?!... Si do dalë nga ky qerthull kur ta kemi përkarshi?! ...

Dhe Ai erdhi... I vetëm, i qetë deri në indiferentizëm, gjithnjë me disa minuta vonësë, i rrethuar me aureolën e heshtjes që impononte edhe mizën të mos fluturonte... Dhe asnjë mungesë në auditor, në asnjërin nga ardhjet e tij! ...

Ora e parë... Fjalja e parë... Mbetet e pashlyer, jo për privilegjin e të qenit e para, po për kumtin plot nëntekst, sikur po na kërkonte të lidhnim një pakt: - Do flasim këtu dhe për letërsinë erotike, po unë do shprehem gjithnjë "Letërsia e dashurisë"!... Ju mos harroni e nënkuptoni gjithnjë "Letërsia erotike"! ...

Heshtja u trazua nga mendimet që zhurmonin po në heshtjen më të thellë: Pse e tha?... Ç'donte të thoshte?... Ç'është ky kod që na kërkon?... Gjithësesi, ai ka besim te ne, ndaj na e tha e ndaj na e kërkoi këtë pakt!...

Dhe ne do të dimë ta mbajmë paktin!... Se ai do të na përumbë në të fshëhtat e Dashurisë, në nënshtresat e asaj që s'duket, duke e zhveshur Dashurinë e paskajshme, si një Frojd, deri te thelbi i saj, arti Erotik! ...

Një ditë, nuk e di se si e qysh e pse, mora vesh një të vërtetë a thashethem, (e ç'rëndësi kanë për mitet të tilla detaje!) se vetë dekania, gruaja Ballvora, me kast

kishte kaluar nga korridori i përhershëm ku kalonte Ai dhe i kish thënë butësisht:

- Shoku Ismail!... Mundohu të vish në kohë në leksion!...

Thonë se Ai kishte tundur kokën vertikalisht me një Po të nëpërdhëmbur! ...

Perënditë kishin tështitur! ...

Ai u largua pas tre muajsh dhe s'e pamë më! ...

... Më mitik se sa kur na kërkoi një mirëkuptim për kodin e Dashurisë!

3. Një shans i humbur!

Ka qenë viti 1977 kur m'u botua libri i parë, "Thirrja e jetës"!

... Ndjesi të papërjetuara për një student!... "U bëra poet, shkrimtar!" (Ndonëse më pas, pas 41 vjetësh, vetëm katër poezi nga "poeti i dikurshëm", "e merituan" të kishin një copëz vend në librin "e trashë" me poezi të përzgjedhura! Bashkë me titullin e pazhbëshëm, alla realizëm socialist, "Thirrja e jetës"!

(Duhet optimizëm që në krye të librit, më thoshte Fullani i të vetmes Shtëpi botuese të asajkohe!... Ja, në Elbasanin tënd i ke Metalurgjikun! Atje është jeta që të thërret!...) Dhe, për një çast, unë dyshova se mos do jepja letërsi për metalurgët që do ndiqnin gjimnazin natën apo me korrespondencë! ...

Po befasia më e madhe, në përmasat e lumturisë, ishte ajo çka më tha shkrimtari i shquar, në atë kohë redaktor në gazetën "Drita", Vath Koreshi... Ja, e perifrazuar, ç'kishte ndodhur:

S'dihet se pse kishte kaluar Ismail Kadareja nga zyra e madhe e redaktorëve dhe mbi tavolinën e Vathit kishte parë disa libra të poetëve të rinj. Pas një shfletimi të shpejtë, tërthorazi e në këmbë, kishte përzgjedhur dy libra, "Thirrjen" time (Thua, vallë, ta thërrisja!?) dhe librin e dikujt tjetër... Do të shkruaj për këta, i kishte thënë Vathit dhe i kish marrë me vete të dy librat.

Kaq më tha Vath Koreshi, po te unë kalli një drithërimë!... Të shkruante vetë Ai për librin tim, aq më tepër që ishte dhe i pari?!... S'kishte rëndësi sa do të të inkurajonte a lavdëronte apo dhe të të masakronte! (Mjafton që rrufenë e hedh Zeusi i letërsisë, edhe pse rrufe...)

Ndjeje një si vetëpërkëdhelje, një si vetërendesë brenda qenies tënde që të jepte më tepër siguri edhe kur hidhje hapat në rrugë. Dhe, nëse për poezinë deri më tani kishe harxhuar X kohë, tashmë ajo padyshim që do dyfishohej, do bëhej më pretenduese e sqimatare, do ishte Dikushi mes emrave të njohur të rretheve e qarqeve letrare! Ishte një start i privilegjuar për më tej, nëse do të kishe këllqe! Se libra botoheshin jo pak dhe atëherë, po me pikatore gjeje ndonjë prononim nga Ai! ...

S'ishte asgjë botimi i një libri, qoftë ky dhe i pari, para një shkrimi që Ai do të bënte për të! Do të ishte si një pagëzim... do të kishe kumbar vetë Atë!... Dhe horizonti më dukej më i madh atje tej, dhe veten e shihja në një kladeoskop ngjyrash! ...

...- Ah, mor qyq! Të rroftë emri kompozitë, Fat-mir, që ke!- i thoja vetes më pas, kur kaluan ditë e javë e kaloi dhe muaji e Vath Koreshi vetëm ngrinte supet, sikur të thoshte: "S'ka sjellë gjë! Kushedi ç'i ka dalë!" ... Dhe as unë s'i thashë t'ia kujtonte, dhe as ai s'e mori një zotim të tillë!... edhe Vath Koreshi s'duhet të ketë qenë i shpenguar para Atij që "kthjell e vran" e që i din vetë punët e veta!

... Vitet u bënë dekada e dekadat po kapin gjysmëshekullin, po te unë ende ka mbetur pengu i hershëm e i them vetes: - S'ke shans, or qyq! Edhe një herë që qëllave në vendin e në kohën e duar, fati s'ishte me ty! ... Të të rrojë ai emër grotesk që të kanë vënë!

MESDHEU LINDOR, një roman nga Ivi Meleagrou

Përktheu Isida Foci

Mesdheu Lindor (1969) i Ivi Meleagrou mund të konsiderohet si kulminacioni i parë i rëndësishëm, një kërcim i madh si në prozë, ashtu dhe tek romani i shkruar në Qipro gjatë shekullit të 20-të. Eksperimental, fragmentar dhe shpesh i vështirë, me mësim nga tradita evropiane e modernizmit dhe e Romanit të Ri francez (e ashtuquajtura “Shkolla e shikimit”), me një gjuhë narrative shumëformëshe, zakonisht ironike dhe metaforike, thotë pak e fsheh shumë. Duke vlerësuar narrativën shumëdimensionale, shkrimtarja përpiket t'i tregojë ngjarjet në mënyrë shumëplanëshe dhe ndërthur kuadrin erotik të trillimit me elementë nga kuadri historik qipriot të viteve 60.

Edhe pse struktura tematike dhe rrëfimtare e romanit fragmentohen dhe përhapen me mënyra moderne të retorikës, shumë elementë ndërthuren dukshëm me çaste të historisë qipriote të kohëve të fundit: Lufta çlirimtare përkujtohet kryesisht në rreshtat e shkruara nga i riu Kornaros në çastet e fundit të jetës, para se të varej nga kolonizatorët britanikë. Ngjarje të tjera, si konfliktet e para të përgjakshme midis qipriotëve grekë dhe atyre turq në verën e vitit 1958 akumulohen në mënyrë të përsëritur, me aludime dhe heshtje, kthehen me këmbëngulje dhe në mënyrë torturose në monologun dhe rrëfimet e panjohura të shpirtit të heroinës qendrore, që shpesh lënë gjurmë me elementë të theksuar tipografikë, madje dhe në të gjitha llojet e rrëfimeve të mëpasshme, si rrëfimi i Anthusës. Gjithashtu, veçanërisht në bisedat politike midis dy avokatëve të romanit, Ionas dhe Jorgo, preken kushtet problematike të Zyrihut dhe Londrës, nën të cilat parashikohej themelimi gjasme i pavarur i Republikës së Qipros, por në thelb i varur dhe i cunguar, ndjenja e zhgënjimit që mbizotëronte në shtetin jofunksional të Qipros, planet e qeverisë Makariu për ndryshimin e Kushtetutës me të ashtuquajturat trembëdhjetë pika, duke arritur kulmin me shpërthimin e konflikteve ndër rajonale në prag të Krishtlindjes së vitit 1963. Paralelisht ndërfiten dhe rrëfime, eksperiencia, kujtime, aludime që i referohen periudhave kohore më të vjetra p.sh. në forma të historisë antike qipriote (Kiniras, Evagoras, Onisilos), në martirizimin e Vragadinos gjatë pushtimit së Famagustës nga Turqit në 1571, në varjen e “dhespotit”, dmth. të kryepeshkopit Kiprianos, gjatë ngjarjeve të përgjakshme të 9-të Korrikut 1821, etj. Të gjitha këto skicohen dhe ndërthuren me mënyra të shumëllojshme retorike në strukturën narrative të romanit, ndërthurur bukur dhe me trillimin.

Shkrimtarja zgjedh të hedhë dritë mbi ngjarjet kryesisht nga këndvështrimi i Margaritës dhe së dyti me syrin e xhaxha Ionasit. Fokusohet më pak tek Nikita, tek Frini dhe tek Kornaros. Në pjesën më të madhe të librit rrëfimi është i fokusuar në personazhin e Margaritës, e cila lëviz me makinë në qytetin e vjetër të Nikosias, kryesisht në anën veriore të tij, të rrethuar me mure veneciane. Fikson me sytë e saj monumente dhe ndërtesa të njohura (mure veneciane, hendekun, Kishën françeskane, Portën e Kirenias, statujën e Ataturkut, Sheshin Ataturk, kishën mesjetare të Shën Sofisë, Xhaminë Bajraktari, Portën Pafos etj.), dhe njëkohësisht përpiket të zhytet thellë në mendime dhe të kthehet pas në kohë, për të nxjerrë në pah ngjarje dhe ndodhi që kanë shenjuar jetën politike të vendit, por edhe të sajën: Në pjesën e parë të romanit jepen copëza nga masakrat e grupimit të grekëve të Qipros, nga fanatikët turq të Qipros, të cilat u bënë me nxitjen dhe kontributin e kolonialistëve britanikë në Qershor të vitit 1958 midis fshatrave Kioneli dhe Kodemenos. Bëhet fjalë për një shembull elokuent të politikës koloniale të “përça e sundo”. Ndërsa Margarita përshkon fushën nga Nikosia për në Kirenia, rikrijon në mënyrë imagjinare përpjekjen e ankthshme të qytetarëve të pafajshëm grek për t'i shpëtuar masakrës duke vrapuar herë midis barishtesh të dendura dhe herë midis peisazhit lakuriq, që nuk u ofron atyre mbulim dhe mbrojtje. Në skena të tilla kthimi të brendshëm, Margarita kthehet tek vetja dhe pajtohet me egon e saj të dyzuar, Elenën. Duke përvetësuar teknika të ngjashme të shkrimtarëve modernistë dhe të Romanit të Ri francez (p.sh. të Klod Simon dhe të Samuel

Beket), Meleagrou vendosi të fiksojë me ngjyrë të kuqe pjesë të botës së saj të brendshme dhe ballafaqimin me egon tjetër, që funksionojnë si valvula sigurie për të kontrolluar fobitë, obsesionet, traumat e fëmijërisë dhe dëshirat e pathëna.

Në fokusin dhe në perceptimin e Margaritës ndërthuren në mënyrë të përsëritur “të tjerët”, “ata” domethënë turqit e Qipros por dhe turqit në përgjithësi, që kurrë nuk u vunë emra. Heroina riprodhon në mënyrë të përsëritur figurën e “tjetrit”, të bashkëpatriotit turk që dikur ishte i mirë dhe filloi të kthehej në armik, sepse një figurë e tillë është formësuar në periudha kontradiktore dhe dëshmon izolimin midis dy komuniteteve të mëdha të Qipros. Anthusa nuk mund t'i quajë veçse fanatikë turqit e Qipros, të cilët i therën të atin, një bari paqësor. Por edhe Margarita nuk mundet veçse t'i shohë me dyshim dhe frikë turqit, teksa vërtitet në të tashmen narrative (1963) në sokaqet e Nikosias së vjetër. Sjell në mendje greqishten e çalë të barinjve turq, e cila i dukej e panjohur dhe komike, të paktën në një fazë fillestare. Fillimisht hezitoi t'u afrohej, por më pas tregon se është në gjendje të përmbysë stereotipet e ngurtësuar në lidhje me kombin: “Atëherë ata buzëqeshin dhe ndryshojnë, nuk janë as më të zeza, as më ndryshe fytyrat e tyre, gjuha fillon t'i pëlqejë... i pret, i qeras, blegërijnë përreth delet, bëhet një botë tjetër”. Heroina rikthehet në të shkuarën për të kërkuar figura pozitive nga bashkëjetesa paqësore e grekëve me turqit: Ngërthen me shikim një ngjarje festive pranë Portës së Kirenias (me zurna, daulle dhe thika, dhe kujton një vizitë me të fejuarin e saj, Jorgon në “Teqenë e Dervishëve” dhe shijuan të gjitha ushqimet e tyre (“kadaif, llokume, mish”). Kthehet pas në kohë, në moshën e fëmijërisë, për të kujtuar vizitat që

bënin në hamam bashkë me të ëmën dhe sjell në mendje formën, fjalët dhe gjestet e Havasë, turkes që i lante dhe që punonte për “zbulimin” e trupit femëror dhe zgjimin e erosit tek një fëmijë i vogël.

Me të njëjtën mënyrë e mundon dhe mendimi se grekët dhe turqit kanë atdhe të përbashkët. Një ndjenjë tërheqjeje dhe largimi, pra për të kornizuar mosmarrëveshjet e përshkallëzuara midis dy bashkësive të mëdha të ishullit, që këto vitet e fundit nxitet nga politika zyrtare turke (por edhe nga kolonializmi britanik) dhe që parashikohet në mënyrë profetike. Diku, heroina lexon në heshtje një publikim me pozicionet turke dhe ndërhyrjen kërcënuese të Turqisë në Qipro: “E konsiderojmë ndërhyrjen në ishull si kismet. Nëse nuk bëhet nesër, do të bëhet pasnesër. Ky nuk është vetëm urim, por edhe besim”. “Ishulli i gjelbër është yni. Nuk do ta shkelin të huajt. Kur të lëshohet parrulla, ushtarët trima të Allahut...”

Por tashmë në *Mesdheun Lindor* është e dukshme përpjekja e shkrimtares të korrigjojë dhe të përmbysë stereotipat kombëtarë, imazhin e turqve të izoluar, duke u përpjekur nëpërmjet heroinës të përshtasë në mënyra të ndryshme karakterin, pamjen, zakonet, fjalimet e besimtarëve të feve të tjera, të rracave të tjera të ishullit. Natia Haralabidu me të drejtë ka komentuar se “Meleagrou nuk i referohet me vetëdije skemave stereotipe. Kështu i ka parë heroina e saj, kështu ishin gjërat për të dhe me sinqeritet shprehu në këtë mënyrë ndjesinë e izolimit, të shkaktuar nga “ndryshimi”.

Meleagrou u përpoq dhe pati sukses në dhënien e atmosferës psikologjike, klimën e pasigurisë politike, përgënjeshtrimit dhe asfiksionit në vitet e para të Republikës së Qipros, kur kishte filluar të dukej se kushtet e themelimit nuk ishin aspak funksionale. Paralelisht me këtë çështje, e cila reflektohet edhe në marrëdhëniet e trazuara mes grekëve dhe turqve të Qipros, bashkëekzistojnë dhe çështje të tjera jetike, përgënjeshtrimi erotik dhe izolimi bashkëshor, stresi ekzistencial, pesha e së kaluarës historike etj. Lufta e Qipros e ngulitur me referenca kalimtare, të shpërndara në të gjithë romanin, tregohet veçanërisht përmes shënimeve të ditarit të Kornarit. Por këto nuk përkthehen në çaste heroike të Luftës, por shfaqin shqetësimet, luhatjet psikologjike dhe fytyrën njerëzore të një të riu që do të vdesë.

(Vijon nga faqja 7)

nevojës për ta vlerësuar dhe përthithur atë, sidomos në kuaternën e përveçuar, që e sollëm në këtë ligjëratë, si fakt të lavrimit të poezisë unike të poetit.

Në poezinë e nëntëmbëdhjetë të librit të parë që trashëgojmë nga shkrimtari, e cila ka vetëm 23 vargje, kemi edhe situatën e mëposhtme, e cila thellon praninë e rrafshëve të subjektivitetit të gjurmëve të poetit:

*Qi më dhe kaqë hir
Këtë kafshë me mbaruom,
Si e paqë zanë fill
Gjithë herë tue shkruom.¹*

Në këto vargje të hapura si kumt ndeshim një linjë të shqiptimit të pastër të marrëdhënies së poetit me aktin e shkrimit, të poezisë që shqipton shestimet e poetit, të shqiptimit të ngasjeve kreative thelbësisht subjektive, e cila mundëson projektimin e ngjyresave personale. Një situatë e afërt ligjërimore shfaqet në vargjet e poezisë së tretë, që gjendet te libri *“Pasqyra e t’rrëfyemit”*, e përbërë nga 117 vargje gjithsej, ku ndër të cilët veçuan:

*Nd’ Arbënë me ua dërguom
Sikur një pasqyrë,
Ndë të cit tu shkruom,
Të nçilen ma mirë,²*

Kuaterna e kësaj poezie të njëmendtë si shenjëzim autorial, sërisht vendos pika kontakti me vendin/Arbënë, si dhe me dobinë e kundrimit të librit/vargjeve, si një pasqyrë e shoqëruar, me përthyerje shëmbëllimi, që përpos të tjerash ndikon fuqishëm për ta kuptuar botën përqark. Te poezia e vetme që gjendet në *“Rituali Roman”*, me 39 vargje 16-rrokëshe apo me 8-rrokësh të dyzuara, ndërkohë që aty rimerret shqetësimi i autorit për besimin në Arbëni:

*Këtë kafshë me mbaruom: qi e paqë për detyrë
Natë e ditë tue shkruom: zemëra më gjet’ të lirë,
Shokëvet me ua dërguom: sikur një pasqyrë,³*

Në vargjet e kësaj poezie, nga më të veçantat në trashëgiminë poetike të Budit, e cila përçon dy ndryshime thelbësore në poetikën shkrimore, si mënyrë vargëzimi, me shkrimin e vargjeve monokolorë, si dhe kapërcimin e stilemës së tetërrokshit në tetërrokësh të dyfishtë, ose të një sitleme poetike me 16-kësh, rimerret situata e vlerësimit të librit/poezive, që e ndeshim edhe në poezitë e librave të tjerë.

Pra, ngasa vihet re, prej shtjellimit vetëm në rrafshin e poezive origjinale, që nuk kanë asnjë lidhje me përkthimin apo përshtatjen, vihet re se pesë poezi dhe 475 vargje janë të Budit, madje në mënyrë të padiskutueshme. Trashëgimia tjetër, e shkrimit poetik, që gjendet në tre librat e autorit, e huamarrë apo e përkthyer, si një pistë hipotetike, që deri më tani nuk ka marrë përgjigje të argumentuar, është rishkruar në poetikën e tetërrokëshit trokaik, duke mishëruar kështu tiparet e poetikës së shqipes së autorit. Në këtë logjikë, e gjithë trashëgimia poetike në gjuhën shqipe, me gjasë e përkthyer/e rikënduar nga motivet e Biblës, Dhjatës së Vjetër apo asaj të Re, vjen e shqiptohet më tepër si e rijetësuar, madje që bartet në të gjithë pentagramin e poezisë shqipe të mëvonshme, veçmas si poetikë e tetërrokëshit.


Literatura kryesore: Budi, Pjetër: POEZI, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë 2006.

- Riza, Selman: *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, (shkruar në vitin 1964 fillimisht si tekst universitar), botuar në vitin 1996 në Prishtinë dhe në vitin 2002 në Tiranë, nga Shtëpia Botuese Toena.
3. Papas Gaetano Petrotta: *Popolo Lingua e Lett. Albanese* (Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare), Tipografi Pontificia – Palermo, 1932.
- Historia e Letërsisë Shqiptare*, botim i Akademisë së Shkencave, tekst universitar, Tiranë 1976.
- Roques, Mario: *Gjurmime mbi Tekstet e Vjetra Shqipe e shkrime të tjera*, Botime Françeskane, Shkodër 2011.
- Pjetër Budi*, botim i Muzeut Historik Kombëtar, Tiranë 2008.
- Berishaj, Anton, *Lertërsia performative*, shtëpia botuese BUZUKU, Prishtinë, 2010
- Hamiti, Sabri: Shkollat letrare shqipe, <https://www.scribd.com/.../SHKOLLAT-LETRARE-SHQIPE-Albanian-literary-school...>
- Gjoka, Behar, *Poetika e Budit*, Albas, Tiranë 2002.

1 Pjetër Budi, *Poezia*, Prishtinë, Rilindja, 1986, f. 263.

2 Pjetër Budi, *Poezia*, Prishtinë, Rilindja, 1986, f. 277,

3 Pjetër Budi, *Poezia*, Prishtinë, Rilindja, 1986, f. 281.



Shpejtësi maramendëse dhe kapërcime Spindarike nëpër kryeqendrat e botës aktuale dhe me raste prapa shikuese tek tempujt muzikorë të Europës juglindore, solli Amir Xhakoviqi, pianist i vërtetë e përfaqësues model i shkollës sonë të artit muzikor në një mbrëmje nga të parat që po organizohen për të festuar 60 vjet nga çelja e Konservatorit shtetëror të Tiranës, më 15 të janarit 1962, sot Universitetit të Arteve.

Një Recital i denjë për të demonstruar në tastierën e pianos, pa fjalë por thjesht e shkoqur, një rrugëtim sinjifikativ që në këtë rast është fatlum, dinjtoz dhe avancues për shkollën shqiptare të artit të kufijve të hapur.

Amir Xhakoviqi është tashmë një artist mbi të 30-tat, i afruar herët me muzikën, fillimisht në qytetin e tij Shkodrën, ku burojnë pandalë talente dhe i plotësuar më pas në klasën e sprovuar të mjeshtres së mirnjohur të tastierës, Prof. Anita Tartari, pjesë e memories historike të shkollës që po i festohet jubileu.

Gjatë viteve të shkollimit, që herët i paraqitur në konkurset për pianistët e rinj si "EPTA" në Tiranë në dy edicione, vlerësuar me çmime, si dhe "International Competition" në Prishtinë ku fitoi Çmimin e parë. Gjithashtu fitoi po Çmimin e parë në Cetinje të Malit të Zi, në "Konkursin e Republikës".

Nëpërmjet një cikli specializues në klasat dinjitoze limitrofe të profesoratit pianistik si Boris Kraljeviç që me një recital të tijin në skenën tonë, vite më parë, na entusiazmoi të gjithëve. Më pas tek Vladimir Boshkarjov dhe Aleksandar Serdar, për të mbyllur mjeshtërizimin e tij në klasën e pianistit amerikan Alan Weiss, më 2012 në Lemmensinstituut, në Belgjikë.

Intensifikoi karrierën e tij koncertore përmes pjesëmarrjes në festivale të ndryshme pianistike ku më dinjtozet janë tre edicione të "F. Chopin" në Tiranë, "Ulta Padum" në Pavia – Itali, "Pranvera e kulturës greke", "Cikli koncertor i pianistëve të rinj" në Podgoricë, Stina Koncertore e Universitetit të Arteve në Tiranë, "Koncertet e muzikës bashkëkohore" në Podgoricë, me kuartetin ndërkombëtar "Joy of Music" (me veprën e Olivier Messiaen), në vijim si solist me Orkestrën Simfonike të RTSH-së, si dhe një tur koncertor në Japoni.

Aktiviteti i tij solistik është spostuar këto vite nga skenat shqiptare edhe në Kosovë, Mal të Zi, Serbi, Greqi, Itali, Belgjikë e Hollandë. Ka vijuar pjesëmarrjen në workshop-e me emra të shquar mjeshtrore si Natalia Trull, Norma Fischer, Frederic Rzewski. Kohët e fundit përfundoi studimet e doktoraturës në Universitetin e Arteve në Beograd në klasën e Prof. Aleksandar Serdar.

Përveç karrierës koncertore, Amir Xhakoviqi është lektor me kohë të plotë në Universiteti e Arteve në Tiranë.

Ky prezantim "briefly" i CV së protagonistit të Recitalit në mbrëmjen e 6 prillit 2022 në hollin e shkalladës të hyrjes në Universitetin e Arteve, është i domosdoshëm jo vetëm për një prezantim publik të tij, por dhe pse nëpërmjet rreshtave numëruese të një jete dedikuar bukur fort muzikës, evidentohet aliazhi që përbën suksesin profesional, në rastin tonë, kur subjekti i përshtatet gjatë regjimit klasë – skenë, edukim shkollor rezultativ në maksimumin e mundëshëm në vendin e tij, më pas mjeshtërimin të hapur në praktikumet ndërkombëtare e kudo ku mundësohen ato, nga afër shumë deri në largësitë kontinentale.

Nisja recitalore...

Nën një heshtje të urtë dhe me një përkushtim vështrimqartë drejt realizimit, Amiri që ndërkohë kishte kapërcyer mbylljen pandemike jo kollaj, shpërtheu

RALLY PIANISTIK I AMIRIT – PEIZAZHE PIANISTIKE NGA BALLKANI

Nga Zhani Ciko

atë mbrëmje, si kurrë më parë një "bëmë muzikore" që prezentët në sallë i mbërtheu nga vepra në vepër deri sa pa mëdyshje, në fund e mbushën vlerësueshëm me duartrokitje entusiaste, ekslamacione shpërthyes dhe shkrepeje fotografike.

Prurja për publikun në sallë dhe një vështrim i domosdoshëm për 'të'

Fillimet e shekullit të XX evidentuan tendenca rinovuese në krijimtarinë muzikore. Shkollat kombëtare kishin sjellë prurje pasuruese veprash të autorëve me identitet të spikatur që buronte nga bazamenti i përkatësisë nacionale, aftësitë profesionale për ta përdorur këtë premisë dhe sidomos forcës së talentit që e transformonte këtë materje në "Vepër arti" me përkatësi autoriale dhe përfaqësuese në fondin muzikor botëror.

Por shekulli që mbylli vitet '800, me këto prurje të mbara, konsumoi në masë të ndjeshme elementë të sintaksës, stilit përkatës e sidomos formës, që krijuan edhe mpirje të venës ushqyese të inspirimit dhe fertilitetit prodhues. Fillimi i viteve '900 kristalizoi rrugë të reja krijuese, shkolla mjeshtërore me numër identifikues si ajo e Vjenës II, degëzime postromantike, ekspresioniste, ku më evidente u bënë ato tendenca që u identifikuan pak nga pak si "Muzikë e Re".

Në shekullin e XX krijuesit në vendet gjeografikisht lindore dhe ato të juglindjes evropine, aplikuan qendrimin në dukje më komod, të një muzike që qendronte dhe e kërkonte risinë në sintezën mes "Lindjes dhe Perëndimit". Këtë pozicionim poliedriku rumun e francez George Enescu e emëroi shkurtazi si "L'esprit de temps" (gjuha shprehëse e kohës). Është gjithësesi, një sintezë arti e epokës që përjetohej përditësisht me kulturën muzikore der' atëhere të realizuar, që përbënte traditën. Për dikë kjo amplitudë shtrihej nga kultura arkaike deri tek ajo savante, që nënkuptonte kulturën e madhe instrumentale dhe orkestrale Evropiane, sintetikisht thënë "një procedim i ri i shprehshmërisë përmes një gjuhe muzikore të re".

Një tjetër savant, hungari Bela Bartok dhe system-krijuesi Zoltan Kodaj, arkaizimin e besuan si të vetmen rrugë për ti bërë krutazhin shtresës muzikore të të ardhurve nomadë me kombësira të stërlargëta që kishin invaduar muzikën hungareze të '800-shit, që patriarku i madh, europeisti Ferenc Liszt e kishte imponuar atëherë me veprat e veta, i tërhequr më shumë nga sharmi se sa nga mendimi. Për këtë Bartoku ndërmori një udhëtim gadishullor në kërkim të rrënjëve të "musica hungarica" me metodën krahasimore për të identifikuar ato elementë modalë e ritmikë që i shërbenin purifikimit të gjuhës muzikore, sa më afër rrënjëve të stërlashta

hune. Atë e mahniti sidomos ritmika e pasur, sa që u kënaq shpejt me gjetjet dhe u ngut siç dihet, duke nominuar si "bulgar ritmus" një formulë që në folkun shqiptar ka trajta më të pasura sesa tek "vëndasit" e dyndur më vonë në trojet e zaptuara ku jo shumë larg gjendeshin Ilirët autoktonë.


Duke folur për pasurinë ritmike të etnoseve gadishullore, ekzistenca paralele e ritmeve nën ndarëse, (fr. divisionaire) pra milimetralisht të disiplinuar, njëherësh me ritmet e lira e të çliruar, si ato që përcaktohen me termat "rubato" apo "ad libitum" në muzikën e kompozuar kudo, tek ne gjen dhe struktura që qendrojnë pa ndarjen e masave, si psalmoditë bizantine, po që nuk kanë asnjë lidhje modale dhe as historike me to. Duke ekspozuar të tillë elementë, duket se shtrojmë tezën e një "gjeometrie muzikore" që gjendet vetë, pa u sajuar, në muzikën e rajonit tonë.

Për të mos u përsiatur më shumë tek elementët e përbashkët të multietnikës ballkanase, si ekzistencën e asaj që quhet "eterofoni" në parashtrimin elementik melodik në dy trajta horizontale, bashkëjetuese e stërllashtë me vertikalishtin e shumëzëshit (polifonisë), që ne e kemi element të krenarisë, por që ekziston në trajta qartësisht të ndryshme dhe tek popujt e tjerë, vijmë dhe tek një tipar karakterizues i temperamentit tonë rajonal në muzikë dhe pavarësisht saj dhe në koreografinë tonë, "Virtuoziteti" në ekzekutimin instrumentor popullor individualisht apo edhe atë të formacioneve, si përdoret rëndom, orkestrinave propullore, a thjeshtë, "sazeve".

Emra të mëdhej të muzikës së re të etnikave muzikore juglindore Evropiane, i gjejmë krahas Eneskut e Bartokut dhe tek të tjerë krijues përfaqësues të shfaqur më pas, disa prej të cilëve morëm pjesë dhe në "Rally"-n e Amirit në "Peizazhe pianistike nga Ballkani.

Kthimi në holl

Koncerti Recital i Amir Xhakoviqit është vërtetë një ekspozë peizazhesh që lexohen sapo shpalos fletë programin e mbrëmjes. Dalja e tij solli menjëherë zbulimin e peizazhit të parë me përkatësinë e një krijimi nga Atdheu i ynë, madje, nga qyteti i tij i lindjes, Shkodra. Mbase rastësia e çoi të qëmtojë krijimin me titullin tërheqës të kompozitorit Aleksandër Peçi "Barokjare". Predispozohesh të gjesh një sprovë të kompozitës që ka vendosur në matricullën e krijimit autori dhe që në shpalosjen e seksionit të parë dëgjon se sa vijimësi ka mes një materjali që për nga linja përshkuese dhe ornamentika sjell trajta të një "anonimi" të lagunës së brigjeve perëndimore, Venetisë, me një kadencim të kantikut të pa identifikuar nominalisht, por të tipologjisë "Jare shkodrane". Është interesante dhe analiza e ornamentikës, herë si pjesë stilistike dhe here si melodizim emocional.



Amiri i ka zbuluar drejt karakteristikat e gjuhës muzikore dhe i qendroi deri në fund asaj çka ai gjeti në 97 masat e veprës.

Pas peizazhit të parë lirik e meditativ, në "Tre etyde mbi ritme popullore greke" të kompozitorit Yannis Constandinidis, solisti nëpërmjet përcaktimit autorial *Allegro veloce*, vrapon dhe hidhet mbi ritmin gjithëballkanik 7/8, formalizuar në treshen *legato* të lëvizjes së parë, me *quasi staccato* të dy lëvizjeve që kompletojnë masën. Ky fluturim stresues për solistin dhe zbavitës për dëgjuesin të rrëmben në Preludin fillues. Duket sikur vërtetë pianisti përshkon me shpejtësi superstonike 700 km ajrore që ndajnë dy kryeqytetet tona. *Intermexo* pasuese e këndueshme dhe me laryshi kompozimi, që edhe pas mbi gjysëm shekulli që na ndan nga krijimi, ruan freskinë e gjuhës harmonike që në këtë kohë del më pah. Kërkesa për një zotrim të lojës instrumentore dhe shikimi të qartë në të gjitha skutat, që përmban *Toccata* përmbyllëse e ciklit të tre etydeve, të sjellin në bindjen se Amiri nuk i është shmangur për asnjë çast komplikimeve që sjellin veprat e shekullit të modernizimit muzikor, jo në shembullin e rrymës ekstreme të stokastikës së greko-francezit Xenakis, por të një krijuesi që nuk i tutet mardhënies me interpretuesin. Xhakoviqi i ka qendruar përballë me guxim. Pasazhi i masave të fundit, kinse *meno mosso* (pak më ngadalë) duket i rremë sepse nis me një kaskadë oktavash të komplikuar harmonikisht, ndjekur me një *accelerando molto* (shpejto sa më shumë), që vetëm një zotërues i teknikës së lartë, e përballon pa ju marrë mendja mbylljen, deri ne largimin e vrullshëm të duarve, ndërsa instrumenti vetishëm vijon të vibrojë, nga potencia e goditjeve të akumuluar.

Kur Pancho Vladigerov, kompozoi më 1951 Simfoninë e tij që meritoi çmimin Dimitrov "Poemë ebraike" Op.47, Dimitri Shostakoviç u shpreh se "vepra të tilla shkruhen një herë në 100 vjet" dhe po aq vlerësues për krijimtarinë e bullgarit ishte dhe Richard Strauss, Alexis Weissenberg, David Oistrach dhe somitete të tjerë të shumtë. "Improvizim" Op.36, Nr.4 është një pjesë koncertore nga ato që zakonisht i pëlqejnë dhe publikut dhe atij që i interpreton. Duket sikur pas veprave që shpallin kërkimin e muzikës së re, koncertistëve që i interesojnë mardhëniet e mira me të gjithë krijuesit, përfshijnë në Recitalin e tyre dhe një vepër komode, jo për atë që e luan, por për dëgjuesin që merr emocionin që mbase i mungon veprave ku kërkimi i së resë është në kredon e tyre.

Udhëtimi nga peizazhi i gjelbër pllajor bullgar në brigjet e thepisura e majat e paharritëshme të Malit të zi, zgjat gati 400 km. në vijë ajrore, por mes nesh ai është i kalueshëm edhe "më këmbë". Në këtë udhëtim piktoresk, ku mes shtresës gjethore rrjedh pazhurshmë një vijë ujore kromatizmi muzikor, në intervale

kohore përherë më të ndjeshme e frekvente dëgjohen nga lart goditje të një breshërie *inquieta* (të shqetësuar) si e kërkon autori, që vijojnë të bjerë gjatë gjithë kohës, më e përthyer ritmikiisht. Ndërsa linja e dorës së majtë, shumë e artikuluar e me një tingëllim të largët, pa u vënë re, rrit prezencën dhe fillon të egërsohet, goditur vertikalisht nga breshëritë që tashmë nuk duken si fenomen natyre, por të bëjnë të kuptosh se janë armë dhe ti ndodhesh në një zonë rreziku, e ku një kapërthyerje e linjës trashedente (rjedhëse horizontalisht) por që tashmë kacaviret majash me arpezhet e çrregullta, ndeshet me breshëritë e egra, si të një kallashi gjëmë ndjellës. Drejt një fundi tragjik, që mbas një *fortissimo*, shpejt kalon në kërkesën "me të gjithë forcën e mundëshme" e përshpejton ritmin drejt arpezhimit të rrëmbyer që mbërrin nëpërmjet 3 forteve, fff majën ku s'ka më. Ajo çka vjen fill, nuk është një rënie, as një shkarje, por një hedhje e qëllimshme tragjike. Jemi në mars 1990... Senad Gacević e ka titulluar këtë krijim të tijin, të pa shoq në literaturën pianistike, thjeshtësisht Tokata (afërsisht thënë: Prekje). Ecce homo! E theksoj, jemi në '90-tën. Në Ballkan nuk hyesh e dilesh pa gjak e vuajtje. Ajo që ndodhi më vonë me autorin e këtij jo peizazhi, por filmimi nga episode frekvente asi kohe, është tashmë eposi i bashkë vuajtjes.

Me hapjen e dyerve mes fqinjve që jo rrallë kishin dhënë e marrë, pa ardhur koha e ngujimeve të mëdha. Prof. Senadin e patëm disa herë mes nesh dhe madje pak më vonë edhe në Prishtinë, me funksionet e tij pedagogjike, muzikologjike, krijuese, personale dhe ndër-rajonale, ashtu si koha i mundësoi, bashkë me vullnetet e njerëzve që kishin ëndëruar dhe kontribuar për tu "parë e pyetë". U shkëmbyen vlera dhe u mësuan të shkuarat, si rrëfimi muzikor që zbuloi *Tokata* e tij. Kuptuam se e keqja nuk ndodhte vetëm në një anë dhe u afuam dhe më miqësisht. Të gjitha këto mi tha atë mbrëmje shqiptari Amir Xhaković me pianon e tij, i admiruar në mbylljen e pjesës së parë, nga publiku gjatëduartrokitës.

Një kartëvizitë e muzikës pianistike shqiptare, *Tokatë për piano*, ngjizur në vitet e para të jetës së Konservatorit që rriste krijuesit gjithashtu të parë, si kompozitori ynë Feim Ibrahim i më 1962, sjellë në formën përfundimtare më 1968. Ajo është vetë mbajtur gjallë "kurdo dhe kudo ku luhet piano tek ne". Ka krijuar një traditë të sajën. Përfaqëson një nga autografet

muzikës shqiptare, sepse është e formuar me materialin ritmik e modal autentik, nuk komplikohet në asnjë rast artificialisht dhe ka një "shenjim" dallues të shkëlqyer, siç është kalimi surprizues i goditjeve perkusive në pazicion të hapur, që ndërrojnë fakturën e ritmit daullor – vallzues në goditje gjëmimi paralajmërues, për diçka tjetër që pritet të ndodhë. Dhe vërtetë, fillimisht ritmi daullor përzihet me nisjen e një strofe kënge që e mbyt ritmi daullor, deri sa forca e tij ezaurohet nga një përshfaqje në gjendje ekstaze *esspresivo*, shkruan autori në partiturë dhe që vijon me dilema që shtrohen njera pas tjetrës pa gjetur përgjigje, deri sa derdhen përfundimisht në vallen marramendase e dominuese.

Amiri e përfshiu veprën në hapjen e pjesës së dytë të programit. E kundroi jo si një interpretim repetitiv të asaj çka kanë sjellë paraardhësit e tij të tastierës, por qëllimisht nuk i mëshoi as bravurës së tij superiore, e as një vërshimi tingëllues prepotent, përkundrazi e përkori atë dhe për mua, e pa veprën si krijesën që më pas do shpërthente në Koncertin Nr. 1 për piano dhe orkestër. *Tokatë* paska qenë filizi që rriti veprën që theu kanonet. Thjeshtësia e interpretimit të tij mu duk "grryerje skorjesh që rrezikonin pas pak kohësh të ndryshknin bocetin e vyer".

Në pikën vluese të Recitalit, ndjehet se përcaktimi i Amirit për sjelljen e peisazheve nga Ballkani, kishte rrënë?! Ajo që pasoi ishte një cikël tabllosh që dominuan hapësirën kohore dhe botën e tyre, gati të një eposi muzikor. Brenda një shtjellimi në 5 pamje që i përmbledh "Vom ewigen Augenblick" (Nga çasti i Përvetshëm), përsiatemi në qerthullin e një rrugëtimi brënda vetes, ku tabllotë ndryshojnë imazhin dhe njëheri burimin tingëllor. Kështu tek 1. *Katabasis*, brenda pak masash, 8 gjithësej, të ndryshueshme shumë, krijohet një mjegullnajë që nuk davaritet edhe kur dridhjet tingëllore zbehen deri sa mbërrijnë të respektojnë shënimin "laschia morire". Tek 2. *Voluntas* vjen nga lashtësia një kantik serial si një linjë e ndërprerë nga dëmtimet në kohë, e shoqëruar nga pickime të telave që sjell një instrument i sapo dalë copë, nga gërmimet që e kanë nxjerë në dritë. 3. *Kangë malcore djepit*, ëmbëlsisht na sjell një pëshpëritje muzikale të ndërë thellë, a reflektim kujtimesh "të dashtuna" nga vizitat ndër bjeshkë, a ëndërimet për natyrën ndjellëse të një peizazhi bukolik që shkon "të tuj u tret". 4. *dans la Flamme* (si në Flakë) shpërthen një fontanë gazi e flake, nga asgjëja deri në 4 forte – *ffff*. Nën tokë vlon një bas kromatik i frikshëm që modelohet me shputën e dorës që gadget telat nën kapakun e pianos e që shkon tek shpërthimet e frikshme mbi tokë, *con tutta forza* (me gjithë forcën), që sinkopojnë shkatërrimin. Pas tij, kur mbulon hiri, mbetet Nr. 5 *Canto di Eracle* (kënga e Erakliut), një psalm e duf vokal bashkë që murmuron nën zë dhe më pas, papritmas klith e godet me sa mundet. Më në fund me një dyzësh në kuartë lehtë e kënduar, tretet drejt heshtjes. I gjithë ky epos në përfytyrim, ndodh me një densitet të presuar fort. Si në një krijim fovist, dallohet qartë mjedisi, edhe pse bimësia nuk është e gjelbër dhe deti nuk është i kaltër. Por vepra mbaron duke lënë misterin.

Duartrokitjet e zgjatura na zbulojnë autorin e pa njohur nga thauja askush në sallë. Pianisti fton në qendër të hollit, një artist të rafinuar si figurë dhe respektues ndaj publikut për veprën e vlerësuar më së

miri. Njohëm kompozitorin Jozef F. Pjetri. I lindur në Shkodër ku u mësua fillimisht dhe pak më pas u rrit si muzikant. U brumos me vite në shkollat e mesme e superiore në Greqi, Itali dhe së fundi në Austri, ku nëpërmjet tyre dhe krijimtaria e tij mbëriti në podiume prestigjioze. Njohja nga afër zbuloi prirje për një intelektualizëm në shërbim të formësimit muzikor që projektohet në të sotmen dhe të ardhmen e tij. Një takim i pa harruar, në një natë të bekuar.

Për të ndryshuar gjendjen emocionale të publikut të impresionuar na vepra e krijuesit të spikatur J. F. Pjetri, protagonist i kësaj mbrëmje zgjodhi emrin e kroates Sanja Drakulić, pianiste dhe kompozitore që nga vitet '70 të shekullit të XX dhe deri në ditët e mileniumit ku jetojmë. Nuk rresht së shkruari muzikë në të gjitha gjinitë muzikore koncertore, me një evoluim të admirueshëm në praktikat krijuese ku kalon prija estetike e kohës.

Drive është ajo që prezantohet siç përftohet nga titulli lakonik dhe ajo që shpalos interpretimi i veprës. Lëvizja që zbulon skuta të proit ndërgjegjësor e që shpaloset qartë e thjeshtë që në zanafillën e veprës, vijon me elokuencë të admirueshme në të gjitha prerjet kontrastuese, nëpërmjet të cilave zbulohet ecuria e proit vetiak të autores dhe interpretit që e publikon atë pa asnjë kompleks. Të mahnit paraqitja e çliruar nga detyrimet e realizimit *con brio* (me shkathhtësi) të strukturave virtuoze që pasojnë e komplikohen sidomos në prerjen e fundit, nga masa 82 dhe gjithë rrugëtimi i gjatë dhe tmerrësisht i komplikuar, ku reflekset e një ekzekutimi symbyllazi dhe memorizimi mëndjehapur, mbyllën me entuziazmin plotësisht të merituar këtë interpretim të shkëlqyer, që e shndëroi mbrëmjen në event.

I pa thyeshëm në misjonin e tij në shërbim të kultit të muzikës dinjitoze të bashkohësisë dhe përkatësisë rajonale, Amiri shpalosi dhe "gurin e fundit" që kishte zgjedhur për të demonstruar në një recital plotësisht impenjatv stofin artistik të një koncertisti që synon ta shohë nga lart

realitetin artistik, të mos përfillë vështirësitë dhe pengesat, por të ndjekë dritën e shejtë të orientimit.

Drei Preludien fur Klavier të Milan Mihailoviçit ishin si një zgjatim i asaj çka kishte përjetuar publiku një çast më parë. Por çka pasoi kishte një kontekst krejt të ndryshëm e mbase të kundërt.

Vijoi elaborimi i teknikës trashedentale pianistike të kohës sonë. 1. Pas dy pikpyetjeve në ritëm të përmbajtur dhe në fshehtësi të pëshpëritura, vijon në fshehtësi të plotë një largim vrapues me tingëllim minimal që në masat e fundit ngadalsohet dhe shkarkon në etydin 2. ku po brenda dinamikës tmerrësisht të lehtë që përcaktohet në *pp*, *ppp*, *mp* e përfundon po në *pp*.

Vijon konfidenca e autorit në etydin e tretë, ku duke vijuar tingëllimin minimalist, madje duke i shtuar dhe shënimin e përdorimit e pedalit *una corda* (vetëm të një teli të instrumentit), starton një *Elegji* me ritëm tepër të shpejtë që e vajton me dënesë e nën zë, siç kuptohet nga ritmi marramendës, përjetimin vetjak të M. Mihailoviçit, që mbyll me një përgjigje të pashpresë, pikpyetjet konfidenciale që shtroi në fillim të triptikut. Kur u kompozuan këto prelude, në Beograd ishte Maj 1989, vit i shembjes nën dhunë të një sistemi..! Kështu nën zë u fik kjo ngjarje muzikore e rrallë.

Në asnjë rast tjetër analog të muzikës pa fjalë, nuk kam ndeshur kaq ngjarje e subjekte. U shqetësova dhe u përgjegjësova me mjeshttrat ballkanikë. Paskemi hyrë në histori dhe me muzikën që pretendon jashtë kohësi, më thanë në fund mjeshttrat që na prezantoi Mjeshtri i ynë i pianos.

Tek ne nuk ekziston më përvoja e shkrimeve për mbresat nga një Recital koncertor. Urimet pas tij nganjëharë janë qoka me lule e foto. Kur mendon mundin e realizuesve idealistë dhe misionarë të tyre, edhe më pak se impenjimi madhor i pianistit shqiptar Amir Xhaković, s'të zë gjumi për ti dedikuar atij një shenjë admirimi modest e të sinqertë.

Prill '22 Tiranë



Madhështia e mirësjelljes dhe e dijes

Kur takohesh dhe bisedon me Martin Camajn, nxënësin e Shkodrës, studentin e Beogradit, redaktorin disaveçar të revistës «Shëjza» të Romës, profesorin e Universitetit të Munchenit, autorin e një vargu veprash letrare e gjuhësore, dy gjëra të pushtojnë para të gjitha të tjerave: madhështia e mirësjelljes, dinjiteti njerëzor dhe dija e madhe, që natyrisht janë rrjedhojë e gërshetimit dhe e mbëltimeve të kulturës së fituar në Shkodër, pastaj në Romë e sidomos gjatë tridhjetë vjetëve sa jeton dhe punon profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqiptare në München. Bashkëbiseduesin e mahnit dija e tij në fusha të ndryshme, por dy janë që veçohen mbi të tjerat: letërsia (e shkruar dhe gojore) dhe gjuhësia. Dhe ai që ka nderin dhe rastin të bisedojë me të do të bindet për informacionin dhe njohurinë e madhe që ka për letërsinë klasike greke, romake, italiane, gjermane, për letërsinë bashkëkohore gjermane e italiane, për rrymat e ndryshme letrare etj. Për një kulturë të pasur dhe për një shije të lartë për artin letrar të Martin Camajt nuk do të bindemi vetëm në bisedë me të, por sidomos kur i lexojmë veprat e tij, të cilat janë dëshmia më e plotë e dijes dhe e përkushtimit të këtij autori në fushën e artit të fjalës, dëshmi e vlerës dhe e pjekurisë së artit letrar shqiptar në përgjithësi. Njëmbëdhjetë veprat e tij letrare, të botuara deri më tash, janë një kontribut i madh i pasurimit dhe i ngritjes cilësore të letërsisë bashkëkohore shqiptare. Punë madhore bëri dhe në fushën e gjuhësisë me botimin e një varg veprash e studimesh.

Vepra ime po rikthen në vendin që i përkiste

FJALA: U desh të përëndonjë rreth dyzet vjet në sistemin monist bolshevik në Jugosllavi—Kosovë që të bëhej e mundur kuvendimi i lirë me Ju, me veprën Tuaj. Edhe pse ishit i yni, ju bëmë të «huaq», i bëmë të «huaqa» edhe veprat Tuaja; pa asnjë arsye ua mbyllëm dyert e botimit! Të «huaq» i bëmë dhe krijuesit letrarë si Fishtë, Konicën, Koliqin etj. A s'është kjo dëshmi e fatit njerë dhe tragjik të kulturës-letërsisë sonë?

CAMAJ: Ishte në logjikën e këtij sistemi për të cilin po flitni që të bahemi «të huej» apo që të mos komunikoni, por historia e re, moderne, e popujve po e tregon dita-ditës se dhuna kur të mbushet kupa zhduket si vesa para diellit. Kaq në përgjithësi. Tue kthye te thelbi i pyetjes suaj rrëfj hapas se simbas ndijes sime ndalimi i veprës letrare, pa gjyq, ashtë dënimi ma i madh që mund t'i bahet një autori që shkruen në gjuhën e popullit të vet. Dhe tue qenë se poezia ka të bajë kryekreje me ndjesitë e një vetje, kjo si dhunë s'do vu krahas me ndalimin e një ideologjie, e një ideje. Kjo si tragjikë peshon ma randë. Por unë tashti nuk kam ma të drejtë të ankojem sepse po përjetoj kohën kur vepra ime po rikthen në vendin që i përkiste.

FJALA: Në botimin gjermanisht e shqip të poezisë suaj në revistën letrare të Münchenit, Sirene (nr.5/1990) dymbëdhjetë poezi Tuaja janë përfshirë nën titullin e përbashkët «Larg atyne që flasin si unë». Kjo ide—ndjenjë është e kapërthyer edhe në shkrimet Tuaja të tjera letrare, pa pikë dyshimi me arsye.

CAMAJ: Domosdo kjo mospërfillje me kohë bahet motiv që tematizohet në letërsinë e artistit, nga njëherë bahet «obsesion» apo mani përndjekje: po këtë sëmundje psikike kam pasë rast ta shoh te ndonjë shkrimtar i mërguem, jo shqiptar. Titulli «Larg atyne që flasin si unë» tek unë do marrë ma tepër si ankim, ndonëse edhe në mue ndamja nga masa lexuese i ka lanë gjurmët e veta: krahaso Agonin në romanin «Rrathë», të cilin si shkrimtar të pandëgjueshëm organet kontrolluese e izolojnë në një fshat malor ku bie për 20 vjet në letargji. Por me mue nuk ka

BISEDË E MARTIN CAMAJT ME ANTON NIKË BERISHËN NË VITIN 1990

INDIVIDUALITETI YNË SHPREHET NË LETËRSINË DHE ARTIN TONË

ngja kështu.

FJALA: Jeni ndër intelektualët e rrallë shqiptarë që jetoni kaq gjatë në Perëndim (Itali e Gjermani) e nuk e tradhtuat artin letrar dhe punën pedagogjike shkencore me veprimtari politike ose me ndonjë biznes tjetër, ku shpesh «kurthohen» intelektualët. Çka e përcaktoi rrugën Tuaj: madhështia e shpirtit krijues ose etja për artin letrar, për komunikim artistik si shkallë më e lartë e gjallimit të qenies njerëzore?

CAMAJ: Shpesh herë në kuvend e sipër instinktivisht kam pohue: *nuk jam njeri i politikës*, por kurrë nuk kam thanë se *nuk jam njeri politik*. Dallimi në dy frazat qëndron nuk *vehem në shërbim të politikës* të një rryme apo ideologjie, por jam i interesuem për *fatet e njeriut*. Një artist nuk mund të jetë ndryshe. Në këtë qëndrim fshehet edhe një lloj egoizmi prej anës së artistit apo shkencatarit i *cili don me qenë i lirë* dhe të jetojë jashta shabloneve. Mandej një që punon në dy krih, në art e gjuhësi dhe ka një jetë private, s'ka kohë për sende tjera. Për të ardhë tek pika e dytë: çka e përcaktoi rrugën time? Janë mbarë kushtet e jetës, por disa nga ato janë vendimtare që kanë përcaktue formimin tim në tri qytete: Shkodra ku kam marrë njoftimet e para kulturore, por edhe atmosfera e këtij qyteti ku fantazia (kështu e kam në kujtesë!) shëtiste e lirë nëpër rruga, andej dhe entuziazmi i trillimit, bukuria e gjuhës shqipe që përdorej në këtë qytet, ditët e pazarit në një mjegull ngjyrash tashti vetëm në kujtesë. Mandej periudha pesëvjeçare në Romë, në një qytet ku nxuna me çmue artin e shekujve si gja të kushtueshme, pajë e njerëzimit. Këtu edhe si redaktor i revistës «Shëjzat» u njofta me shumë shkrimtarë jo vetëm italianë, por dhe me disa letrarë romunë e lituanë: këta më kujtohen mirë si dhe tjerë autorë emigrantë nga Evropa Lindore pse kishim tema të njëjta letrare. Në Romë u njofta me botën arbëreshe me të cilën edhe sot e kësaj dite jam fort i lidhun. Mandej Myniku, dervend kulturor në Evropën Qendrore ku jam ba edhe gjuhëtar e jetoj tash 30 vjet.

FJALA: Krijuesit e rangut Tuaj nëpërmjet të artit të tyre madhor në Perëndim kanë krijuar pasuri të konsiderueshme materiale. Ju, edhe atë që e keni fituar e krijuar si profesor e pedagog universiteti dhe si punëtor studimor e keni dhënë (investuar) për botimin e veprave Tuaja letrare, një pjesë të të cilave ua keni falë miqve, bibliotekave dhe dashamirëve të letërsisë.

CAMAJ: E keni fjalën për veprimtarinë botuese: veprat shkencore albanologjike janë botue nga shtëpitë editoriale të specializueme. Studimet në fjalë janë të gjitha italisht, gjermanisht ose (tash së fundi) edhe anglisht. Për këto s'ka pasë probleme, por veprat letrare shqipe ashtë e

pamundun të botohen nga editorët e huej, andaj ashtë dashtë të kujdesohem vetë. Ky ka qenë problemi i të gjithë autorëve shqiptarë apo arbëreshë: botimi shqip. Edhe Bogdani shkruen se «malli i shtampës» e pruni në Padovë ku sendësoi atë edicion të shkëlqyeshëm të *Çetës së Profetënve* edhe me mjete të veta financiare. De Rada shkriu pasuninë familjare, tokë e vneshta për të botue veprat e veta letrare. Edhe unë kam ndjekë këtë rrugë: të gjitha veprat letrare shqip në Perëndim i kam botue me mjete të mija, afër 2000 faqe shtypi. Këta libra paraqiten në një veshje shumë luksoze dhe dikush më ka kritikue se paskam dashë të hjek kreni me këtë punë. Po çështja ashtë ndryshe: në këta libra në gjuhën shqipe punoj tash 45 vjet të plota, andaj ashtë e drejtë ime t'i paraqes lexuesit në veshjen që unë due. Arti për mue nuk ka qenë kurrë një mjet fitimi të hollash, as nuk do të jetë! Edhe këtu fshehet një lloj llogarie sepse kam dashë të jem i pavarun. “Jemi të ndryshëm, por mbesim kongjenialë, si bukë e një mielli”.

FJALA: Në Prishtinë botuat veprat e para letrare: përmbledhjet me poezi Nji fyell ndër male (1953) dhe Kanga e vërrinit (1954). Këto vepra, edhe pse të parat në krijimtarinë Tuaj, bënë një ndikim të madh në poezinë shqiptare që u zhvillua më pastaj në Kosovë dhe përgjithësisht në Jugosllavi, por edhe më gjerë. Krijuesit letrarë kosovarë e pohojnë këtë (gjë fort e rrallë) pa ngurrim. Fjala vjen, edhe A. Shkreli, njëri ndër poetët më të mëdhenj bashkëkohor shqiptar, ma tha këtë (derisa po përgatitja një zgjedhje të poezisë së tij për shkollat e mesme) për ndikimin që keni bërë ju tek ai. Të mos përmend autorë të tjerë të moshës së tij ose më të rinj. Ç'domethënë kjo për Ju dhe si e shpjegoni këtë dukuri?

CAMAJ: E prunë rrethanat (e për këtë rast sot jam fort i lumtun!) që kemi fillue bashkë një degë të letërsisë shqipe. Sot Kosova ka qinda e qinda poetë temperamentesh të ndryshme. Si e ka vu në dukje dikund Agim Vinca, unë vija nga një traditë tjetër letrare, nga e ashtuquejtuna «shkolla letrare shkodrane» së cilës i përket edhe Pjetër Bogdani, kosovari autentik i tjera kohnave. Nga ana tjetër (unë) rrjedh nga një vis (Lugu i Drinit) që trajton tanësi të njëjtë gjuhësore dhe pajë kulturore me Kosovën që njëkohësisht mbahet dhe djepi i epikës shqiptare. Sikur letërsia kosovare të kish pasë zhvillim të natyryshëm në kushte tjera të lira, autorët në fjalë edhe pa shkrimet e mia kishin ardhë në këto trajta të shprehisë artistike. Konkretisht Azem Shkreli ashtë poet me talent fort të spikutun, andaj ai tue u nisë nga kjo pikë e zhvilloi poetikën e vet të pavarun (si edhe unë). Sot të dy jemi të ndryshëm, por mbesim kongjenialë, si bukë e një mielli.

FJALA: Disa krijues kosovarë (ndër ta



dhe A. Pashku), të cilët e njohin krijimtarinë Tuaj thonë me arsye se Ju si poet jeni më i madh, duke pasur parasysht edhe ndikimin që ka bërë poezia Juaj. Mirëpo, ai që ka lexuar me kujdes prozën Tuaj do të mund të pohojë (kjo është bindja ime e thellë) se nëse jo më i madh, atëherë si prozator jeni po aq i madh sa edhe si poet. Veprat Tuaja, veçmas «Rrathë», «Karpa», «Dranja» (madrigale) dhe «Shkundullima» (tregimet dhe novelat) janë dëshmi e denjë për këtë. S'do mend, ky nivelizim artistik nënkupton aftësinë, përgjegjësinë, përkushtimin Tuaj krijues, para se gjithash, ndaj vlerës artistike të secilës vepër dhe të secilës formë shprehjeje.

CAMAJ: Pajtohem me ju se nuk do veçue proza nga poezia sadopak në rastin tim. Kjo pyetje vëhet dhe jashtë Kosovës kur flitet për këto vepra. Po përpigem të shpjegohem sa ma thjeshtë e ma. Donë sqarue dy pika në të cilat përmbahet dhe përgjigja e pyetjes komplekse tuej. a) Rrjedha krijuese, kalimi prej vargut në prozë e prej proze në varg nuk gjindet vetëm tek unë, sidomos në letërsinë shqipe. Në bazë e mbaj veten lirik dhe proza ashtë mjet për zgjanimin e mundësisë shprehëse, diçka ma esplikative; b) ka tema që nuk e durojnë vargun, andaj kalohet në prozë (khr. DJELLA). Tue u nisë nga kjo bazë, e kam pasë gjithmonë vështirë t'i ndrydh krijimet e mia në kategori letrare ngase edhe si shkencatar nuk jam i bindun në këto kategorizime. Po ju rrëfj lexuesve të *Fjalës* (natyrisht dhe ju ma parë!) një fshehësi apo të dhanë që e ka kapërthye prozën time. Në vjetet '60, kur nisa të merrem intensivisht me prozë, rashë nën ndikimin strukturalizmit të aplikuem në linguistikë. Në teknikën e novelës ose të romanit nuk lot ma rol stofi landa e tregueme në përmasa rrethuese të ngjarjeve për të lanë pamend lexuesin: djegun për sensacion. Përkundra ngjarjet ose tregimi i tyne hyjnë në punësi si mjet për t'i shpjegue relacionet mes botës së mbrendshme e të jashtme. Ndërlidhjet, *relacionet*, që mund të jenë të natyrave të ndryshme gjenikojnë strukturat apo rrathët e ndryshëm në romanit «Rrathë». Me fjalë tjera, në këtë mes autori i bishtnon kërkesës së lexuesit që lyp përshkrim ngjarjesh në sipërfaqe (*action*) e jo shpjegim të fenomenit në thellësi. Kjo quhet shpesh letërsi e vështirë! Mirë, mund të thoni, këndej kalohet si pa u kujtue në psikologjizëm. «Rrathë», në të vërtetë, u klasifikue si roman psikologjik Ky, për shembull, mund të jetë një element që e ka largue prozën nga poezia.

FJALA: Romanet «Rrathë» dhe «Karpa», si vepra madhore në prozë, afrohen në disa piki në rrafshin tematik e konceptual, por edhe ndryshojnë dukshëm, veçmas në mënyrën e transponimit të problemeve dhe të shumësisë së sistemit kuptimor. Në «Karpa» vërehet një qasje më komplekse, më filozofike. Është një prozë që nëpërmjet të artit shqipton çështje të mëdha e të ndërliqshme të botës sonë.

CAMAJ: Me pyetjen nëse «Karpa» ndërlihdet me botën tonë, andaj kjo pyetje përmban në vete «funksionalitetin» e veprës. Pohoj se në këtë moshë që jam nuk më lëshon kujdesi dhe ideja e gjallnesës së popullit tonë në të ardhmen. *Karpa* që për arsye të shprehun ma nalt nuk e cilësova «roman» ashtë vepra e fundit në prozë. Preokupimi im ashtë tek konfliktet e mbrendshme në botën shqiptare sepse një *diktaturë* pjell një diktaturë tjetër dhe kështu shkon varg dhuna: prej dhune në dhunë. Po ky pesimizëm me zhvillimin e ngjarjeve të reja po mëngohet në ndërgjegjen time. Por që të kuptohemi! As këtu, në «Karpa» nuk qëllimoj të baj moralizëm: moralizimi i qëllimuem nuk duhet të ketë vend në art sepse ngjan e kundërta. Jam i vetëdishëm për përkimet e motiveve e të përmbajtjeve mes romanit «Rrathë» dhe «Karpa». Kaplot raste edhe në poezi kur kthej tek motivet e përjetime të trajtueme edhe ma parë. Këtë e kam ba instinktivisht, pa frigë të kritikës se gjoja po përsëritëm: kjo vërtetohet shpesh edhe në pikturë dhe në muzikë posepo!

FJALA: Në veprën «Dranja» (madrigale), formë krejt pak e kultivuar në letërsinë tonë, artistikisht përjetësoni (nëpërmjet qenies të quajtur breshkë) fatin tonë: krenar e tragjik. I përgjigjej pikërisht madrigali shtjellimit të një teme të këtillë ose forma e këtillë i përgjigjej tematikës?

CAMAJ: *Dranja* ka dalë, si vepër, mjaft e diskutueshme sidomos për formë e gjuhë. Arsyeja pse u quejt kompozitë *madrigalesh* së pari më erdhi nga kuptimi që ku ky emërtim në muzikën klasike (krh. Monteverdi etj.). E kam vu në dukje në kopertinën e këtij libri se nuk do marrë si gjini në kuptimin klasik dmth: *madrigal* “gjini letrare në vargje me përmbajtje idilike” etj. Më duket se *Dranjes* i përshtatet ky emërtim edhe në pikëpamje të etimologjisë së fjalës: *cantus matricalis* — *kangë në gjuhët amtare* apo popullore. Po për mundësinë interpretative pëlqehen këto madrigale edhe nga të huejtë që lexojnë shqipen dhe njerëz të shtitruem në letërsi të vështirë. Në Dranjën fort e vështirë ashtë gjuha, andaj edhe e pa përkthyeshme, thonë disa.

FJALA : Çdo vepër e krijuesit letrar, e jo vetëm e atij letrar, është qenësisht pjesë e një vepre të madhe, që autori e krijon gjatë gjithë jetës së tij. Megjithatë, janë disa periudha kur autor ridëshmohet me lloje e forma të ndryshme të krijimtarisë letrare. Me një fjalë dëshmon vijimësinë dhe pasurimin e punës së vet krijuese. Edhe te Ju hetohen këto faza.

CAMAJ : Si e kuptoj unë, kjo pyetje prek diçka fort me randësi: ashtë fjala për kunorzimin e një procesi krijues në përfundimin e veprës. Nëse kjo përjetohet thellësisht, autori pjekunohet bashkë me veprën e pa u kujtue kapërcen një fazë jete. Një autor i pa faza krijuese o ashtë i ri apo nëse i vjetër në këtë zeje sendet që shkruhen nuk janë të përjetueme prej tij.

FJALA: Në fushën e poezisë që keni botuar deri më tash, NJERIU MË VETE E ME TJERË (München 1978) është dëshmi e një niveli të lartë artistik, një thellësi e kohezion kuptimor me shumë tipare origjinaliteti, sidomos në punë të gjuhës poetike dhe të sintaksës gjuhësore të veçantë.

CAMAJ: Tue kundrue në retroperspektivë kjo fazë për mue ka qenë vendimtare, fillimi i një refleksioni të paprovuem ma parë. Kësaj metode apo përmbajtje i shtohet një qëndrim i ri ndaj gjuhës. Gjithmonë kam gjetë përkënaqje në përpunimin e gjuhës, as me qenë kjo një gur i fortë që në skalitje e sipër merr trajta impresionuese; nga njëherë kam kalue edhe në formalizëm të tepruem

që në themel do vlerësue si e metë. Këtë përmbledhje poezish e mbaj dhe sot e kësaj dite si të përsosun, andaj e kam lanë të lirë të përkthehet nga Francesco Solano (Dushko Vetmo), shkrimtari arbëresh fort i rrahun në shijimin e letërsisë dhe në gjykimet mbi të.

Vepra duhet të afirmohet në gjuhën origjinale

FJALA : Krijimtaria Juaj letrare është përkthyer në disa gjuhë botërore. Si është pritur ajo nga lexuesit dhe nga kritika ? Po vëllimi me poezi i botuar në italisht (me tekstin shqip përbri) si u prit në truallin e lirikës së madhe, në Itali?

CAMAJ: Në përkthim deri tash janë botue vetëm lirika, në vjetet ’60 së pari italisht (*Fiera Letteraria*, antologji etj.). Përkthyes prof. Ernest Koliqi, prof. Zef Schiro jun. etj. ma vonë edhe anglisht (krh. *London Magazin, International Poetry Review*). Më lejoni të shpreh disa pikëpamje rreth përkthimit letrar në përgjithësi. Së pari, një vepër letrare duhet të afirmohet në *gjuhën origjinale*, në shqipen, për shembull: përkthimi do mbajtë në parim një- një reproduksion „i papërkryem“ e një kuadri në voj. Unë për vete i kam qëndrue besnik këtij parimi, andaj kam pengue mjaft përkthime të veprave të mia që ato të botohen: me këtë jam i bindun se e kam mbrojtë veprën time! Për çdo siguri, kam lypë gjithmonë që përballë tekstit të përkthyer të botohet edhe origjinali, në mënyrë që nëse lirika në vete ashtë e bukur, të afirmohet bashkë me të edhe gjuha jonë e mrekullueshme! Tash tek pyetja juej : si priten në Itali këto sende të mia të botueme italisht. Çdo nacion, por sidomos italianët, deri tash vonë janë të *paraprogramuem* për sa i përket shijes letrare, dmth edhe kur lexojnë lirika të përkthyme kërkojnë analogji rrymash e autorësh në letërsinë e tyne me të vërtetë të mrekullueshme. Bie fjala, lirika ime përnjësohet me hermetizmin italian meqenëse dihet se kam ndëgjue nja dy vjet në universitetin e Romës leksionet e Ungarettit që ishte profesor në këtë universitet. Në të vërtetë, na disa lirikë

shqiptarë modernë nuk kemi të bajmë me hermetizëm, po shtijmë në punë simbolikën tradicionale tonë që gjindet dhe në poezinë popullore shqiptare. Sa për informim: në New York ka dalë në këto dit një përmbledhje poezish të mia (Selected Poetry), në dy gjuhë në përkthim të Leonard Fox, ndreqë e miratue nga Eric P. Hamp dhe shikue edhe nga prof. Arshi Pipa. Përgatitja e këtij vëllimi 220 faqesh me hymje e *Notes* si dhe shtypi ka zgjat 6 vjet.

Delli i letërsisë kosovare rrah me ritmin e kohës, me shqetësimet

FJALA: Edhe pse larg atmosferës krijuese kosovare, keni pasur mundësi të përcillni letërsinë që zhvillohet këtu. Cilët janë autorët që i keni lexuar dhe i çmoni? Për çfarë arsye i çmoni?

CAMAJ: Qysh në zanafillën e saj e ndjek zhvillimin e letërsisë kosovare, në kohët e fundit mjerisht vetëm në vija të përgjithshme: ju thashë se jeni ba shumë! Nuk guxoj me kalue në imtësi e të jap gjykime të preme, s’po jap as emna, por kaq mund të thom me bindje të plotë: letërsia kosovare në një kohë fort të shkurtë dha e po jep talenta fort të fuqishëm, ma të fuqishëm e të singertë se në çdo trevë ku lavrohen letrat shqiptare. Delli i kësaj letërsie rrah me ritmin e kohës me shqetësimet dhe kujdeset që kjo kohë po bie me vete. Dhe ashtë mirë kështu! Dihet, shpesh mungon qetësia për refleksion. Gjithnjë, simbas mendimit tim, poezia qëndron në krye të këtij vrapimi. Problemi im në ballafaqim me këtë letërsi përqendrohet tek format. Mbi këtë temë mund do të kuvendonim deri nesër, po ia gjejmë shtegun të ndalemi edhe mbi këtë pikë.

FJALA: Po letërsinë që zhvillohet në Shqipëri e keni përcjellë dhe a e përcillni?

CAMAJ: Jo sa letërsinë tonë në Kosovë, por po! Ndonëse ajo zhvillohet në kushte specifike që donë mbajtë gjithnjë parasysht, krijimi letrar në Shqipni ashtë ma lehtë të ndiqet. Në vjetet ’60 kur isha kryeredaktor

i revistës «SHEJZAT» në Romë u mora intensivisht me të. Në vjetët ‘60 shënojnë një kthesë sidomos në prozën e letrarëve të Tiranës. Qe edhe për mue më randësi, si autor shqiptar, ky ballafaqim apo lexim sistematik i *Nëntorit* dhe *Dritës* si dhe prodhimit tjetër, nga u binda se letërsia shqiptare ishte nisë shtigjesh që nuk ishin ato të zhvillimit të natyrshëm të letërsisë tradicionale. Kjo letërsi sot gjindet në një krizë, gjë që e vë në dukje dhe shtypi i Tiranës. Për ne larg nga atmosfera e kushtet në të cilat zhvillohet kjo letërsi, ashtë e vështirë të biem një gjykim pak fjalësh mbi të. E pakuptueshme ashtë për mue, fjala vjen, se në Shqipni kur diskutohet për shkaqet e krizës (ndër sa tjera nga rrjedh stereotipizmi) kërkohen ato në kategori «jashtaletrare» që nuk kanë të bajnë me normat e ligjet qenësore të letërsisë e të artit. Pos ndoj letrari të shquem, kritika s’i zë në gojë, për shebmull, *përmbajtjet* letrare dhe harmonizimin e tyne me *format* (këtu tue përfshi dhe gjuhën). Gjithnjë qet krye në këto diskutime një lloj «Berührungsangst» (si me ia thanë shqip?) me rrymat letrare të kohës. Kjo situatë në letërsinë kosovare ashtë kapërcye me kohë.

FJALA : Në letrën, që ma shkruat më 14 prill të këtij viti, më bëni me dije për veprat Tuaja të reja letrare NEMA dhe BUELLI (ky i fundit poemth 23 copësh, kushtuar neve në Kosovë). A na thoni diçka më përafërt për këto vepra?

CAMAJ: *Nema* (Nemesis) dhe *Buelli* (The Buffalo) botohen për të parën herë me përkthimin anglisht përballë, si u tha, në New York University Press, New York, N.Y. 10003, Washington Square Center). Patjetër këto dy cikle paraqesin një fazë të re që nis mbas 1980. *Buelli* lidhet me mitin e lashtë të këtij frymori në vise te Mesdheut si zot i fushave, por edhe me procesin e çfarosjes së tij gjatë brigeve të Lugut të Drinit e ma larg. Shpresoj se lexuesit vetë të zbulojnë domethanien e këtij cikli poezish që simbas përkthyesve e gjykuesve na qenka mjaft i vështirë.

FJALA : Në të njëjtën letër më keni shkruar edhe këtë: «Qëndrimi im kundrejt jush: kam ba çka munda, kusurin ma falni! Do të kisha mbetë atje, sikur të më kishin lanë në punën time dijekëqijtë. Rrëfej se në kohët e fundit jam tepër i përkujdesuem për ju (në Kosovë - v. A.N. B.). Një këshillë: kërkonit të drejtat tueja me mjete paqësore deri në pikën e fundit. Komunikim me fuqitë paqedashëse kudo të jenë ato...» Çka t’i shtoj kësaj? Ne kemi një mijë arsye t’ju falim kusurin Tuaj ndaj nesh. Po vështirë është që Ju do të mund të na falni për parakusurin dhe për kusurin tonë ndaj jush; të shtrënguar nga politika bolshevike, që i bëri varrin (sa munda) edhe letërsisë sonë, u sollëm ndaj jush si me një të «huaj», po kështu vepruam edhe me veprën Tuaj. Edhe me disa letrarë të tjerë! Duke mos ju përfillë juve, duke ju mohuar, në esencë ne mohuam veten, kulturën, letërsinë tonë! Apo jo?

CAMAJ: Ndonëse «e bamja nuk bahet e pabame», me urti e vullnet të mira ndreqen shumë sende. Le t’i lëshojmë një sy ripërtrimjes në zhvillim e sipër gjithkund në popujt e Evropës Lindore që po bie me vete edhe mënyra të reja të menduemit. Shpresoj se edhe shqiptarët do të përfshihen në këtë proces, gjë që ashtë në interes të gjithëve, tonin e të fqinjëve. Tek unë kjo nuk ashtë frazë, por kështu e kam ndie gjithmonë. Këtë deshta me thanë në letrën time që po e citoni: kjo do mbajtë si e vetmja rrugë e drejtë. Për t’u orientue drejt kësaj rruge busullën në dorë duhet ta mbajë *inteligencia* jonë. Tue ardhë tek letërsia: individualiteti ynë shprehet në letërsinë e artin tonë, marrë në tanësi, pa diskriminim! Andaj mue më

(Vijon në faqen 12)



E KA PIRË KAFEN?

Tregim nga
Gjergji Mihallari



Ajo u kërrus më shumë, si të ishte një shkarpë e dobët, që nuk e duronte dot peshën e rëndë të një dëbore që vetëm shtonte trashësinë mbi gjethet që shkëputeshin të pajeta një e nga një nga dega e brishtë. Ajo u tkur më shumë, u mblodh sa një grusht, si fjala e vetme që qarkullon gojë më gojë, si të jetë e vetmja dritare ngushëlluese për të vështruar dhe dalluar dritën e pastër të jetës. Ishte tkurur si trupi i iriqit, që kur ndeshet me rezikun, e mbledh trupin sa një grusht, duke u dhënë forcë gjembave të tij për t'u mbrojtur. Edhe sytë humbën shkëlqimin, u bënë të mjegullt, sikur moti i keq të kishte follenë aty, me gjithë vrejtësinë, hirtësinë e reve të plumbta, me shkëlqimin e rrezeve të diellit fshehur pas ngurtësimit.

Lëvizte natën në shtrat, si të gjendej mbi gjembat e ferrës. I jepte trupit përpjetë, gjysëmbledhur, vështronte divanin tjetër. Ishte errësirë. Sytë nuk kishin forcën t'a shponin masën e squllët të mosqartësië. Kushedi sa herë i kishte shqiptuar ATIJ, që duhej të mbanin mbi komodina, në mos dy, të paktën një dritë nate. Jemi pleq, duhet të shkojmë në banjë natën. Nuk na ndajnë më sytë dhe do të thejxmë qafën...

Jo, kundërshtonte AI, kërkesën e saj, drita ma zbon gjumin. Pastaj kush duron ato flutura të natës që do sillen rrotull dritës, nuk më pëlqen që hija e lojës së tyre, të turbullojë ëndrrat...

Dhe mbyllej biseda e përsëritur çdo natë. Por rihapej përsëri të nesërmen kur muzgu tretej për t'i lënë vendin mantelit të zi që vishte nata si një priftëreshë e tempujve antikë. Dhe kërkesa kundërshtohet me të njëjtat fjalë. Përsëri përsëritej të nesërmen, të pasnesërmen, përsëri, përsëri, dhe ...përsëri mbytej në errësirën e natës, si një rit i pakthyesëm në trajtën e njëtrajtshmërisë. E ky avaz, kishte vazhduar prej më shumë se pesëdhjetë vjetësh, qysh kur drita elektrike hyri në shtëpinë e tyre.

Edhe pse mundohej të shqepete errësirën e dhomës, për të shquar divanin tjetër, vetëm shtonte rrathë njollash të errta në syrin me vështrim të lodhur dhe dobësuar. Eh, h, t'iu marrë shejtani edhe ju sy, mallkonte paafësinë e vet. Por, aty për aty, e mblidhte arsyetimin dhe bëhej pak më e mënçur. Të merr në njërin krah Perëndia, e t'a jep në krahun tjetër, shqiptonte me zë, por shpejt kafshonte gjuhën. Ende ndiente frikën e asaj kohe të mallkuar, kur u vunë kazmën shtëpive të ëngjëjve dhe Zotit. Pas një heshtje dhe qëndrimit në errësirë, ftillohej, kujtohej që kishin ndryshuar kohët. Këmbanat kishin tingëlluar edhe gëzuar edhe vajtueshëm. Nëse do të ishte akoma ajo kohë, tani, fëmijët e saj nuk dë qenë shpërndarë nëpër botë si zogj të trembur dhe arratisur nga foleja.

Si mbaronte ato dialogje pa përgjigje me vehten, mbante vesh qetësinë e plotë të dhomës. Mbase duhej të dëgjonte një gërhitje të lehtë, apo edhe një përplasje buzësh të thara nga sëmundja, që kërkonte pak ujë. Por heshtje! Asnjë tingull, heshtje e plotë. Edhe frymëmarja e saj ishte bërë njësh me heshtjen, nuk ndihej as duhma e saj duke frymuara. Dëgjoi një të folur në gjumë? Me siguri më gabojnë veshët, duhej t'i mbushte mendjen vehtes, se nuk ishte asnjë tingull tjetër në atë dhomë veç heshtjes së natës, heshtjes së saj... Mundet, po më lënë në udhë edhe këta të shkretë veshë!

Lëvizi nga divani-shtrat. E njihte udhën nga divani deri tek dera. E kishte të fiksuar në gjithë trupin. Këmbët lëviznin vetë, aq dhe sa hapa duheshin për të prekur dorezën e derës. Duhej të shkonte në banjë. Përsëri dy fjalë të shqiptuara në gjumë. I thirri fort arsyen, mblodhi veten. Ishte e bija. Flinte në shtratin e TIJ, në divanin e TIJ. U fillua në kujtesë. AI, ishte larguar njëherë e përgjithmonë nga kjo jetë. E ajo, nuk dëshironte t'a pranonte...

Po kthehej nga banja. Mbante në duar një peshqir. Duhet t'i ndërroj tjetrin, që me siguri është qullur nga djerësitja. Disa muaj që ndëronte peshqirin nga nënkresa e TIJ. Nuk vinte gjumë në sy. I ndëronte peshqirin, fanellën. Të nesërmen lante fanellën dhe peshqirin, që AI, të kishte fanellë të pastër, e në jastëk të nderej një peshqir i thatë. Kishte një dyzinë fanellash të punuara nga dora e saj, po aq edhe peshqirë, sa për një kohë shumë të gjatë të mos lante dhe shpëlante ato që ndëronte AI. Por merakui, ah merakui i gruas. AI gjithmonë duhej të shkëlqente nga pastërtia, të dukej bukuria e burrit që ajo e dashuronte me mënyrën e saj arkaike, me mosdijen e dashurive që duken vetëm fasadave të hipokrizisë. E çfarë gruaje mund të jetë ajo, që nuk i vriten sytë edhe nga njolla më e vogël në rrobën e burrit, i kthehej të kunatës, kur kjo e fundit e ngacmonte për kujdesin e tepruar të saj, duke shqiptuar se shumë e zbukuron burrin, por avash, se mos t'a rrëmben ndonjë tjetër... Rrudhte buzët, e ndiente fijen e zemërimit që trallavitej brenda në kraharor, por ruante atë qetësinë që fitonte kur ndeshte sytë e TIJ, i përgjigjej qetë kunatës, po të ketë atë mendje, udha e mbarë i qoftë. Mua, të më rrojnë fëmijët!

-Si flete mama? -dëgjonte zërin e të bijës në mëngjes.

I linte përpara filxhanin e kafesë, që mbushte ajrin e dhomës me një aromë të fortë ngacmuese. Ishte ndjellëse ajo aromë.

-Ai, yt atë, është këtu, me ne! -gjerbte kafënë, duke lëvizur vështrimin në hapësirën dhomës, e rrëzonte pastaj, për t'a ngurtësuar tek divani, atje ku kishte fjetur AI. -E ndiej kur lëviz, më rrëfen udhën në errësirën e natës. I dëgjoj hapat, pranë veshit më ushton frymëmarja e thellë. Don të flaës, diçka do të më thotë. Por nuk mundet, e mundon diçka...

-Mama, -e ndërpret e bija, në përlojtje. -Babai nuk jeton më, e kupton apo jo?

-Si?! Nuk jeton më?-tulatet, rrotullon vështrimin plot ankth si të ketë humbur brenda dhomës. Pastaj, e gjen veten pranë të bijës, e mbështjellë nga përqaftimi i saj. Ndjen edhe lotët, në lëkurën e thatë të fytyrës së saj. E shtërngon zemra. Rrënkon, dhe për një çast nxehet me ATË, me bashkudhëtarin e mëse gjashtëdhjetë viteve të jetës së saj. Pa ditur shumë si mund të ishte dashuria, e dashuroi në mënyrën e vet, të thjeshtë mbase edhe pak antike, ATIJ, që kurrë nuk ia përmendi emrin ndër të tjerë, apo edhe t'i drejtohej e t'i fliste njëherë të vetme me emër. Të shqiptonte emrin, dukej sikur do të shkatëronte mënyrën e saj të të dashurit, mënyrën e të respektuarit si burrë dhe bashkëudhëtar për një jetë të tërë. Por AI, e kishte tradhëtuar në atë rrugëtim, e la në mes të rrugës, të vetme. Kjo ide, nxori dufin e shfryrjes: -Iku? Po, po. Iku dhe më la vetëm. Nuk i erdhi keq për mua? Pse më la vetëm, përse?

-Mama, nuk je vetëm, -e ngushëllon e bija. Ndjen mbi flokët e zbardhur, ndalesën e buzëve të së bijës. Në qafë i mblidhet shamija që burgos tufën e flokëve të kokës.

-Po, nuk jam vetëm! Jam plot, me nipër e mbesa. Të më kini jetë të gjatë dhe qofshi me barkun plot gjithmonë, -vazhdon ajo. -Por ai, nuk duhej të largohej kaq shpejt, jo...

-Po vuante nënë, do të lëngonte në shtrat...

-Vetë do ta laja dhe shpëlaja si një fëmijë, -ngulmoi ajo. -Mjaftonte ta kisha aty në krye të këndit. Po tani, si është? Ka ftohtë?

Kush ia ndëron teshat e lagura nga djerësitja? Do të ketë ngrënë? Po kafënë, e ka pirë?

Ndërkohë, dita hapte dyert. Vinin e shkonin të afërm e të tjerë, bisedonin dhe kujtonin. Brenda bisedave ishte AI. Ajo mblidhej grusht në divan. E ndinte veten gjysmake, të gjysmuar nga ana tjetër e një jete që s'mbahej mend qysh kur kishte filluar rrugëtimin. Që kishin ndarë gëzime dhe hidherime bashkë, me lëngun e hidhur të kafesë duke e gjerbur në mëngjeset e herta, kur AI, nisej për në punë, apo në mesnatën e vonë, kur kthehej nga puna. Lotët ishin burgosur në sytë e saj. Ishin shterur apo tharë? Jo, jo! Për ATË, që kishte qënë gjithë jeta e saj, dashuria e vetme, më e madhja dashuri, iluzioni turbullues i burrit që e robëroi në ndjenja, mjaftonte një grimë, që të krijonte lumenj lotësh. Por jo, duhej t'a mbante vehten. Kishte mënyrën e vet për ta qarë dhe vajtuar ikjen e TIJ, me dhimbjen që rëndonte si gur mbi trupin e shterëzuar.

E ndërsa afrohej nata, do t'i shqiptonte të bijës se AI, ishte aty, në atë dhomë. Ajo e ndiente, i ndihte frymëmarjen e rënduar. E në mëngjesin tjetër, do pyeste të bijën:

-E ka pirë kafën?

(Vijon nga faqja 11)

ashtë duke gjithnjë absurditeti ndalim i autorëve. Ajo që ma lodh mendën tashti ashtë *rikuperimi* i autorëve të ndaluem (fjalën «rehabilitim» në vend të «rikuperim» e mbai jo të përshtatshme!) Shpesh e pyes veten nëse kuptohet nga të gjithë se shkrimtarët e ndaluem kanë lanë një vend të zbrazët mbrenda letërsisë e se rikthimi i veprës së secilit në tanësi në vendin e lanun zbrazët ashtë gjaja ma e natyrshme e botës.

Ndërlidhjet mes nesh dhe kulturës perëndimore

FJALA: A e keni lodhur mendjen se ku e ka vendin vepra juaj mbrenda letërsisë sonë? Ju jeni sigurisht vetëdijes se opusi juaj letrar është mjaft kompleks e se pjesa kryesore u krijua jashtë gjirit të popullit tuaj. Ju folët dhe për ndikimet dhe përshtypjen që ju la kultura perëndimore.

CAMAJ: Edhe pse pjesa kryesore e kësaj vepre u krijue në Perëndim nuk duhet të mbahet e huaj për masën e popullit këtu në vend e troje të veta. Na jemi një popull evropian. E vërteta, ka pasë periudha ndamje nga Evropa ashtu si qe dhe fati i shumë popujve të Ballkanit, por ndërlidhjet nuk janë këputë kurrë mes nesh dhe kulturës perëndimore, as në këto dyzet vjetët e fundit. U tha se fazën fillestare e kemi kalue bashkë: pyetni mikun tonë. Esad Mekulin, dekanin e letrave tona në Kosovë. S'do harrue se vepra ime ashtë e njoftun jo vetëm në diasporën shqiptare, por edhe në rrethe kosovare. Mos të harrohet se një pjesë e letërsisë sonë u shkruhe dhe u botue jashta vendit, por tematika del gjithnjë e lidhun ngusht me popullin të cilit këta poetë i përkasin. Format, rrymat e reja, shijet nganjëherë paraqesin një simbiozë mes pajës shpirtnore autoktone me ato universale. Unë i gëzohem kontaktit me masën e lexuesve dhe lexuesit e kanë fjalën e fundit se ku ashtë vendi im në këtë letërsi. Nga shkrimet tueja këtu në vend mbrohet me kambëngulje teza se thellësia apo «shumëkuptimi» i tekstit si dhe simbolet me ndryshmënitë formale e pasunojnë dhe letërsinë tonë.

FJALA: Zoti Profesor, do të bënim një mëkat të pafalshëm që në këtë bisedë të parë për lexuesit e «Fjalës» të mos i theksojmë edhe disa çështje të gjuhësisë, të punës suaj në këtë fushë studimi, që po ashtu është me rëndësi të posaçme. E filluat këtë punë me studimin për «Mesharin» e Buzukut (teza e doktoranturës e mbrojtur në Romë), vazhduat me «Çetën e profetëre» të Bogdanit, me «Fjalëformimin në gjuhën shqipe» (tema e habilitacionit në Munih), me gjuhën e arbëreshve të Italisë, me «Albanian Grammar» dhe me një varg punimesh të veçanta. Është një fjalë e urtë frënge: Kaun duhet kapur për brirë! Ju u morët pikërisht me problemet më të ndërliqshme të gjuhësisë shqiptare, me problemet më qenësore.

CAMAJ: Në kushte normale do të isha marrë tanë jetën me letërsi, por edhe nga shkakui sesi i mërguem më duhej një profesion, zgjedha gjuhësinë shqiptare që mos të ndahesha nga poezia. Pra, lidhja e studimit të gjuhës me letërsinë krijuese ka qenë shpëtimi im edhe si vetje. Tue pasë këtë si objektivë, vërtet, jam marrë me mbarë pjesët e gramatikës shqipe sepse tue mendue edhe në mënyrë *struktrale* të gjitha këto pjesë trajtojnë tanësinë e gjuhës sonë. Si sintezë do mbajtë *Albanian Grammar*. Në vjetet e fundit po merrem intensivisht me dialektet arbëreshë. Në shtyp gjindet një gramatikë e një dialekti arbërrsh (*La parlata arbëreshë di San Costantino Albanese*, faqe 250). Studimet gjuhësore, letrare e folklorike i kam të gjitha në gjuhë të hueja, gjermanisht, italisht e tash së fundi anglisht, në gjuhën ma të përdorun në botë edhe në studime shkencore.

FJALA: Koncepti dhe qëndrimi juaj për gjuhën del, edhe nga veprat letrare, edhe nga studimet dhe punimet diskursive kushtuar gjuhësisë sonë dhe problemeve të saj. Veçmas këtë e keni përligjur thellësisht në veprën «Albanian Grammar» (1984). Cila është rëndësia e kësaj vepre?

CAMAJ: Qenësore në *Albanian Gramar* ashtë metoda që u ndoq në përpilimin e saj që synon të vehen në relacion të tri variantet tradicionale të gjuhës së shkrueme: gegnisht, tosknisht dhe arbërisht. Tue u nisë nga fazat bazore të gjuhës mbërrihet në format e gjuhës së sotme, pra në mënyrë *deduktive* e cila si metodë i kundërvehet asaj të gramatikave të reja në Tiranë dmth tue u nisë nga një variante veçuese, nga forcimi i tosknishtes rindërtohet një sistem gramatikor që nuk bazohet në tanësinë e gjuhës dhe në historinë e saj. Megjithatë në *Albanian Grammar* paraqiten edhe principet e reformës gjuhësore të Tiranës (që rrallë kush po i ndjek!) d.m.th. «gjuha e njësuar». Kjo gramatikë ime u përgatit për t'u hy në punë studentëve të albanistikës ndër universitete dhe linguistëve që donë të mbështeten në variantet e ndryshme të shqipes të cilat gjithmbarë paraqesin tipologjinë saktë të

shqipes së përgjithshme. *Albanian Grammar* u përkthye edhe italisht dhe hyn shpejt në shtyp. Kjo gramatikë u pajis dhe me tekste të çdo variante, si aplikim i rregullave gramatikore.


Albanistikës po i hapen perspektiva të reja

FJALA: Një meritë e madhe Juaja lidhet edhe me punën arsimore pedagogjike në Universitetin e Munihit, si profesor dhe si përgjegjës i Katedrës së gjuhës dhe letërsisë shqiptare. Te Ju e me ndihmën Tuaj, mbaruan studimet shumë studentë, magjistrantë e doktorantë, disa edhe habilituan në albanologji. Atë që kishin bërë e bëjnë në Itali prof. Valentini, Koliqi, N. Ressuli dhe prof. Merlekaj e bërët dhe po e bëni Ju në Gjermani, ku albanologjia u bë lëndë (Fach) universitare. Me këtë hap i shtohen mundësitë albanistikës më shumë se asnjëherë më parë të të vazhdojë e ta pasurojë traditën e filluar nga Thunmann, Hahn, Pedersen, Meyer, Jokl, Lambertz etj. për studimin e kulturës shqiptare.

CAMAJ: Krijimi i albanologjisë (gjuhë letërsi) si lëndë universitare në një universitet si i Mynikut nuk ka qenë punë e lehtë. Vetë kualifikimi i titullarit përkatës përcillet me procedura të gjata përgatitje shkencore sidomos ashtë fjala për ndoj lëndë të re si kjo e albanologjisë me përmbyllje *magjistrature* dhe *doktorati* (Dr. phil.). Sikur po e veni në dukje dhe ju albanologjia, sidomos në Evropën Qendrore, mbahej pjesë e indoeuropeistikës me emna të mëdhaj. Në këtë traditë mbështet edhe profesura në fjalë. Kësaj lande po i hapen perspektiva të reja në dheun gjerman, sidomos mbas hapjes së kufijve mes dy shteteve. E ndihmuem veten të forcuem sidomos me bashkim forcave apo të specialistëve nga Lindja, si është një prof. Fiedler, por edhe ma andej, kontaktet me specialistët nga Shtetet e Bashkueme (me në krye prof. Eric P. Hamp), atyne në Bashkimin Sovjetik (Prof. A. Desnickaj a) etj. Me albanologët e Italisë me programe humanistike plotësohen të gjitha kushtet t'i vehen kësaj lande baza serioze në gjurmim si mësim universitar. Këtij kontakti sidomos mes shkencëtarëve të albanistikës universiteti i Kosovës dhe Instituti Albanologjik i Prishtinës i kanë dhanë pulse të forta, posaçe përmes Seminarit ndërkombëtare që organizoni çdo vjet në gusht. Konferencat mbajtë në këto Seminare (edhe i keni botue rregullisht) dëshmojnë për trajtimin e temave të reja në këtë disiplinë. Ju uroj përzemërsisht për këtë sukses! Due të theksoj se qendrat albanologjike në këto universitete kryejnë edhe një funksion informimi në planin marrëveshës e mirëkuptimi mes popujve.

FJALA : Çdo krijues dhe vetje ka botën e vet të fshehtë, ndjesitë e veta; ka diçka që njeriu dëshiron ta thotë e tjetri këtë nuk mund ta dijë, din ta cysë. Dëshironi të thoni diçka të veçantë për lexuesit e «Fjalës» jashta pyetjeve që ju bëra?

CAMAJ: Falënderoj Fletoren «FJALA», e ju Dr. Berisha, për këtë intervistë. Ky për mue ashtë kontakti i pari i këtij lloji me lexuesit e «Fjalës» andaj më mbeten plot sende pa thanë. Kryekreje përshëndes të gjithë lexuesit posaçe gjeneratat e reja në Kosovë, Maqedoni e në Malin e Zi. Qysh prej vjetit 1950 jam në kontakt të pandërpreme me rininë universitare, se pari si student e mandej si docent: njësohem me *rininë* në përgjithësi e posaçe me ju në kujdeset e problemet tueja gjithfarësh.



USHTARËT E ËNDRRAVE

Poezi nga Linda Agolli



SA SHPEJT VJEN NATA

Dhe shpejt, sa shpejt që vjen nata
Valëvitur si tyl i vejushës
Një prekje më endet në trup
Mbështillet si mjegulla gëmushës
Dhe shpejt, sa shpejt që vjen nata.

Dhe shpejt e shpejt bie nata
Këndon zëpak një zogth i trishtuar
Rrëzohet pa zhurmë një muzg
Më derdh errësirë përmbi duar
Dhe shpejt e shpejt bie nata.

Dhe shpejt, si qyrk rëndon nata
Një zilkë trembur tundet në erë
Shtëpi e vogël rrënuar
Hyjnë dy pleq, pas mbyllet një derë
Dhe shpejt, si qyrk rëndon nata.

Dhe shpejt, sa shpejt sundon nata
Dita shuhet sysh, e ngrata...

USHTARËT E ËNDRRAVE

Nuk shoh më ëndrra
Kaptoj botën time dhe gjendem në një tjetër
Pa zhelet e kësaj bote.

I pata nisur dikur në beteja
Ushtarët e pavdekshëm të ëndrrave
Ushtonte trumbeta
Gjëmonte ëndrra.
U pata ngritur monumente
Dhe gdhendur krahë
Ushtarëve të ëndrrave të mia.

Janë kthyer prej kohësh
Dhe unë prej kohësh fle mbi mermer

Kalojnë aty pari ata, ushtarë
Ende të parritur ,
Lëpijnë plagë imagjinare.

Eshttrat e mia mbetur mbi ëndrra
Gdhendin me mundim
Emra besnikësh.

Tani mbi shtrat të bardhë
Si pika e vesës, mbi gjethe fle,
E në rrëshqitsha
Do të jetoj në zemër të Detit.

DUART E MIA RREKEN TË MBAJNË ZËRIN TËND

Duart e mia rreken të mbajnë fort zërin tënd
Që kumbon
Ndër kupa të vogla qiejsh të coptuar
Zërin që hopet,
Perplasht, derdhet e jehon,
Mureve të bardha
Nga llërët pikon teposhtë
Kyçeve të imtë,
E dua ta mbaj.
Ta mbaj dhe i thërras me shkulm
Lëshoj gjithë lukuninë e kordave të mia të memecta
Por zëri yt shkon tej përtej atje,
Përmbi bedenat e një ëndrre
Të vetmuar
Ndrydhur në kështjellë harrese.

Nuk më dëgjon, më zbraps,
Më ngrin ndër duar
Dhe bëhem shtrati i lumit të askund
Thërrmohem, bie, bëhem blu,
Derdh trupin e pastaj,
Dergjem plot plagë në dete...

Prej vitesh, që kur tirqit që i qepte e ëma me serxha të vjetra zunë t'i binin shkurt e deri kur u stërkeq nga pleqëria, kishte hapur varrin e çdo të vdekuri në fshat. Kuptohej që varret nuk e hapte krejt i vetëm, por ishte ai që do të piketonte drejtimin e kokës së të vdekurit drejt Perëndimit, do të saktësonte thellësinë e varrit dhe do të sigurohej që varri i ri nuk do lëndonte ndonjë kockë të vjetër. Sa herë hapte një varr, soste një kuti me duan. Atë natë përpëlitej në shtroje dhe shihte ëndrra të çuditshme. Por që do të hapte edhe varrin e Shabanit, që ishte jo më pak se dhjet vjet më i ri se ai dhe që kishte jetuar në këtë jëtë kobshëm, si brenda një varri të hapur, nuk e kishte shkuar ndërmend.

Shabani kishte jetuar gjithë jetën e tij, vetëm, në një shtëpi të fikur, bri shtëpisë së varrmihësit. I thonin shtëpi e fikur, sepse trembëdhjetë pjestarët e saj vdiqën nga fruthi i zi. Mbeti gjallë vetëm Shabani. I mbetur jetim, u rrit me lëmoshën e shpirtmirëve dhe një ditë vendosi të kulloste lopët e fshatit. Nuk merrte pagesë për to. Por as përulja dhe as kullotja e lopëve pa pagesë, nuk e fshinin të shkuarën e tij, që e la beqar gjithë jetën. Ai nuk shkonte kurrë në dasma. Ende fshatit gjithë zhele me lopët para, duke kruar herë pas here me një shkop gungën e pasqafës, që siç duket më vonë do t'i merrte dhe shpirtin.

Të gjithë e shihnin shtrembër dhe me pështirojse. Lahej rrallë. As vetë nuk e pati kuptuar se nga e mori guximin atë natë. Doli para pasqyrës së një llambe të vjetër me vajguri, shkurtoi pak mjekrën, veshi një palë rrobe të një të vdekuri, që e kishte lënë botën e të gjallëve veç dy javë më parë dhe iu avit ahengut. Në fillim u ul në pjesën e pandriçuar të oborrit, nga frika se mos e shihnin dhe do e dëbonin. Por kur u këndell nga muzika, zuri t'i afrohej turmës që kërcente. Disa e vunë re të gjorin, por nuk e nganë.

Në plemë, Ali Batakçi, mbaroi punë shpejt e shpejt me një nga nuset e shtëpisë dhe zbriti ne qendër të fshatit, duke u zhdëpur me raki. Të nesërmen, hapi lajmin në të gjithë fshatin, se Shaban mjeranin na e paskësh parë në plemë me më të bukurën nuse të shtëpisë se Çelajve. Shpirtligësia e tij donte të shpifte diçka, që këtë nuse të dërgonin në shtëpi si të damkosur nderi. Atëherë, ai ta kishte më të lehtë t'i hidhej dengjeve të barit. Lajmi u hap në fshat si kolerë, por Shabani nuk dinte asgjë. Vuri lopët para dhe sosi në mal. Një tufë djemsh, nga ato që ende nuk kanë vënë brisk fytyrës e kishin rrethuar. Ata zunë ta tallnin, ta shanin, madje dhe ta gjuanin me gurë. Shabani kishte një jetë që kishte duruar ato tallje, sa herë e shihnin tek kruhej. Një vrer i kahershëm i shpëtheu shpirtin dhe klithi me sa fuqi kishte, por djemtë nuk deshën t'ia dinin, iu afruan edhe më. Secili prej tyre mbante në dorë nga një thupër. Iu sulën sipër duke e goditur dhe duke e përplasur. Por nuk qe kjo më e keqja. E tmerrshmja qe, se ia bënë dhunshëm, si një femre të dorëzuar, pa pikën e mëshirës. Turpi mori dhenë. Shabani nuk doli me muaj nga shtëpia. Derisa një ditë, u shfaq në fshat më lopët para dhe sytë fikur, ngulur në gropat e udhës. Që nga ajo ditë dhe për tridhjetë vite të tjera jetoi kokëulur, por i pafaj. Viteve të fundit të jetës, pas privatizimit dhe shkrirjes së kooperativave, tufa e lopëve iu shtua. Ai sfilitej dhe më shumë nga lodhja, por mahnitej kur zbriste xhades për në shtëpi. Kurrë në jetën e tij nuk kishte parë aq shumë njerëz, makina dhe flamuj shumëngjyrësh. Ishin kohë zgjedhjesh. Detyra e re e Shabanit

PENGU I NJË VARRMIHËSI

Tregim nga Shqiponja Axhami

në këto kohë ishte të ngjiste nëpër trungje, shtylla, mure avlishë e kudo ku kishte ndonjë hu, foto kandidatësh. Një herë e zhdëpën në dru, sepse mu në mes të fshatit, në kryqin e fundit të Udhës së Epërme, duke u ngutur se i duhej të lëshonte lopët, ngjiti foton e një kandidati me kokë poshtë. Katër javë nuk doli jashtë plagëve. Por, gjithsesi, këndellej nga një tis i papërshkrueshëm gëzmi dhe e ndjente veten të vlerësuar, kur një grup, nga ata të lartit, e fusnin në mes duke i thënë se kishte një mision të rëndësishëm, ngjitjen e fletëve. Shumëkush në fshat Shabanin e thërrisnin me ironi, "I marumi". Ai nuk u martua kurrë. U plak mes trishtimit dhe vetmisë, duke ngushëlluar veten me kullotjen e lopëve dhe ngjitjen e fletëve. Ndaj, kur e akuzuan se kishte vrarë një kandidat të majtë, burrë ding, rreth njëqind kile, askush nuk e besoi.

Ditën e vrasjes, Shabani kishte ngjitur gjysmën e fletëve, pjesën tjetër e pati vënë poshtë të ndjenjurave. Një gjumë egjre po e ndillte si zuskë. E zgjuan tufa e lopëve, që i kishte marrë miza. Pritej një shi i madh, sepse një zagushi të merrte frymën. Shabani u ngrit i trembur. Duhej t'i mblidhte me patjetër kafshët dhe t'i drejtonte Udhës së Ndërmjetme.

Stuhia mbuloi fshatin dhe një mantel i zi iu fashit udhëve. Dukej si natë. Shabani përcolli me mundim në shtëpinë e vet secilën lopë. Vetëm një viç i larmë nuk po i bindej. I ra fund e krye udhës kryesore të fshatit, futi dy –tri herë turinjtë në gardhe misri dhe si të qe tërbuar, dukej se po matej me stuhinë. "Duhet të jetë trembur," mëmëriste me vete Shabani dhe vraponte t'i dilte para, që ta kthente në shtëpinë e të zotit. Në njërën dorë mbante një shkop me dorezë, me tjetrën ngrinte poturet, që ligësuar sa më s'bëhet, i rrëshqisnin poshtë të ndenjurave. Stuhia sa vinte dhe bëhej më e çmendur. Në udhë nuk kishte këmbë njeriu. Shabani i doli dhe dy –tri herë viçit mjatas, djathtas. Në fund viçi u dorëzua, pëlliti dy –tri herë si të kishte parë diçka të pazakontë dhe ndaloi në vend duke varur kokën. Shabani u kujtua për fletët, "E marrtë dreqi", - tha me vete, "do e ha prapë ndonjë dajak. Të paktën t'i ketë marrë kjo e çmendur stuhi". Tek bluante ndjesitë e frikës, ndjeu se shiu i qe futur në palcë. E solli në vete pëllitja si e mbytur e viçit dhe mori hov të kalonte përroin e formuar nga rrebeshi. Kur doli në anën tjetër, viçi pëlliste mbytur, mbi një gjë të zezë, të madhe. Stuhia ulërinte dhe një llavë rrufeshë iu lëshuan qiellit të asaj as dite, as nate.

"Eja larosh, eja, mos u tremb!" e ndolli me një zë të butë viçin, duke e prekur lehtas në fundshpinë.

Viçi kishte ngulur kokën në gjënë e zezë dhe si të qe tërbuar nga gjaku, nxirrte një hungërimë të tmerrshme. Nuk e dalloje dot, nëse ishte pëllitje viçi apo e qarë njeriu. Një klithmë zanoresh dilyn nga goja e kafshës, nën një timbër të çuditshëm. Shabani u drodh frike. Poshtë kokës së viçit endur sa gjërë- gjatë, shtrihej një njeri. Shabani shtangu, e njihte fort mirë. Ishte njeriu i fletushkave, kandidati. "Duhet ta ketë çarë rrufeja faqezium" tha me vete. Si gjithë fshati edhe ai e dinte që kandidati ishte një njeri shpirtlig dhe me shumë vese. Në fakt kandidatin e kishin vrarë. Jo pak, por shtatë plumba i kishin depërtuar trupin. "E ç'të duhet ty kjo", i bërtiti vetes Shabani, duke i rënë butë viçit në kurriz.

Të nesërmen nisi makthi tjetër i jetës së tij. Lajmi mori dhenë se Shaban mjerani, rojtari i lopëve, na paskësh vrarë kandidatin. Biles e kishte shtrirë mu në mes të udhës, mbi një tog fletësh të tij.

Këto kujtonte varrmihësi i mbushur me një mllëf, që i digjte si lëmsh i zjarrit në kraharor. Pikëllohej kur hapte një varr, por rallë qante. U përlot. Ai ishte i bindur në pafajsinë e Shabanit, në pafajsinë e gjithëjetshme të tij. Kur po gërmonte pëllëmbën e fundit të varrit, iu kujtuan fjalët e tij thënë në gjyq.

"Zoti gjykatës, unë po ndiqja viçin e Poçarëve. Ju betohem në Zot". Pas kësaj fjalie, kishte ulur kokën dhe kishte pyetur një biçim avokati, të cilit nuk i dinte as emrin. "Njeri a e njohin gjykatësit, Zotin?". Pa prituri që avokati t'i kthente përgjigje, kishte vazhduar. "Zoti gjykatës, unë jam një rojtar lopësh. Jetoj që në vegjëli i vetëm, e dinë të gjithë. E ku kam mendere unë, që të vras një kandidat. Unë po ndiqja viçin e Poçarëve. Një dreq stuhie shpërtheu fytit të qiellit atë pasdite. Nuk jam fajtor, zoti gjykatës, më besoni. Di të them që nuk jam fajtor, as për ato që shkruajnë botuesit e gazetave. Një ditë më morën zvarrë, tek po ngjisja lopët shpatit. Më futën në një kthinë të terrtë. Ali Batakaci, Aliu i thetores së Lagjes së Epërme, ishte njëri prej tyre. Besoj e njihni zoti gjykatës, Ali Batakçiun. Ç'nuk ka shpifur e vjedhur gjithë jetën e tij, zoti gjykatës. Por atë askush nuk e nget. E kam parë me këta sy edhe duke lëvizur kufinj të në ngastra. Është punë e ligë shumë, zoti gjykatës, të luash me kufijtë e tokave. E ç'faj kam unë, zoti gjykatës. Ata më detyruan të bëj dëshmi të rreme. Sikur unë kisha parë, ata që kishin vrarë kandidatin. Më thanë t'i mësoja përmendësh fjalët, që kur të vinte gazetari, të isha i gatshëm. Por unë i harrova të gjitha, zoti gjykatës. Që thua ti, unë nuk mbaj mend as çfarë kam ngrënë mbrëmë, e jo të mbaj mend një tufë gënjeshtër. Gazetat shkruajtën ç'u deshi



qeji pas asaj dite. Një palë më akuzonin, pala tjetër më mbronin. Më tha me gojën e vet varrmihësi, fqinji im "Mendje të mëdha janë çuar në këmbë, kritikë, botues". Të gjithë mbakërkan në gojë emrin tim. Pas një jave m'u turrën përsëri, Ali Batakçi me shokë. Më lanë gati të vdekur, zoti gjykatës. Dy javë kam zbutur plagët me jaki. Ka qenë e tmerrshme, zoti gjykatës. Nga jeta e një çobani të mjerë, mësuar me vetminë e tij, më është dashur t'u ik me vrap gazetarëve. E ç'faj kisha unë? Unë po ndiqja një viç larosh dhe krejt papritur gjeta shtrirë, një kandidat të vrarë. Ditën kur më arrestuan, më është dashur të vrapoj zvarrë e gjunjazi dy kodrina. U futa në një shpellë ku fshihesha i vogël prej breshërit. Por dhe aty më gjetën, zoti gjykatës. -Po, po, ishte prapë Ali Batakçi me një turmë të rinjsh të dalë soji e sorollopi. Më rrahën e ç'nuk më shanë. Por, më besoni zoti gjykatës, ata donin me çdo kusht, që unë të pranoja fajësinë, ose të bëja dëshmi të rreme. Jam i bindur që kandidatin e kanë vrarë ata vetë. Disa herë, mes shqelmave, e dëgjova fort mirë Ali Batakçiun: "Do pranosh akuzën, ose do të të çoj të tretesh me të", që do të thotë me kandidatin. Unë trrusur nga frika në këndin e shpellës, nuk dija ç'tu thoja. U thashë se nuk di të gënjej dhe as të shtirem. Ata më rrahën aq keq, sa plagët i kam edhe sot. Por më bësoni, zoti gjykatës, nuk jam fajtor. Unë isha aty se po ndiqja një viç të larmë, që u çmend nga moti i keq." Këto kishte dëshmuar në gjyq Shabani.

Dy netë para se të jepte shpirt, kishte trokitur në derën e varrmihësit, i dërmuar, pas gjashtë muajsh hetuesi. Si duket gjykatësit e kishin kuptuar që po vdiste dhe në mungesë provazh e kishin liruar. Varmëhisi nuk do ta harronte kurrë bisedën e fundit me të. Pak para se të jepte shpirt, Shabani ia kishte ngulur sytë thellë. Mezi mbushej me frymë, por donte me shpirt që t'ia tregonte të gjitha. Varrëmihisi e kuptonte që ai donte që të ikte nga kjo botë i pafajshëm, ashtu siç ishte në të vërtetë. Shabani pati mërmëritur mes lotëve, duke i thënë: "Duhet ta dish. Edhe në qeli më rrahën pa dhimbje. Edhe aty më vunë për fundi. Edhe aty ma bënë më keq se një femre. Përsëri...Ali Batakçi me shokë...". Këto kishin qenë fjalët e fundit të Shabanit dhe kishte anuar kokën, duke dhënë shpirt. Varmëhisi qe këputur në shpirt. Një vullkan urrejtje i kishte shpërthyer brinjëve, duke u dridhur inati dhe pamundësie.

Shabanin e varrosën në të dalë të agimit. Nuk kishte askënd të largët që ta prisnin. Qe një varrim i ftohtë, ashtu siç qe jeta e tij.

Atë natë, pas varrimit, varrmihësin nuk po e merrte gjumi. U drodh dhe u

shpërdrodh në postiqe. U ngrit, piu dy broke me ujë dhe drejtoi sytë nga qielli, duke u lutur që ta zinte ai i bekuar gjumë. Kishte një kureshtje të skajshme dhe mezi priste se me ç'ëndërr do e miklonte vdekja e Shabanit. Pas mesit të natës, kur u ndal dhe e lehura e fundit e qenëve, u kot në një përgjumje të trazuar.

Nuk e kuptoi nëse ishte në ëndërr apo zgjuar, kur

në mes të varrezave, tek varri i Shabanit, dhe zuri të dridhej. Qe mbledhur i gjithë fshati. Banorët i lajmëronte vetë ai, varrmëhisi, duke çjerrë zërin “Oooo Milet, Shabani ka një amanet”. Pasi thoshte këtë fjali, i binte një daulleje që nuk ishte si daullet e zakonshme, por ishte një baule në formën e një kafke. Kur u mblodhën pothuajse të gjithë, varrmëhisi vuri re se mes banorëve kishte edhe të gjallë, edhe të vdekur. Ai pa shkoqur kandidatën, kryetarin, botuesit, gazetarët, kritikët, Ali Batakçiun dhe një rresht të vdekurish, që kishte varrosur së fundmi. Ndërkohë që thërrsite, varri i Shabanit dridhej dhe më shumë. Të gjithë prisnin që prej tij të dilte Shabani i ringjallur. Pas pak, gurët e varrit u shpërndanë nga një forcë e madhe e brendshme. Të pranishmit shtangën nga frika, makthi dhe turpi. Prej varrit u ngrit Shabani me një penis gjigand, që tundej e tundej. Ishte e tmerrshme. Varmëhisi shtangu. Shabani bëri disa hapa me penisin gjigand të drejtuar nga banorët. Gratë zunë fytyrat më duar, por e vështronin përmes gishtave të mahmitura. Burrat ulën kokat të llahtaritur, që gjithë kjo po ndodhte para syve të grave të tyre. U dëgjua një pshëritimë gruaje, pastaj dukush lëshoj një “Ah” të mbytyr. Meshkujt të tmerruar donin t'ia mbathnin, por këmbët u kishin ngrirë.

Varmëhisi po shihte mankthin më të ethshëm të jetës së tij. Të pranishmit të hipnotizuar binin rathë- rathë mbi njëri- tjetrin. Pas pak Shabani i bëri me shenjë Varmëhisisit. Duhej t'i ngjiteshin një kodrine. Varmëhisi i shkoi mbrapa. Morën shpatit të kodrinës dhe sosën tek një rrafshinë mbuluar më sherbelë. Ndërkohë, poshtë në varreza, turma lëvrinte ende nën ekstazë

Shabani ndaloi në mes të rrafshinës. Penisi gjigand midis këmbëve pothuajse i qe zhdukur.

Varmëhisisit iu mbushën sytë me lot. Deshi të klithe, por nuk bëzajti. Fjalët e Shabanit ia prenë zërin. “Unë nuk kam vrarë askënd, më beso. Bota e të vdekurve më besoi, por ende nuk kam shkelur në kopshet e parajsës. Të lartit e botës së përtejme më kanë caktuar të jetoj në këtë rrafshinë me shërbelë. Nëse nuk gaboj, i thonë Purgator. Më thanë se jam i pafajshëm, por ende nuk mund të shkoj në parajsë. Duhet të shlyej duke u endur në këtë rrafshin me shërbelë, mëkatin tim të vetëm, borxhin e madh që i kam vetes.”

Atë çast varrmëhisi kërceu përpjetë dhe u zgjua. Të brendshmet i kullonin ujë nga djersët. Diçka i diqte në kraharor, një si varrë, një si peng. U ngrit me rrëmbim dhe u fut në kthinën e terrtë, ku ruante me merak një thikë të mprehtë, të cilën e ngjeshi në brez. Sosi na haurin e kalit, e zgjidhi, e shaloi, hipi mbi të dhe u ngjit vetëtimë lart. U fut vrulltas në thertoren e madhe të Lagjes së Epërme dhe doli po vrulltas. Pas një copë here shkoi të çlodhej në koliben e tij, tek Porta e Varrezave. Të nesërmen do i duhej të hapte varrin e Ali Batakçiut.

FRYMA IME E DËSHIRON SHIUN

Poezi nga Daniela Xhani



HABITUS MENDOR

Një asgjë e pakuptuar në strofkën e mendjes
që shkul yje e thellimit mbjell fytyra
shpërfillëse, nganjëherë, kaq mizore
siç gishtërinjt' e kthyer në gjallesa pa sy
tekta bien në rrëfimin e trupit,
për asgjë e lehtë përsëri errësira
mbivendoset
gjerë-e-gjatë në gjithçka që e lodh
kujtesën
sikundër gishtat mbi kodin e heshtjes;
heshtje brenda heshtjes,
ca trajta të pakuptuara
që ndahen.

QUID EST VERITAS?*

Një grua e zhveshur lakuriq
vështrohet në pasqyrën e mbuluar
që ruan imazhin e saj.

PRODIGIO

Mënyra sesi bie drita, këndi i
përthyerjes
i ngushtë; muri brenda që zhduk
njerëzit
por jo kujtesën. Vogëlima sidoqoftë!
Në parajsë ende s'është zbuluar zjarri
veç fryma cifloset e ngrohtë në
patrajtë,
këmbët zgjerohen – që do të thotë
heshtje
– në tempull. Dhe ti i dashur brenda
meje
që kërkon me ngashërim Zotin...
Jam një krijesë e trishtë; kaq vite që
nuk qaj.

FRYMA IME E DËSHIRON SHIUN

Fryma ime e dëshiron shiun,
duart e tua mbi tavolinë
mëngë dhe heshtje bashkë
bojë gështenjë. Në brendësi
zëri që flet më përhum
nga lagështi e kodrave.
Mos vallë, mendimi i mbramë,
kërkon t'i fshihet
anatomisë së mendimit?

LACRIMAE RERUM

Kur trupi ra nga qielli, i lëngët si të
metat e botës,
përfshirë kujtesën e përsëritur që
ndëshkon fluturimin
pak mbi krateret e milingonave,
sytë me bindje të parakohëshme
dhe gojën e pezmatuar me natë,
brendia e marrosur bërtiti fort, –
mbase e vetmja gjë e vlerë – kuptomë!
Dhe as që e shtrëngova atë çast
pafajësie.
Më fort kuptova trupin e gruas
që u hodh nga dritarja e ëndrrës.

PAK

Pesë qirinj të ndezur, burime drite
mbi kurbën e fytyrës – asaj here,
në rreckosje pashe muzgun të rrëzohej
dhe kohën të prishej lëkurës së qiellit
me re të rrëshqitshme – ngado
çdo përkulje shëmbëllen shenja
si arna në largësi të njëjtë
dhe pëllëmbën që mat barkun e butë
dhe zanoret e zgjatura, teksa një çast
hijet e trupit lakuriq mblidhen
brenda kapelës së zezë të magjistarit.

SHI GJAKU

Dritarja e shtëpisë së braktisur
në një mëngjes me shi...
Njolla gjaku në mure – fluturat
që gjithë natën dolën nga krizalidat
pa lëshuar asnjë tingull.

Pema, gjuha e reve, harmonia e
shkurtër
e kohës, mes zgjimit dhe duarve;
gjethet e sipërme që pikojnë më
poshtë;
të poshtmet që pikojnë këmishën
ku kopsa e tretë ka mbërthyer vrimën
dytë.

TRE

Ne kët' dhomë gjysmë të errët
që i jep thelb bardhësie lëkurës,
ankthi ul qepallat në bukuri intime
nën purtekat e zbehta të dritës,
që formojnë trekëndësja në pasqyrë,
besoj tek diçka e çfarëdoshme
në gjendje të përmirësuar,
Zoti është një trekëndësh i
çfarëdoshëm.
Tash që flas me veten, heshtur,
duke lëvizur gjymtyrët e përveshura
mbi njollat e gjakut
përpiqem të lidh tre dhimbje të bukura
për të cilat ndoshta vetë jeta ia vlen.

*Fraza (pyetja) gjendet në Ungjillin sipas Gjonit 18:38.

Nata 17 Maj 2020

Teatri vdiq si i kishte hije,
Në skenë, jo diku tjetër...
Edhe pse ishte natë.
Nuk është luejtë kurrë një tragjedi a komedi
me ma shumë aktorë në të.
Qemë rumbullak 800 policë ia vunë
shqelmin në fyt,
Thua të kishin parë të gjithë në teatër sesi
vritet një hero,
Njërin prej policëve e njoh.
Ai më tha se kishin qenë më pak.
I besova se e kisha pasë spektator,
natën që pata vue në skenë “Hamletmakinën”.
Dukej zotni atë natë
me të fejuemen në të djathtë.
Më pyeti të nësermën nëse do jepej prapë
Por i thashë se e nesërmja qe anullore.
Ka vetëm të sotme.
Prandaj polici me numër devize 2314
Mbeti i pakënaqun atë natë,
Sepse Teatri nuk kishte pasë diçka të
përgatitun për “biz”.
Nuk pati kohë për një solo të fundit.
Jo se i mungonte teksti
Porse ca tipa dashamirës, kllounë
revolucionesh,
Kishin humbur maskat në nxitim e sipër.
Megjithëatë mizanskena gjithsesi u
respektua.
Nga sytë e teatrit doli gjak në formë shtyllash
të kuqe
projektorësh mjeranë.
Konferencieri i kapur për krahësh arriti të
shqiptojë vetëm:
Shplajeni vrasjen nga fytyra Princat e mi
dhe bëni një fytyrë të qeshur për Danimarkën
e Re.

Tiranë, 18 Maj 2020

Milloshit

Sonte ishte ftohtë,
s’ishte e lehtë të përgjoje.
Por ama ishte e njajta skenë:
Ti atje mbas dritares së dhomës tande,
ngjitë me një tjetër dhomë,
ku vazhdon të festohet diçka...

Unë edhe sonte u mahnita me indiferencen
tande.
Si nuk ngrihesh të mësosh se kush dhe për
çfarë
festohet te dhoma,
ngjitë me tanden?!

Nuk kuptoj asgja.
Nuk e di sepse të duhet të vishesh shik
që të shkosh në takim atje,
si të jeshë duke shkue në takim me kohën,
Në krah të kujt asht koha?

Kësisoj ndalem aty poshtë për të kuptue
diçka.
Edhe pse sonte asht ftohtë,
dhe s’asht e lehtë të përgjosh:

Drita u fik, u ndez, u fik si të ishte një blic
gjigand
që të ndihte të fotografoje gjallesat përreth.
Mandej m’u duk se ti u çmende
U çmende në formë zogu
me sqep të gjatë,
të zi
prej të cilit doli një gjuhë
e hollë,
e kuqe,
të cilën ia drejtove një e nga një,
të gjithëve,
që po festonin në dhomën përbri.

Shkodër, 05 mars 2022



Poezi nga Stefan Çapaliku

Prishtina e pame prej synit magjik

Asht një derë që na ndan,
një derë me sy magjik në ballë.
Një portret ciklopik,
i rrafshët
si derë,
si derë që hapet
si derë që s’hapet
si derë.

Një sy magjik
lypë synin tem t’i rraset.
Më lypë beben e synit,
Irisin,
ma lypë.

Jemi sy që bajnë dashni
tanë natën.

Shoh matanë derës
Prishtinën
Prishtinën e mysët
Prishtinën e lugët
Konkave e konvekse

E kështu e luejmë lojën,
me rradhë.

Mandej asht Prishtina që më shikon
Kushedi si i dukem
Më vjen marre
prej vetes,
për veten,

Gjithcka ndërkohë rritet,

plaket.
Veç syni rri ashtu i vogël,
i pafajshëm,
i parritshëm,
i paplakshëm,
si një sy magjik,
i bamë për ne
për me pa njëni tjetrin
deri në imtësi,
deri në bardhësi
të lakuriqsisë tonë
të pamarre.

Prishtinë, 8 Mars 2022

Shishe në det

Edhe ti ike...
Unë mbeta i fundit në anijen
që era e sillte si të ishte prej letre,
sepse ishte prej letre.

E ç’mund të të ofroja unë veç fjalëve,
të shkruara në një letër fletoreje me vija,
me të cilën prodhova anijen prej letre?

Fjalë my Lady,
You look truly charming, my Lady.

Mandej unë zgjata dorën te
radiotransmetuesja
dhe nisa në ajër mesazhe të koduara
në alfabetin mors:
Ju flet Shkodra!
Po transmetojmë disa mesazhe speciale.

Fjalë my Lady,
You look truly charming, my Lady.

Lumturia nuk ndjehet mirë
Durimi po nxitohet
Besniku tradhëtoi
Kujtimin e çmendit harresa
Mendimi po rri trishtueshëm
Fitimtari humbi pjesën e parë
Shpresa vdiq e fundit
Mos kujto se të harrova (Pikë)

Mbas këtyre mesazheve të verteta,
por aspak miqësore,
pashë anije të mëdha që u afruan të
shpëtonin
tonën, që po mbytej.

Por, kur ata vërejtën se ti po dilje shëndosh,
ashtu e gjatë, e bukur e pacen...
Kthyen nga kishin ardhë.

Ndoshta kujtuen se po tallem...
Prandaj unë vazhdoja të emetoja fjalë...

Fjalë my Lady
In the meantime
you look truly charming,
my Lady.

Çelikut i vrasin këpucët
Soses i erdhën ato (Pikë)

Dhe kaq
anija u mbyt,
unë bashkë me të.

Natën e mirë dhe
flesh rehat, my Lady.

Pije shishen me mesazhe,
E gjen diku ndër valë...

Clever, young and charming,
My Lady

Tiranë, 14.03.2022

O Zot, sa naiv jam kur shkruaj
poezi...

Poezinë time të fundit e kisha ruejtë në
portofol
Në portofolin që ma vodhën sot,
në autobuzin urban.
Ishte një poemë me shumë fletë,
aq sa për t’iu dukë dikuj
një portofol i mbushun plot.

Ishin fjalë të mira, të buta, të ngrata
Shpesh të paqëllimta.
Përmendeshe ti herë mbas here
Nuk e di pse.

Nuk e di sepse qe e nevojshme
që të përmendeshe ti
në atë poezi fatkeqe
Ndërkohë që unë e dija krejt mirë
se atë portofol do ma vidhnin

O Zot
Sa naiv jam kur shkruaj poezi.

Prandaj dhe jam në hall
Se mos ai budallai që më vodhi portofolin
do e lexojë
Ndoshta do e lexojë me shokë
Me za të naltë
Sonte
Kur të jenë duke pi
te klubi i mëhallës
dhe do më shajnë me fjalë të ndyta
sidomos kur të lexojnë vargjet e fundit,
Aty ku shkruhet se të desha fort...

Tiranë, 14.03.2022

Në vdekjen e dajës tim, dr. Thoma Dardelit

Ashtu i shtrimë dukesh i bardhë,
si një ushtar i bardhë,
i thirrun ndën armë,
si një ushtar i bardhë shahu.
Pedinë e bardhë,
e vetme,
fillikat i bardhë,
prej atyre që befas ia dalin
të kthehen në mbretneshë,
të bardhë.
Sonte je një shahist fitimtar,
i sapo dalë nga një simultanë,
në të cilën humbjet nuk qenë gjithaq të
rëndësishme...
Fundja vetëm dy herë humbe thellë
në jetën tande,
të bardhë.
Dy herë që të munden ushtarët e tjerë,
të kuq...
Ti rri sonte shtri,
ma elegant se kurrë.
Lirue prej borxhesh të pagueme shtrenjtë,
me burg...
Ti sonte po fle me shijet e fitoreve,
si atëhere student, më 1956,
dhe me të gjitha kujtimet si këmishë e
zbërthyme,
me flokë dhe dëshira në erë,
diku mbi ndonjë urë të bardhë,
në Danub...

Tiranë, 27 mars 2022

Kujtim fëminije

Ne pamë sesi ajo zbriti nga bicikleta.
Pamë sesi ai e mbylli bicikleten me zinxhir.
Ne gjendeshim në anën tjetër të trotuarit,
ishim të gjithë adoleshentë.
Ne sapo kishim nisë të masturbonim,
(ngandonjëherë edhe në kolektiv)
Ne pamë sesi ai e mori atë prej dore.
Ajo ishte krejtësisht e bardhë,
ajo kishte një lëkurë prej qumështi.
Ne thamë me vete se,
nëse ai do ta shtërngonte,
asaj do t'i nxihej lëkura...
Ajo qe krejtësisht me flokë të verdhë,
të gjatë, me këmbë të zbuluara poshtë
një fustani blu, me pika.
Askush s'e vuri re atë.
Asnjeni nuk e di sesi ishte veshë ai
Ne dimë vetëm se ai e mori për dore
Ata u ngjitën lart për shkallash,
si në qiell, në katin e dytë.
Në katin e dytë ne pamë se ai
nxorri krahët e vet jashtë
dhe mbylli dritaret.
Ai mbylli dritaret me grrila të randa.
Kurse ne mbetëm aty poshtë.
Heshtëm.
Dhe mbyllëm sytë...

Tiranë, 30.03.2022

Ujk në Ulqin

Në Ulqin bie shi.
Asht ende dimën.

E unë jam kaq vetëm, sa duket sikur
kam dalë të zbuloj të vertetën:
Që Ulqini dikur qe vend ujqish?
Apo se prej këndeje vjen
d'Ulqinja e Tobozëz?
E dashtuna e Servantes,
ajo që e pati grabitë kur kaloi këndeje?
Nuk e di.

Asht ftohtë.
Deti te plazhi i vogël bërtet me të madhe,
si me qenë ndër tortura.
Unë sillem vetëm.
Asnjë d'Ulqinjë nuk duket.
Servantes ka ikë prej shekujsh.

Kam ftohtë,
dridhem,
një dallgë përplasat për bordurat e betonit
më lagë, hungroj.
Një tjetër më ban qullë,
nis e skërmitem,
shpejt trupi im shndërrohet mbi trotuar,
filloi të ndjehem ndryshe,
ndoshta si ujk,
Ujk në Ulqin.

Ulqin, 31. 03. 2022

Në gjithë atë shtëpi

Në gjithë atë shtëpi,
dikur të zhurshme,
kanë mbetë vec katër-pesë pleq.
Në përgjithësi ata nuk flasin me njeni-
tjetrin.
Kanë folë boll,
një jetë.
E cka mund të thonë ma shumë?!
Takohen vec ndër shkallë,
kur hypin e zdrypin mundimshëm
për me krye
punët e veta,
sende të vogla,
me gjasë pa randsi,
si jeta e tyne.
E shkuemja e tyne kishte qenë e rrëmujshme:
Kthime të zhurmshme prej pune,
Të qeshuna me za të naltë.
Muzikë.
E mandej edhe ndonjë lojë me të ftuemit e
javës.
Dikur qenë shumë.
Ma shumë se karrige në sallonin e madh
dhe ma shumë se gota vene, që
herë mbas here thyheshin me zhurmë,
për me i ba të gjithë me kthye kryet e,
me thanë në kor “Për hajër na qoftë!”
Tani dhomat janë ma të mëdha se kujtimet,
Në to mund të luejn teatër po deshën.
Teatër kamertal, teatër pauze,
ku mungesa e ngjarjes,
asht vetë ajo:
Ngjarja.

Tiranë, 04 Prill 2022

Pezullime

Pezullojnë mbi krye yje,
diej të vegjël, që nuk më ndriçojnë...
E nuk kuptoj a janë ata që vrapojnë
të ikin larg prej meje,
apo jam unë që fugoj
t'ia mbathi prej tyne?!Kjo asht një pyetje që më mundon,
derisa prishet koha.
Kur moti ndërron e mbi kryet tem
pezullon një re e madhe,
shpirti meskin qetësohet
e ndihet mirë ashtu në gjysëmerrësinë,
me tanë të tjerët...

Shkodër, e diel paradite, 13 shkurt 2022

Nuk e di se çka presim

Nuk e di se çka presim,
e nuk ia hamë kryet këtij vendi?!Me kryet e tij kishte me dalë
një paçe e mrekullueshme
kambësh...

Tiranë, 21. 02. 22

BOTIM I RI NGA MINERVA

INFLUENCA: PSIKOLOGJIA E BINDJES


“Influenca është kënaqësi ta lexosh. Cialdini
meriton të lëvdohet për originalitetin e tij”.
—Contemporary Psychology

Influenca, libri klasik për bindjen, shpjegon psikologjinë se përse njerëzit
thonë po dhe se si t'i shfrytëzosh këto njohuri. Dr. Robert B. Cialdini është
eksperti pionier në fushën gjithnjë e në zgjerim të influencës dhe të bindjes.
Kërkimet e tij rigorozë dhe të bazuara mbi prova gjatë tridhjetepesë viteve,
së bashku me një program tre vjeçar studimi mbi atë çfarë i nxit njerëzit të
ndryshojnë sjellje, ka sjellë si rezultat këtë libër kaq të vlerësuar.

Do të mësosh gjashtë parimet universale, si t'i përdorësh për t'u bërë një
bindës i aftë dhe si ta mbrosh veten prej tyre. Një libër i përsosur për njerëzit
në të gjitha fushat e jetës, parimet e Influenca do të nxisin ndryshim të thellë
personal dhe do të shërbejnë si një forcë shtytëse për suksesin tënd.

WWW.INFLUENCEATWORK.COM

ROBERT B. CIALDINI, PH.D., punon në dy departamente në Universitetin
Shtetëror të Arizonës. Ai është një pedagog i Dalluar i Marketingut në
Universitetin W. P. Carey, pedagog i Psikologjisë në Universitetin Regent
dhe është emëruar Pedagog i Dalluar i Kërkimeve Universitare. Dr. Cialdini
është gjithashtu president i Influence at Work (www.influenceatwork.com),
një kompani ndërkombëtare trajnimesh dhe konsultimesh mbi bazën e
kërkimeve të tij novatore për zbatimin etik në biznes të shkencës së bindjes.



KËNGË

Ëndërroma një pyll ku të gjithë
bredhat
ta humbasin rrugën

vallëzoma një re
një bosht një lëndinë

vërshoma një pus nga
përplasjet
e pulsimeve tua

ngritma një tokë
për muajt hënor të buzëve të mia

ledhatoma një erë
dhe përqafoma një det

vritma një kërcim mes
shkëmbinjëve

mbi dorën tënde

harroma një rreth argjendi
mbi ballin tënd

Sytë e tu janë lumenj të ngrohtë
Por unë dëgjoj një zë nga thellësia magjepëse e pyllit
Që loz mbi rrënjët dhe trungjet e dredhura
dhe hedhë çarçafin e vet
mbi shushërimën e gjethit

Asnjë shtazë e egër nuk vallëzon mes trungjesh

Në atë pyll muzgu është tepër i kuq
dhe anemonet rriten të gjata sa pemët
Nga petalet e tyre unë pi zërin
që është harresë e natës

Ftohtë më shikojnë shtazët e rënda dhe të panjohura
mes trungjesh
Valët e reve zbukurojnë brirët e tyre
por mua akoma më kujtohet
dikush që vallëzonte

Ah cili lum do të ndaloj këmbët e mia
dhe do të shmangë zjarrin e akulltë të duarve të mia

Janë lumenj sytë e tu?

Lumenj të zi rrjedhin qiellit
pëshpëritjet e tyre vallëzojnë gjakut tim
Ç'rëndësi ka nëse i shmang
dhe e fsheh fytyrën time ndaj pushtetit
dhe bukurisë së tyre të madhe
Rrobat e mia tashmë janë djegur në plazh
më duhet tërë jetën të jetoj lakuriq
se asnjë anije nuk do të më bartë të gjallë
nga ky bregdet

Përmytmeni atëherë lumenj nga zemra ime
që është zemra e tokës dhe qiellit!
Shpërthemëni dhe ikni tutje me krahë yjesh!

O shtylla shtegëtimesh
rrathë dhembjesh e gëzimesh
le të shpërthejnë harqet e ritmeve tua
kah lëkurë e ndritshme ndër vena

Ky është zjarri që më çliron nga vetja ime

Bëhu vdekja ime sonte
ti që je kamxhik dhe burim
më farko në dallgë
më të buta
më ëndërro në dënim
më të gëzueshëm

Mbret i valëve
mbret i të gjitha organove i të gjitha rrugëtimeve
i të gjitha vendeve përtej gjithë detërave
i të gjitha erërave që presin



RUT HILLARP
(1914-2003)

këshillë për
Izoldën

Përktheu nga suedishtja
Qerim Raqi

dhe zgjohen
dhe rriten
po, më shuaj stuhitë e mia
me stuhitë e tua.
depërto klithmat tua kënetës së flamujve të klithmave
të mia
shpërthe bodrumet e mia, katakombet tua
ku rritet uji
po je ti je ti që ekziston!
e di, shtigjeve të mia jetojnë
organot tua në dorën time mbi fytyrën time
të gjitha muret
bien mbi trupin tim

në vdekjen time për
shtigjet
e gjymtyrëve tua

Errësira jote më është përshtatur
Brenda meje pushojnë
diejt dhe uraganët e mi

Më përshkojnë bregdete

I dashuri im fle në stuhinë e egër
dhe çdo natë e pres e lidhur për shkëmbi
Zinxhirët e hekurt m'i ngritin lartë gjinjët

drejt puthjeve të tij mahnitëse
dhe me vetëtima të arta
më shpon trupit
Një herë i pashë sytë e tij
Etja e tyre ishte e pashuar

Gjatë ditës prangat m'i ledhatojnë këmbët
për të rrënuar kujtimin e armatimit të tij të shkapër-
derdhur.
Por asgjë nuk mund ta qetësojë plagën e përgjakshme
të ndjeshmërisë
dhe floririn e zjarrtë të epshit
në vaginën time

Dhe ai që do të më çlironte
do ta përqeshja.

KËSHILLË PËR ISOLDEN

Ëndërra është sabotator i përjetshëm
dhe me lindjen e diellit ai duhet të vdesë

Por për trupin e bukur ti duhet të kujdesesh
Vendose pranë të tjerëve në anijen me velat e kuqe
dhe u thuaj lamtumirën aty ku qëndrojnë
në sarkofagët e tyre të akulltë me ndriçim të gjelbër
me qefinët e tyre të bardhë
pranë njëri- tjetrit
Anijen duhet ta dërgosh tek Tristani
që të pret në bregdetin e Cornvallit

Se ëndërrat kanë pirë gjakun e duarve te tij
ato nuk do të të njihnin tani.
Dhe fytyra jote do të mohonte afërsinë e buzëve të tij
Shpirtrat tuaj do të ishin shumë larg
dhe të huaj për njëri-tjetrin
dy zogj të kaltër
të nxënë në të njëjtën ikje
në të njëjten pabesi të perëndimit gjak të kuq:
një takim pa kufij
një vdekje që nuk ekziston

ORFEU

Pse të qajë kokën për ndalesat e tyre.
A nuk i krijoj unë vet ligjet e mia
në këtë errësirë të dredhur
aromën e saj të shqetësuar në qafën time

Një shkëndijë e fytyrës së saj
tani
është më e vlefshme se vitet e afërsisë,
vitet me fytyrën e saj në derën me kuti postare
Tani: shih , sytë e saj zmadhohen
në një çast përjetësie.
Gjymtyrët e saj të holla
në shpresë dhe dëshpërim.

Në njëmijë këngë do ta dua

GJUHA E NATËS

Ç'farë di unë për Tristanin
përveçse që më dashuroi deri në vdekje.
Ai e zbrazì gotën për mua.

Folur nuk kemi kurrë
Vetëm me sy dhe me trup.
Gjuhën e natës
me një shtëllungë kërcënimi të zbehur nga
shpërthime të rrugëve qumështore

Përse nuk e sheh atë
thotë mbreti

EURIDIKA

E mbyllur e mbyllur

dëgjoj gjakun tim si rrahë mureve
i thërret një dere
por këtu nuk ka dyer s' ka dritare s' ka tavan
vetëm mure mure
të tkurrura të ngurtësuar

ku jam
në cilën hapësirë

Është kjo zemra e tij?

Vetëm një çast ai ktheu kokën për të më parë
Vetëm një çast isha e vërtetë
Jeta ime zgjati një çast
Ndërmjet zbrazëtisë dhe pafuqisë

MËNGJESI I DITËS SË TRETË

Në atë çast pashë gurin lart pranë hyrjes së varrit.
Sa e nxehtë është akoma vdekja jote.

Nën qepallat e mia
agu i lotëve të huaj
kujtimi në anën time
djegur pas ëndrrës:
fytirën e kthyer shpejt kah këto faqe të fryera

Dallgë të kalbura
sërish pranë gurëve

Ta rrotullosh kah unë gurin e varrit tënd

gjumë i rëndë mjegull
e ngulfatur nga gjysmëpasqyrat
këpucët gojëhapur
jo nuk është e vërteta, por nëse gjenden
psherëtima për të ngulur këmbët në to

unë do t'i mbysja hapjet e deres sime
a duhet vallë t'ia dijë për këtë fytirë
këtë trup
nëse gjinden bregdete për të fluturuar
nëse gjinden dritare për të mos u hedhur nga to
kryqe për t'u mundur

Stepe

të ndezura

të Vetmisë

O më në fund guri
përtej të gjitha vetmive ti
aty brenda në ftohtësi
Si të të braktisë vallë për tallje të jetës
Ç'largësi guri yt, sa i thellë varri yt në mua
Kush e dëshiron vallë sërish jetën e vdekur
kush rrënon gurët nga varret e tyre
nëse jo për

O fresko këtu për turpin e këmbëve të mia
të pastrohem nga mishi
të digjem këtu për stuhitë e të gjitha ujërave
të kujtoj errësirën në telin e fortë të buzëve
të ngrihem nga kryqi

Por agimi
tërheq zvarrë fytirat në anën time
nëse gjenden pëshpëritje
nëse gjendet një promuskuitet që e përmbledh një
celibat
ta pres menjëherë dorën rreth vitheve të mia
por nga gjaku mjegulla
stepet e zhuritur e kalbur


Atëherë e pashë engjullin lartë me një shpatë
atë që kërkon ti nuk është këtu ai jeton
kjo është një shenjë
pra vdekja e tij do të jetojë
dhe do të therr si shpatë mitrës tënde
mbarsuar me lëngë, jetë dhe mëngjes

Shko
kërkoje atë përtej vetmisë
Shko
lëre këtë varr lëre
gurin
të bie për një erë
një aromë deti

Por mjegulla

zvarritë

dallgët



G.G. MARQUEZ

AVIONI I BUKUROSHE SË FJETUR

Tregim

Përktheu nga sanjishtja Mira Meksi

Ishte e bukur, elastike, me një lëkurë të butë ngjyrë buke dhe sy si bajame të blerta, me flokë të lëmuar e të zinj, të gjatë deri te supet dhe një brerore lashtësie, që mund të ishte e Indonezisë, por edhe e Andeve. Ishte veshur me një shije të hollë: xhakëtë prej lëkure rrëqebulli, bluzë prej mëndafshi natyral me lule shumë të imëta, pantallona lini dhe ca këpucë të ngushta me majë në ngjyrë të bugenvileve. *Kjo është gruaja më e bukur që kam parë në jetën time*, mendova, kur e pashë të kalonte me hapa të mëdhenj dhe të matur luaneshe, ndërsa unë mbaja radhën për të hipur në avionin e Nju Jorkut, në aeroportin Charles de Gaulle të Parisit. Ishte një fanitje e mbinatyrshme, që flatroi vetëm një çast dhe u zhduk në turmën e korridorit.

Ishte ora nëntë e mëngjesit. Binte dëborë që prej një nate më parë, në rrugët e qytetit qarkullimi ishte më i dendur se zakonisht dhe akoma më i ngadalshëm në autostradë, kishte kamionë ngarkimi të rreshtuar anëve dhe makinat nxirrnin avull në dëborë. Në hollin e aeroportit, përkundrazi, jeta vazhdonte në pranverë.

Prisja në radhë për të regjistruar bagazhin pas një plake holandeze, e cila qëndroi pothuaj një orë duke u grindur për peshën e njëmbëdhjetë valixheve të saj. Nisa të mërzitesha, kur më zuri syri fanitjen e çastshme që më la pa frymë, dhe nuk mora dot vesh se si përfundoi ajo grindje, derisa punonjësja më zbriti nga qielli ku ndodhesha, duke më qortuar për humbamendjen time. Në vend që t'i lypja ndjesë, i kërkoja të më thoshte në u besonte dashurive me shikim të parë. “S’do mend, - më tha. - Të pamundura janë dashuritë e tjera”. Vazhdoi me sytë ngulur në ekranin e kompjuterit dhe më pyeti se çfarë vendi parapëlqej: me duhan apo pa duhan.

- S’e kam problem, - i thashë me qëllim, - vetëm të mos jetë pranë asaj të njëmbëdhjetë valixheve.

Më falënderoi me një buzëqeshje sa për të thënë, pa i hequr sytë nga ekrani fosforeshent.

- Zgjidhni një numër, - më tha, - tre, katër apo shtatë.

- Katër.

Buzëqeshja e saj pati një xixëllimë triumfuese.

- Gjatë këtyre pesëmbëdhjetë vjetëve që kam këtu, - tha, - jeni i pari që nuk zgjidhni shtatën.

Shënoi në biletën e nisjes numrin e vendit dhe ma zgjati bashkë me pasaportën dhe dokumentet e tjera, duke më vështuar për herë të parë me sytë e saj ngjyrë rrushi, që më shërbyen si ngushëllim derisa e pashë sërish bukuroshen. Vetëm atëherë më njoftoi se aeroporti porsa ishte mbyllur dhe të gjitha fluturimet shtyheshin.

- Deri kur?

- Deri kur të dojë Zoti, - tha me buzëqeshje. - Radioja njoftoi sot në mëngjes se do të kemi dëborën më të madhe të vitit.

U gabua: ishte dëbora më e madhe e shekullit. Por në sallën e pritjes së klasit të parë pranvera ishte aq reale, saqë nëpër saksi kishin lulëzuar trëndafila të vërtetë, deri edhe muzika e regjistruar ngjante po aq sublime dhe qetësuese sa pretendonin krijuesit e saj. Befas më tha mendja se ajo ishte një strehëz e përshtatshme për bukuroshen dhe e kërkoja në sallonet e tjera, i drithëruar nga vetë guximi im. Por atje pjesa më e madhe ishin burra të jetës reale, që lexonin gazetën në anglisht, ndërkohë që gratë e tyre e kishin mendjen te të tjerë burra, tek sodisnin avionët e vdekur në dëborë përmes xhamave panoramikë, tek sodisnin fabrikat e akullta, fushat e gjera të mbjella të Roissy-isë të shkatërruara nga luanët. Pas mesditës, në sallë nuk ngeli më asnjë vend i lirë dhe u bë aq vapë, sa ia mbatha që të merrja ajër.

Jashtë saj gjeta një pamje të jashtëzakonshme. Njerëz të të gjitha sojeve kishin mbushur tumbllas sallat e pritjes dhe ishin vendosur nëpër korridoret mbytëse, madje edhe nëpër shkallë, shtrirë përtokë së bashku me kafshët e tyre, me fëmijët dhe me bagazhet e udhëtimit. Sepse edhe lidhja me qytetin ishte ndërprerë dhe pallati plastik dhe i tejdukshëm ngjante si një anije kozmike gjigante, që kishte ngecur në furtunë. Nuk munda ta bishtnoja idenë se

Nëse sytë janë dritarja e shpirtit, atëherë leximi i letërsisë artistike nga vende ndryshe nga i yti, mund të jetë një nga mënyrat më të mira për të pasur një përfytyrim për toka, kultura dhe histori të ndryshme. Për këtë arsye lista e finalistëve për International Booker Prize, çmim që jepet çdo vit për një libër të përkthyer në anglisht, e meriton veçanërisht të përgëzohet.

Gjuhët origjinale këtë vit janë që nga spanjishtja, polonishtja dhe norvegjishtja, te koreanishtja, japonishtja dhe hindi, dhe historitë që tregojnë këto libra duken magjepsëse.

Vetëm kur po shfletoja *Out of it*, romanin debutues të shkrimtares palestinezo-britanike Salma Dabbagh, të cilin e rishikova për këtë gazetë, kuptova se nuk kisha lexuar kurrë se si jetonin njerëzit në Gaza. Kisha dijeni për luftërat dhe politikat, sigurisht, dhe vuajtjet; të gjithë lajmet ishin për këtë. Por nuk e dija se si mes kaosit dhe frikës një popullatë prej më shumë se dy milionë rriste familjet, studionte, tregtonte, hante, binte në dashuri, dhe bënte gjithë gjërat që bëjnë komunitetet e rregullta.

Shkrova: “Vetë fakti që ne dëgjojmë kaq pak për këtë anë të ekzistencës së tyre, i afrohet rrezikshëm ... dhënies së statusit monokrom si viktimë të pafuqishme.” U desh romani i Dabbagh-it që të zgjeronte konceptin tim mbi jetët e tyre. (Aksidentalisht, bëma të tilla mund të jenë të nevojshme për europianët që tani janë të shqetësuar për ukrainasit, të kujdesen pak më shumë për gjendjen e njerëzve në Jemen, Afganistan dhe Mianmar.

Letërsia mund të jape të tilla njohuri që lajmet, analizat dhe opinionet i japin shumë rrallë.

A e imagjinon dot si është të rritesh në një qytet të largët shqiptar që këmbëhet disa herë mes italianëve, grekëve dhe gjermanëve në luftën e dytë botërore? Si mundesh? Provo të lexosh *Kronikë në gur* nga Ismail Kadare, fituesi i çmimit të parë të International Booker në 2005. Dy prej personazheve të tij diskutojnë thashetheme mbi një burrë misterioz mjekërkuq nga shumë larg, një “Jusuf Stalin”, i cili do t’i çlironte nga pushtuesit e padëshiruar.

“Mysliman është ky?” pyeti Nazoja. Xhexhoja mbeti një çast. ‘Mysliman,’ tha pastaj e sigurt. ‘Shyqyr,’ ia bëri Nazoja.” Është një vinjetë e hijshme që sjell në jetë menjëherë se sa të izoluar nga bota dhe koha ishin njerëzit në atë qytet – për të bërë atë hamendësim, vetëm prej emrit të Stalinit.

Ndonjëherë një roman mund ta përcjellë një të vërtetë shumë më qartë se çdo numër reportazhesh apo statistikash. Çdokush që do të dijë për historinë pas pavarësisë të indianëve etnikë në Malajzi, për shembull, do të bënin mirë të lexonin çmimfituesin *Evening is the Whole Day* të Preeta Samarasan-it se sa të shfletonin një përgjigje me studime akademike. E njëjta gjë vlen për *In the Shadow of Banyan*, të Vaddey Ratner-it, për të kuptuar realitetin e punës së detyruar, vdekjen nga uria dhe persekutimin nën regjimin e Khmer Rouge në Kambodian e 1970.

Herë të tjera, romani mund të të lidhë në mënyra të pamundura. Çfarë mund të kem të përbashkët me komandatin e regjuri të luftëtarëve të lirisë në Algjerinë e para-pavarësisë në 1960? Shumë pak, do të thosha – derisa lexova *The Bridges of Costantine* të Ahlam Mosteghanemi-t, dhe përshkrimin e saj për partizanin që e donte fëmijën e tij “me dashurinë e një babai në

Kur e konsideron rolin që luajnë, përkthyesit jo vetëm që janë të keqpaguar por dhe vërtet të nënvlerësuar

Pas çdo nominimi të Booker Prize është një person të cilin nuk e ke dëgjuar kurrë

Nga Sholto Byrnes

të dyzetat”. Isha rreth asaj moshe kur unë dhe gruaja ime lindëm fëmijën tonë të parë, e dija pikërisht çfarë donte të thoshte, dhe papritur ndava atë emocion të veçantë me personazhin e romanit.

Të gjithë romanet që kam përmendur janë të fuqishëm dhe iluminues, por pa përkthyesit letrarë të veprave të Kadaresë dhe Mosteghanemi-t (e kaq shumë të tjerëve) do t’i mohoheshin publikut anglofon. Suksemi i letërsive të përkthyera nga shkrimtarë si Gabriel Garcia Marquez

dhe Haruki Murakami nuk duhet të errësojë faktin se numri i titujve të përkthyer të botuar në USA dhe UK përbëjnë vetëm 2-3 për qind të tregut.

“Përkthyesit nuk mund të jetojnë vetëm me këtë mjeshtri,” tha drejtori i Qendrës së Studimeve të Përkthimeve në Universitetin e Londrës kur dorëzova një raport mbi këtë temë para disa vitesh. Kur e kupton rolin e paçmueshëm që luajnë – të themi të drejtën, të rikrijosh nga e para një roman në një gjuhë tjetër, apo “të bësh të kuptueshme një



kulturë të tërë”, siç e ka thënë shkrimtari i ndjerë Anthony Burgess – përkthyesit letrarë jo vetëm që janë tmerrësisht të keqpaguar, por në fakt janë edhe të nënçmuar.

Kjo e bën edhe më të mirëpritur faktin që International Booker njih jo vetëm autorët individualë por edhe përkthyesit e tyre. Ata ndajnë një çmim prej £50,000, dhe i gjithë kriteri për çmimin ka ndryshuar – në fillim autorët gjykoreshin për gjithë veprën e tyre, jo vetëm një libër siç është tani – përkthyesit e tyre janë nderuar gjithmonë, si David Bellos kur fitoi Kadare në 2005.

Nuk i kam përmendur çështjet e përkthimit të romaneve në gjuhë të tjera, dhe sa e rëndësishme është kjo, siç isha i kënaqur që kisha mundësinë të lexoja romane si *The Tobacco Keeper* të shkrimtarit irakian Ali Bader në anglisht (ishte në listën e gjatë për Çmimin Ndërkombëtar për Letërsinë Arabe në 2009), kjo duhet të aplikohet dhe në drejtimin tjetër gjithashtu.

Por gjuha angleze dominon ndërkombëtarisht. Dhe siç ka thënë shkrimtarja e raportit që dorëzova, Rachel Aspden, “Në epokën e globalizimit, anglishtja rrezikon të lërë mënjanë pjesën tjetër të botës”. Çmime si International Booker bëjnë pjesën e tyre që të sigurohen që kjo sdo të ndodhë. Kështu që le të flasim gjerësisht për finalistët e tyre, të urojmë fituesin, dhe të nderojmë shkrimtarët të cilët thellojnë botëkuptimin tonë. Ata ndërtojnë ura mes kulturave. Ne, lexuesit, duhet vetëm t’i kalojmë përmes që të shijojmë kënaqësitë e tyre.

Përktheu Enxhi Hudhri



(Vijon nga faqja 21)

edhe bukuroshja duhej të ndodhej diku në mes të atyre hordhive të buta dhe kjo fantazi më dha një tjetër guxim për të shpresuar.

Në orën e drekës ishim bërë të ndërgjegjshëm për gjendjen tonë prej anijembyturish. Përpara të shtatë restoranteve, kafeneve, bareve të mbushura plot e përplot, radhët u bënë të pafundme dhe në më pak se tri orë u desh t'i mbyllnin, sepse s'kishte mbetur më asgjë për të ngrënë e për të pirë. Fëmijët, që për një çast ngjanin sikur ishin mbledhur nga të katër anët e botës, ia plasën të qarit në të njëjtën kohë dhe, nga turma, zuri të ngrihej një duhmë prej kopeje. Ishte koha e instinkteve. E vetmja gjë që arrita të haja, në mes të asaj plaçkitjeje, ishin dy kupat e fundit me akullore me krem në një dyqan për fëmijë. I hëngra pak e nga pak në banak, ndërsa kamerierët vendosnin karriget mbi tavolinat që liroheshin, duke u parë në pasqyrën e sfondit, me lupëzën e fundit prej kartoni dhe lugën e vogël prej kartoni në dorë dhe me mendjen te bukuroshja.

Avioni për Nju Jork nga ora tetë e mëngjesit, që ishte parashikuar, u nis në tetë të darkës. Kur më në fund arrita të hipja, pasagjerët e klasit të parë kishin zënë vendet dhe një stjuardesë më shoqëroi te vendi im. Mbeta pa frymë. Në ndenjësen ngjitur, pranë dritarezës, bukuroshja po pushtonte hapësirën që i takonte me lehtësinë e udhëtarëve të regjur. *Sikur ta shkruaja ndonjë ditë këtë, askush nuk do të më besonte*, mendova dhe u rreka të thosha nëpër dhëmbë një përshëndetje të pasigurt, të cilën ajo nuk e kapi. U rregullua sikur do të jetonte shumë vjet aty, duke vendosur gjithçka në vendin dhe sërën e vet, derisa hapësira e saj u stis tamam si një shtëpi ideale, ku gjithçka e ke gati kur të duash. Ndërsa merrej me këtë punë, shefi i kabinës na solli shampanjën e mirëseardhjes. Mora një kupë që t'ia ofroja asaj, por u bëra pishman në kohë. Sepse donte vetëm një gotë ujë dhe i kërkoi shefit të kabinës, në fillim me një frëngjishte të pakuptueshme dhe pastaj me një anglishte ca më të saktë, që të mos e zgjonte gjatë fluturimit për asnjë arsye. Zëri i saj i ashpër dhe i ngrohtë tërhiqte zharg një trishtim oriental.

Kur i sollën ujin, hapi mbi gjunjë një kuti tualeti me qoshe bakri, si baullet e gjysheve, dhe nxori dy tableta të praruara nga një këllëf, ku kishte edhe të tjera me ngjyra të ndryshme. Gjithçka e bënte në një mënyrë aq metodike dhe kursyerazi, sa dukej sikur çdo gjë për të ishte parashikuar që nga dita kur kishte lindur. Më në fund, uli perden e dritares, e shtriu krejt ndenjësen, hodhi mbulesën gjer në brez, pa i hequr këpucët, vuri maskën e gjumit, u shtri në brinjë mbi ndenjëse me shpinë nga unë dhe fjeti pa një pauzë, pa një psherëtimë, pa ndërruar asnjë sekondë krahun gjatë tërë kohës që zgjati fluturimi për në Nju Jork: tetë orë të përrjetshme dhe dymbëdhjetë minuta mbi to.

Ishte një udhëtim intensiv. Gjithmonë kam besuar se nuk ka gjë më të bukur (të mrekullueshme) në natyrë se një grua e bukur, kështu që e pata të pamundur t'i shpëtoja, qoftë edhe një çast, magjisë së asaj krijese përrallore, që flinte bri meje. Shefi i kabinës ishte zhdukur porsa ishim ngritur nga toka dhe ishte zëvendësuar nga një stjuardesë karteziiane, e cila u përpoq ta zgjonte bukuroshen që t'i jepte sendet e tualetit dhe kufjet për të



dëgjuar muzikë. Ia përsërita porosinë që ajo i pati dhënë shefit të kabinës, por stjuardesa këmbënguli ta dëgjonte nga goja e saj se nuk dëshironte të hante as darkë. U desh të pohonte shefi i kabinës, e megjithatë, ajo më qortoi që bukuroshja nuk kishte varur në qafë tabelën me urdhrin se s'donte ta zgjonin.

Hëngra një darkë të vetmuar, duke folur me vete në heshtje dhe duke thënë të gjitha ato që kisha për t'ia thënë bukuroshes, sikur të ishte zgjuar. Gjumi i saj ishte aq i pandryshueshëm, sa për një çast pata frikë se mos tabletat që kishte pirë nuk ishin për të fjetur, por për të vdekur. Përpara se ta vija gotën te buzët, e ngrija dhe uroja:

- Për shëndetin tënd, bukuroshe!

Kur mbaroi darka, shuan dritat, dhanë filmin për askënd dhe ne të dy mbetëm vetëm në mugëtirën e botës. Furtuna më e madhe e shekullit kishte kaluar dhe nata e Atlantikut ishte e pafund dhe e qashtër, ndërsa avioni

ngjante i palëvizshëm mes yjeve. Atëherë nisa ta kundroja atë me orë të tëra, pëllëmbë për pëllëmbë, dhe e vetmja shenjë jete që munda të dalloja ishin hijet e ëndrrave, që kalonin mbi ballin e saj si retë nëpër ujë. Në qafë mbante një zinxhirkë aq të hollë, sa që mezi shquhej mbi lëkurën e saj ngjyrë ari: veshët i kishte të përsosur dhe pa vrima vathësh, thonjtë në ngjyrën rozë të shëndetit dhe një rreth unaze në dorën e majtë. Meqë s'ngjante më shumë se njëzet vjeç, u ngushëllova me mendimin se nuk ishte unazë martese, por unazë e një premtimi kalimtar dashurie. *E di, ti fle e qetë, e sigurt, shtrat besnik braktisjeje, linjë e dëlirë kaq pranë krahëve të mi duarlidhur*, mendova duke përsëritur përmbi kreshtën e shkumës së shampanjës sonetin mjeshtëror të Gerardo Diego-s. Pastaj e shtriva ndenjësen në lartësinë e ndenjëses së saj dhe qëndruam ashtu shtrirë të dy më pranë se në një shtrat bashkëshortor. Klima e fromës së saj

ishte po ajo e zërit dhe lëkura i çlironte një fije hukamë, që s'mund të ishte veçse aroma e vetë bukurisë së saj. Më dukej e pabesueshme: pranverën e kaluar kisha lexuar një roman të bukur të Yasunari Kavabata-s për pleqtë e pasur të Kyoto-s, të cilët paguanin shuma të mëdha për ta kaluar natën duke soditur vajzat më të bukura të qytetit, të zhveshura dhe të përgjumura me anë narkotikësh, ndërsa ata vetë jepnin shpirt nga dashuria në një shtrat me to. Nuk u lejohej t'i zgjonin apo t'i preknin, dhe ata as që tentonin, sepse esenca e atij qejfi të stërholluar ishte t'i sodisje të fjetura. Atë natë, duke përgjuar gjumin e bukuroshes, jo vetëm e kuptova atë delikatesë pleqërie, por edhe e përjetova tërësisht.

- E kush mund ta besonte! - thashë me sedër të lënduar nga shampanja. - Të katandisesha unë si një plak japonez!

Pata përshtypjen se fjeta disa orë i mundur nga shampanja dhe shkrepimat memece të filmit dhe u zgjova me kokën të brazduar. Shkova në banjë. Dy vende pas meje dergjej plaka e njëmbëdhjetë valixheve, që ishte lëshuar e hallakatur si mos më keq mbi ndenjëse. Dukej si një i vdekur i harruar në fushën e betejës. Përtokë, në mes të korridorit, ndodheshin syzet e saj të leximit, bashkë me një varg tespihesh ngjyra-ngjyra dhe, për një çast, shijova kënaqësinë e sjelljes sime meskine: nuk ia ngrita nga toka.

Pasi u çlirova nga teprimet e shampanjës, u habita me fytyrën time në pasqyrë: isha i padenjë dhe i shëmtuar dhe u tremba, kur pikasa që rrënimet e dashurisë ishin kaq të tmerrshme. Befas avioni u lëshua në pikiatë, u drejtua si munda dhe vazhdoi të fluturonte me galop. Dola si vetëtimë, me shpresë se vetëm turbulencat e Zotit mund ta zgjonin bukuroshen, dhe asaj do t'i duhej të strukej në krahët e mi, për t'i shpëtuar tmerrit. Në vrull e sipër përdesh theva gjyzlykët e holandezes dhe kjo do të më kishte gëzuar. Por u ktheva, i ngrita dhe ia vura në pëqi, duke ndier befas mirënjohje ndaj saj, që nuk pati zgjedhur përpara meje ndenjësen numër katër.

Gjumi i bukuroshes ishte i paepur. Kur avioni u stabilizua, m'u desh t'i bëja ballë tundimit për ta shkundur me çfarëdolloj preteksti, sepse e vetmja gjë që dëshiroja në atë orë të fundit të udhëtimit, ishte ta shihja të zgjuar, qoftë edhe të xhindosur, që të mund të rifitoja lirinë, por ndoshta edhe rininë time. Por nuk munda. "Ta marrë djalli, - thashë me vete plot përçmim. - Pse nuk u linda në shenjen e Demit!" U zgjua vetë në çastin kur u ndezën lajmërimet e uljes në tokë dhe ishte aq e bukur dhe e freskët, sa dukej sikur kishte fjetur në një trëndafilishtë. Vetëm atëherë e kuptova se fqinjët në avionë, njëllor si çiftet pleq, nuk i thonë mirëmëngjesi njëri-tjetrit, kur zgjohen nga gjumi. As ajo nuk më tha. Hoqi maskën e gjumit, çeli sytë vezullues, ngriti ndenjësen, hoqi mënjane mbulesën, shkundi leshrat, të cilët i krihte vetë pesha e tyre, dhe bëri një tualet të shpejtë e të kotë, i cili i zgjati aq sa ajo të mos kishte kohë të më hidhte sytë, derisa u hap porta. Atëherë veshi xhaketen prej lëkure rrëqebulli, më kaloi pothuaj përsipër duke mermëritur një ndjesë sa për mirësjellje në spanjishten e kulluar të Amerikës Latine dhe iku pa thënë as mirupafshim, madje pa më falënderuar për gjithçka bëra për natën tonë të lumtur, dhe u zhduk deri diellin e sotëm në amazoninë e Nju-Jorkut.

Qershor 1982

ALAN
WATTS



UDHA
ZEN

Minerva